



Shkëlzen Gashi

Historia e Kosovës

në tekstet mësimore të historisë në
Kosovë, Shqipëri, Sërbi, Mal të Zi dhe Maqedoni



alter
habitus | instituti
për studime
në shoqëri
dhe kulturë

Historia e Kosovës

në tekstet mësimore të historisë në
Kosovë, Shqipëri, Sërbi, Mali i Zi dhe Maqedoni

Botues:

Instituti për Studime në Shoqëri e në Kulturë “Alter Habitus”

Autor:

Shkëlzen Gashi

Redaktor gjuhësor:

Gazmend Bërlajolli

Konsulentë:

Albana Rexhepaj

Arbër Vokri

Armanda Hysa

Dizajni i kopertinës dhe faqosja:

Rrota

www.rrota.com

Shtypi:

Night Design

Prishtinë 2016

Tirazhi:

500 copë

Hulumtimi dhe botimi u përkrahën nga:

Ambasada e Holandës, Ambasada e Zvicrës, KFOS dhe Instituti “Georg Eckert”

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdo ato të Institutit për Studime në Shoqëri e në Kulturë “Alter Habitus”, të Ambasadës së Holandës, të Ambasadës së Zvicrës, të Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), të Institutit “Georg Eckert” e as të konsulentëve.

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	5
1. Origjina e shqiptarëve	9
Përmbledhje	17
2. Kosova në Mesjetë deri në sundimin sërb.....	21
Përmbledhje	26
3. Kosova në Mesjetë gjatë sundimit sërb	29
Përmbledhje	37
4. Kosova në Perandorinë Osmane	43
4.1. Nga Gjergj Kastrioti-Skënderbeu deri te Rilindja Kombëtare Shqiptare	44
Përmbledhje	54
4.2. Rilindja Kombëtare Shqiptare	59
Përmbledhje	66
5. Kosova nën sundimin sërb 1912-2000.....	73
5.1. Kosova 1912-1913	73
Përmbledhje	77
5.2. Kosova mes dy luftërave botërore 1918-1939	81
Përmbledhje	85
5.3. Kosova në Jugosllavi 1945-1990	90
Përmbledhje	97
5.4. Kosova gjatë viteve 1990	103
Përmbledhje	107
BIBLIOGRAFI	117

HYRJE

Ky raport vë nën objektiv paraqitjen e historisë së Kosovës që nga antikiteti e deri më sot nëpër tekstet mësimore për shkolla fillore e të mesme të Kosovës, Shqipërisë, Serbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë. Tekstet e përdorura për hartimin e këtij raporti janë nga botuesit Libri Shkollor (Prishtinë), Albas (Tiranë), Zavod za Udžbenike (Beograd), Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore (Podgoricë) dhe Prosvetno Dello dhe Tabernakul (Shkup).

Tekstet e lëndës së historisë të këtyre pesë vendeve, të miratuara nga ministritë përkatëse të arsimit, kanë shërby si burimi themelor i këtij raporti. Janë krahasuar përshkrimet e bëra nëpër këto historiografi duke i nxjerrë ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre. Autorë ndërkombëtarë, si Noel Malcolm, Oliver Schmitt, Peter Bartl, Stephen Schwartz, e të tjerë që trajtojnë zhvillimet dhe ngjarjet në Kosovë në periudha të ndryshme, janë vënë përballë me argumentet përkatëse.

Raporti trajton periudhat më të rëndësishme të historisë së Kosovës duke i vënë në pah shpërputhjet mes historiografive në fjalë, por edhe falsifikimet përkatëse të cilësdo palë. Në mënyrë të tërthortë raporti nxjerr në pah edhe se çfarë marrëdhëniesh ndërfaqinjesore po u sugjerojnë qeveritë e këtyre vendeve brezave që po i arsimojnë nëpërmjet këtyre teksteve. Raporti synon me shpalosë, në mënyrë sa më të qartë dhe të faktografuar, atë që është baza e pretendimeve shpesh kundërshtuese ndërmjet popujve që përplasen në Kosovë, prandaj po botohet në shqip, serbisht dhe anglisht.

Ky raport u dedikohet hartuesve të teksteve shkollore të historisë nga Kosova, Shqipëria, Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia, pastaj përfaqësuesve të ministrive përkatëse të arsimit, të cilët japin lejet për botimin e tyre, por edhe politikëbërësve dhe vetë mësimdhënësve të historisë nëpër shkollat fillore e të mesme. Po ashtu, ai do të jetë në dispozicion të gjithkujt që mund të ketë interes në temat e trajtuara.

Dhe në fund dua t'i falënderoj të gjithë ata që kontribuan në forma e faza të ndryshme për këtë raport. Në radhë të parë donatorët: Ambasadën e Holandës, me theks të veçantë ambasadorin Robert Bosch, Ambasadën e Zvicrës, dhe Kosovo Foundation for Open Society (KFOS), posaçërisht Luan Shllakun. Një falënderim i përzemërt edhe për Institutin "Georg Eckert" në Gjermani për mbështetjen gjatë qëndrimit dy herë nga katër javë në ambientet e tij, veçanërisht për Claudia Lichnofsky. Po ashtu, falënderim me gjithë zemër për botuesin e këtij raporti, Institutin "Alter Habitus", e në mënyrë speciale Eli Gashin.

Po ashtu falënderoj shumë, për komentet, këshillat, sugjerimet e rekomandimet me shumë vlerë edhe Albana Rexhepajn, Arbër Vokrrin dhe Armanda Hysën, të cilët nuk mbajnë kurrfarë përgjegjësie për gabimet e mia eventuale; pastaj Gazmend Bërlajollin për redaktimin gjuhësor; falënderoj për përkthimet e rrjedhshme: Elizabeth Gowing në gjuhën angleze e Anton Berishajn në atë serbe; për dizajnin dhe faqosjen kompaninë "Rrota", posaçërisht dizajnerët Arbër Matoshi e Ardian Veliu.

1. ORIGJINA E SHQIPTARËVE

Në tekstet mësimore të Kosovës e Shqipërisë pothuajse në mënyrë të padiskutueshme shqiptarëve u njihet prejardhja nga ilirët, prandaj ky kapitull i heton konkretisht këto pyetje: si përshkruhen ilirët, ç'hapësirë u kushtohet, ç'vend zënë luftërat e tyre, cilat janë shkaqet e paraqitura për këto luftëra dhe për rezultatet e tyre, si prezentohet asimilimi/romanizimi i ilirëve; dhe, në fund fare, cili është bashkëpunimi i ilirëve me fqinjët.

Tekstet e historisë në Kosovë thonë se pellazgët kanë qenë popullsia më e vjetër e Ballkanit, ndërsa ilirët pasardhësit e tyre, kurse “gjuha pellazge ka qenë shumë e ngjashme me gjuhën ilire dhe prej saj ka rrjedhë gjuha ilire, ndërkaq traditat dhe zakonet e pellazgëve kanë qenë shumë të përafërta me ato ilire”. Por, nuk jepet asnjë argument mbështetës. Sipas këtyre teksteve, ilirët quhen stërgjiyshër të shqiptarëve, e për këtë ofrohen kryesisht pohime si këto: “ilirët kishin zakone të veçanta, të ngjashme me ato të shqiptarëve të sotëm”; “mikpritja e ilirëve mund të krahasohet me mikpritjen që i bëjnë mysafirët shqiptarët e sotëm”; “mënyra e veshjes së ilirëve ngjan me mënyrën e veshjes së shqiptarëve të sotëm” sepse “ilirët në kokë mbanin kësulë leshi, ashtu siç mbajnë plis të bardhë sot malësorët shqiptarë”. Vlerësimi se “gjuha ilire ishte shumë e ngjashme me gjuhën e sotme shqipe” merr argumentin se shqipja ka “shumë fjalë nga ilirishtja që përdoren edhe sot, si emrat: Gent, Teutë, Agron, Bardhyl...”. Pohimi i fundit thotë se “në territorin e Ilirisë ishin ngritë shumë qytete, gjurmët e të cilave gjenden edhe sot në të gjitha trojet etnike shqiptare dhe më gjërë”.

Pra, ilirët paraqiten si paraardhës të padiskutueshëm të shqiptarëve dhe si popullsi vendase në trevat e Ballkanit, dikur të banuara prej tyre në gati gjithë territorin e ish-Jugosllavisë. Kjo me gjasë për të dhënë idenë e vijimësisë së shqiptarëve në këto treva, ndryshe prej sllavëve, përkatësisht sërbeve, të ardhur këndejpari dukshëm më vonë.

Në raport me pyetjet konkrete që u parashtruan në krye të këtij kapitulli, ndër momentet historike që shtjellohen në tekstet e Kosovës rreth kësaj periudhe, mund t'i vërejmë këto prirje:

- shumë njësi mësimore për ilirët kryesisht thurin lavde entuziaste: “ilirët ishin luftëtarë besnikë e të guximshëm”; “ilirët njiheshin si punëtorë të vyer e të zellshëm”; nga shkollat ilire dolën ushtarakë, mbretër e dijetarë të shquar”...; vlerësimet pa mbulesë vijnë tutje: “kolonët grekë që u vendosën në trevat ilire gjetën një kulturë të avancuar, që nuk e kishin takuar më parë dhe mësuan shumë gjëra nga ilirët, sidomos bujqësinë, blegtorinë dhe zejtarinë, që ishin mjaft të

zhvilluara”; madje “në gjuhën ilire ka pasë shumë libra, por nuk janë ruajtë deri sot për shkak të luftërave e shkatërrimeve”;

- vend qendror zënë luftërat, me ç’rast lartësohen ilirët që “asnjëherë nuk janë nënshtruar ndaj pushtuesve romakë”; “kanë luftuar vazhdimisht për liri”; “kur kryengritjet e tyre janë shtypë me egërsi, ata përsëri kanë ngritë krye kundër sundimtarëve të huaj”; shkak i luftërave është gjithmonë pretendimi i armiqve romakë, grekë e maqedonë për t’i futë nën kontroll territoret ilire, ndërsa disfatat e ilirëve ndodhin sepse luftërat mbrojtëse të tyre ishin lokale për nga karakteri, megjithëse nuk ofrohet sqarim se pse ishin të tilla;
- mohohet kategorikisht romanizimi i ilirëve: “edhe pse të pushtuar, ilirët arritën ta ruajnë gjuhën, kulturën, traditat e zakonet e tyre”; edhe pse mohohen romanizimi dhe helenizimi, evidentohet se disa prej perandorëve romakë, grekë e maqedonë kishin prejardhje ilire: perandori romak Konstandini i Madh; perandori bizantin Justiniani dhe Leka i Madh, biri i Olimpisë ilire;
- për të këqijat që u ndodhin ilirëve, faji u vihet ‘armiqve’ romakë, grekë e maqedonë, prandaj nuk paraqitet asnjë bashkëpunim i ilirëve me ta;

Njëri prej teksteve të Kosovës përmban madje një njësi të veçantë mësimore, të titulluar “Atdheu im në lashtësi – Dardania”, që synon ta veçojë identitetin e Kosovës edhe në antikitet. Dardania, thuhet këtu, shtrihet në territorin e sotëm të Kosovës dhe të viseve përreth, përfshi qytetet Nish e Shkup. Dardania prezentohet si një ndër shtetet më të fuqishme të kohës, jo veç mes mbretërive ilire, por edhe më gjerë. Më tej, pohohet se Dardania kishte ushtri të fuqishme e se veçori e luftëtarëve dardanë ishte se hidheshin të gjithë së bashku në sulm dhe tërhiqeshin po së bashku, pa i lënë të plagosurit në duart e armikut. Flitet edhe se si romakët i krahasonin dardanët me kuçedrën që ringjallej pasi ia këpusnin të gjitha kokat.¹

Tekstet e historisë në Shqipëri, ndryshe nga ato të Kosovës, përmendin se ekzistojnë dy teza kryesore për origjinën e ilirëve: e para, se ilirët janë autoktonë, pasardhës të pellazgëve; e dyta, se janë përzierje vendasish me popullsi të ardhura. Sipas këtyre teksteve, zbulimet dhe studimet mbështesin tezën e parë, që shtjellohet edhe në tekstet e Kosovës, se ilirët janë pasardhës të pellazgëve dhe paraardhës të shqiptarëve. Në mbështetje të kësaj teze, këto tekste pohojnë se “shqipja është vazhdim i ilirishtes dhe sot trashëgojmë

.....
 1 Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj. *Historia 5*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013, faqe 8-21; Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj. *Historia 6*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013, faqe 24, 70-98 dhe 105; Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj. *Historia 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013, faqe 26-59.

shumë fjalë ilire, si emra njerëzish, lumenjsh, malesh, fisesh, e kështu me radhë”. **Ndryshe nga tekstet e Kosovës**, këto tekste e pranojnë megjithatë se këto fjalë gjenden të shkruara me alfabet grek ose latin dhe se deri më sot nuk zotërohet ndonjë dokument i shkruar në ilirisht, madje thonë se nuk dihet ende nëse ilirët e shkruanin gjuhën e vet. Ideja e vijimësisë iliro-shqiptare arsyetohet kështu: “ilirët, ashtu si shqiptarët, ishin të shoqërueshëm dhe mikpritës” dhe “shqiptarët kanë trashëguar nga kultura ilire: për shembull, këngët polifonike janë nga koha e ilirëve”.

Të shikuara kundrejt pyetjeve të ngritura në krye të kapitullit, tekstet e Shqipërisë shfaqin këto prirje:

- shumë njësi mësimore u thurin lavde ilirëve: “ishin trima e luftëtarë të aftë, të stërvitur e të armatosur mjaft mirë dhe lundëtarë të zot”; “mbretërit ilirë nuk kishin pushtet të pakufishëm si mbretërit egjiptas, ata merrnin vendime së bashku me këshillin e pleqve, kurse nëpunësit e tyre zgjidheshin nga përfaqësuesit e qyteteve”; “shoqërinë e kishin të organizuar në bazë të ligjeve, të cilave u bindeshin edhe mbretërit e ilirëve”; thuhet edhe se “ilirët kanë qenë të parët që e kanë përdorë metalin në Europë dhe popujt europianë mësuan prej tyre për punimin e tokës”; ose se “shumë studiues i kanë vlerësuar ilirët si një popull i qytetëruar me virtyte të larta, që kanë arritë një shkallë të lartë qytetërimi, e këtë e dëshmojnë zbulimet arkeologjike dhe burimet e shkruara greko-romake”;
- luftërat zënë vend qendror dhe ilirët lartësohen që “nuk iu nënshtuan sundimit romak”; thuhet se “kryengritja u shtyp, por qëndresa nuk pushoi”. Ndonëse nuk mohohet që anijet tregtare greke e romake shpesh plaçkiteshin nga ilirët ose që romakët i quanin kryengritësit ilirë ‘kusarë’, prapsepap luftërat iliro-romake gjithmonë i shkaktën pakënaqësia e romakëve me politikën e pavarur të ilirëve, e cila i prekte interesat romake, pa dhënë spjegime se cila ishte kjo politikë dhe cilët interesat prekeshin. Shkaqe të luftërave me maqedonë janë prirjet e vazhdueshme hegjemoniste maqedone. Disfatat e ilirëve ishin rrjedhojë e intrigave që përdornin romakët për përçarjen e tyre. Flitet për mizoritë, shkatërrimet, plaçkitjet, grabitjet, konfiskimet e djegiet e kryera nga romakët; për qytetet e lulëzuara që i kthenin në fshatra; për tokat më të mira që i shpallnin pronë të shtetit romak; për kolonët e shumtë romakë që vendoseshin nëpër qytete; për qytetet që fitonin të drejtën e ruajtjes së autonomisë së brendshme po të vlerësoheshin si aleatë.
- lidhur për romanizimin vihet në pah se ka studiues, sipas të cilëve ilirët u asimiluan sepse përvetësuan gjuhën latine, besimin, mënyrën e

jetesës dhe organizimin politik latin, por shtohet se studiues të shumtë sjellin argumente shkencore që kultura romake ka pasë ndikim vetëm në veri të territoreve ilire, ku nuk kishte traditë shtetërore, por jo në jug, ku ekzistonte kjo traditë shtetërore; latinishtja u bë gjuhë zyrtare, por nuk e zhdukuri a zhvendosi ilirishten, trashëgimtare e të cilës është shqipja; qëndresa ilire mbështetet me përdorimin e emrave ilirë për vende, lumenj dhe njerëz. Ndonëse romanizimi i ilirëve mohohet sikur në tekstet e Kosovës, vihet në pah se gjatë kësaj periudhe shumë figura qendrore të administratës ose të ushtrisë romake ishin ilirë në origjinë.

- ndryshe nga tekstet e Kosovës, jo çdo e keqe që u ndodh ilirëve u faturohet gjithëherë ‘armiqve’ – romakëve, grekëve e maqedonëve, prandaj përveç konflikteve, në tekstet e Shqipërisë paraqiten edhe shumë bashkëpunime e aleanca të ilirëve me romakët, grekët e maqedonët. Te luftërat e ilirëve me maqedonë përmenden fitoret, por edhe humbjet e ilirëve, madje tregohen edhe raste kur romakët kanë filluar fushatë ushtarake kundër ilirëve për shkak të aleancës së ilirëve me maqedonë, ose kur dardanët u kanë ofruar ndihmë maqedonëve të sulmuar nga keltët, por edhe raste kur dardanët i kanë shkretuar territoret maqedone, duke marrë 20 mijë robër. Ndërkaq, te aleancat iliro-romake përmendet pjesëmarrja e dardanëve në aleancën antimaqedone që kryesohej nga romakët; dorëzimet e mbretërve ilirë ndaj kërkesave të romakëve; mposhtja e ilirëve nga romakët falë përçarjes që këta arrijnë t’ua fusin ilirëve; e kështu me radhë.²

Tekstet e historisë në Sërbi nuk bëjnë fjalë për prejardhjen e shqiptarëve, ndonëse ilirët i përmendin si njërin prej popujve që në kohërat e lashta jetonte në bregdetin Adriatik dhe në brendi të gadishullit të Ballkanit.

Në këto tekste, prirjet janë këto:

- ka shumë pak hapësirë për ilirët, kryesisht e mbizotëruar nga një tipizim negativ: “ilirët janë quaj të barbarë nga helenët dhe romakët”; “ilirët kanë plaçkitë shpesh anijet tregtare romake”; “ilirët kanë ndërmarrë plaçkitje të mëdha në qytetet helene”; “detyra e legjioneve romake ishte që t’i mbronin kufijtë e perandorisë nga sulmet e barbarëve të egër”, e kështu me radhë;
- luftërat zënë hapësirë të vështrimit mbi ilirët, e si shkaqe të tyre vlerësohen shpeshimet e sulmeve kusare të ilirëve ndaj anijeve tregtare

.....
 2 Boçi, Sonila. *Historia 4*. Tiranë: Botime Shkollore Albas, 2013, faqe 39-44; Treska, Tomi dhe Menduh Dërguti. *Historia 6*. Tiranë: Botime Shkollore Albas, 2013, faqe 25-26; Dërguti, Menduh, Sonila Boçi dhe Ledia Dushku. *Historia 9*. Tiranë: Botime Shkollore Albas, 2013, faqe 9-18; dhe Dërguti, Menduh, Ferit Duka, Ledia Dushku dhe Sonila Boçi. *Historia e shqiptarëve 12*. Tiranë: Botime Shkollore Albas, 2013, faqe 19-42.

romake ose konfliktet mes ilirëve dhe kolonive greke në detin Adriatik, të cilat e nxisnin ndërhyrjen romake;

- romanizimi është përhapë me mposhtjen e ilirëve nëpër gadishullin ballkanik, ku përveç gjuhës, kulturës dhe zakoneve romake, është sjellë edhe një ndryshim i thellë që e ka përshpejtuar zhvillimin e ekonomisë dhe kulturës – romakët kanë ndërtuar një numër qytetesh, rrugësh dhe minierash në Ballkan; po ashtu, është përhapë kultura greke, nëpërmjet kolonish greke në brigjet e Adriatikut, çka ka pasë ndikim në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të ilirëve;
- sa u takon bashkëpunimeve iliro-romake, ofrohet vetëm shembulli se si mbreti ilir Baton, bashkë me shoqëruesit, dorëzohet vetë te gjenerali romak Tiberi, më vonë mbret romak, me kushtin e vetëm që të mbetet gjallë.³

Tekstet e Sërbisë përmendin edhe perandorët romakë që i ka dhënë treva e Sërbisë së sotme, mes të cilëve Konstandini i Madh, për të cilin thonë se ishte nga Nishi, pa saktësuar më tej popullin a fisin të cilit i takonte ky ose ndonjë tjetër nga këta perandorë. Po ashtu, kur flasin për fiset që në kohët antike jetonin në territorin e Sërbisë, përmenden dardanët që kanë jetuar në Kosovë.

Tekstet e historisë në Mal të Zi i përmendin ilirët si banorët e parë të njohur në Malin e Zi, që supozohet të kenë ardhë në Ballkan në kohën e dyndjes së popujve indoeuropianë. Në këto tekste ilirët nuk paraqiten si paraardhës të shqiptarëve, e as ilirishtja si paraardhëse e shqipes. Madje këtu “prejardhja e shqiptarëve nga ilirët” nuk figuron as si njëra nga hipotezat mbi prejardhjen e shqiptarëve. Shqiptarët përmenden vetëm nga mesjeta e këndeje dhe thuhet se “prejardhjen e kanë nga autoktonët e gadishullit ballkanik, të cilët në një masë të vogël qenë romanizuar”, pa saktësuar më tej kush ishin këta autoktonë, ndonëse thuhet se qendra e territoreve shqiptare ishte “malësia Arbanon rreth qytetit Krujë, nga rrjedh edhe emri i këtij populli – Arbën”.

Në këto tekste, ndryshe nga tekstet e Kosovës e të Shqipërisë, dhe deri diku ngjashëm me tekstet e Sërbisë, prirjet janë këto:

- ka pak njësi mësimore për ilirët e për rrjedhojë ka edhe pak hapësirë për luftërat e ilirëve; nuk ka kurrfarë lëvdatash për ta, madje flitet për përluljen që romakët ua bënë ilirëve, p.sh. duke i dërguar mbretërit ilirë në Romë si trofe të ngjadhënjimeve mbi ta;

.....
3 Smirnov-Brkiq, Aleksandra. *Historia 5*. Beograd: Zavod za udžbenike, 2011, faqe 148-51; Mihaljičić, Rade. *Istoria 6*. Beograd: Zavod za udžbenike, 2011, faqe 42; Katić, Tatjana dhe Dušan Iljin. *Istorija za I razred gimnazije*. Beograd: Zavod za udžbenike, 2013, faqe 184-87.

- shkaqet që i sillnin këto luftëra janë plaçkitjet dhe sulmet e ilirëve ndaj anijeve romake dhe ngulimeve greke; nga luftrat ilirët pësuan disfatë të plotë, por nuk jepen arsyet e disfatës;
- nuk mohohet romanizimi i ilirëve: gjuha latine, si gjuhë administrate e kulture, përveçse prej romakëve, përhapej edhe nga ilirë që ktheheshin në shtëpitë e tyre pas shërbimit të gjatë ushtarak;
- nuk stigmatizohen ‘armiqtë’ e ilirëve – romakët, grekët dhe maqedonët – madje përmenden bashkëpunimet e ilirëve me grekët, të cilat çuan në përhapjen e ndikimit grek te ilirët; përmenden edhe marrëveshje mes ilirëve e romakëve dhe mes ilirëve e maqedonëve⁴.

Tekstet e historisë në Maqedoni i paraqesin ilirët si banorë të lashtë të Ballkanit, por nuk thonë nëse janë paraardhës të shqiptarëve. Prejardhja e shqiptarëve nuk trajtohet fare në këto tekste.

Prirjet për portretizimin e ilirëve dhe të periudhës së tyre në tekstet e Maqedonisë janë këto:

- ilirët kanë qenë të gjatë, të fuqishëm, ushtarë të mirë, që “më së shumti e kanë dashur lirinë”; “asnjëherë nuk i kanë lejuar ushtarët të bien në dorën e armikut”; “gjithnjë kanë qenë të gatshëm ta flijojnë jetën për mbrojtjen e të afërmve”;
- ilirët kanë qenë të përcarë, shpeshherë kanë luftuar mes vete e me fqinjët, por kurrë nuk kanë arritë të bashkohen tërësisht në planin politik e kulturor, përveçse kur kanë pasë rrezik nga jashtë, kanë bërë organizime që më shumë kanë qenë aleanca fisesh sesa organizim shtetëror;
- ilirët kanë krijuar kulturën sipas modelit të popujve fqinj, me një ndikim të madh nga kultura maqedone e greke përmes kolonive helene, ndërsa ilirët që kanë jetuar më në brendi, u kanë mbetë besnikë shprehive e zakoneve të vjetra; ilirët kanë pasë gjuhë të ngjashme me helenët, maqedonët e trakët, por nuk kanë pasë shkrim vetjak, prandaj s’është ruajtë gjuha e tyre;
- ilirët janë shkaktarët e luftërave me romakët ngase i sulmonin dhe grabitnin anijet tregtare romake dhe kolonitë helene në det e në ishuj, vendbanimet në brendi, fushat, kafshët, fshatërat e pafortifikuara, e me radhë; në këto luftëra ilirët janë mposhtë përherë;

.....
⁴ Kasumoviq, Millada dhe Goran Markoviq. *Historia 6*. Podgoricë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 2006, faqe 19 dhe 86-89; Vukçeviq, Sllavko dhe Millada Kasumoviq e Goran Markoviq. *Historia 1*. Podgoricë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 2006, faqe 23-4 dhe 149-152; Popoviq, Radovan dhe Dragan Miranoviq e Dragoje Gjokiq. *Historia 2*. Podgoricë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 2006, faqe 100.

- ilirët kanë pranuar kulturën, gjuhën, religionin, mënyrën e jetesës dhe janë inkuadruar në shoqërinë romake, madje duke i dhënë disa perandorë;
- ilirët kanë pasë konflikte me maqedonët, por edhe aleanca.⁵

Përrjashtim këtu bën teksti “Historia 1 - arsimit gjimnazor”, me pesë autorë, dy prej të cilëve shqiptarë, ku thuhet se ilirët janë pasardhës të drejtpërdrejtë të pellazgëve. Por, as në këtë kapitull, sikurse në tekstet e tjera të Maqedonisë, nuk thuhet se shqiptarët janë pasardhës të ilirëve. Në njësitë mësimore kushtuar ilirëve në këtë tekst, sugjerohet që nxënësit të përgatisin një referat për ilirët dhe të hulumtojnë më tutje për jetën e tyre, e si literaturë u rekomandohen librat “Historia e Popullit Shqiptar” nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe “Ilirët” e autorit Aleksandar Stipčević. Në të dy këta libra, e sidomos në “Historia e Popullit Shqiptar”, prejardhja e shqiptarëve nga ilirët figuron si tezë e pamohueshme.

Kapitulli “Shqipëria në mesjetën e hershme (shekujt V-XI)” te ky tekst mësimor bën fjalë edhe për prejardhjen e shqiptarëve. Në të thuhet se në mungesë të dokumenteve burimore, disa historianë ndajnë mendimin se ilirët qenë romanizuar ose greqizuar dhe më vonë asimiluar nga sllavët, të tjerë mendojnë se shqiptarët kanë ardhë në këto hapësira bashkë me sllavët, ndërsa grupi i tretë se shqiptarët janë pasardhës të ilirëve dhe banorë autoktonë. Mbështetet teza e grupit të tretë për vazhdimësinë iliro-shqiptare, si argumente kryesore të të cilës përmenden gjetjet arkeologjike nëpër shumë vise shqiptare dhe gjetjet linguistike që e dëshmojnë gjuhën shqipe si vijimësi të një dialekti të vjetër ilir.

Tjetër karakteristikë e këtij teksti është se, përveç konflikteve iliro-romake dhe iliro-maqedone, i paraqet edhe aleancat iliro-romake e iliro-maqedone. Më e rëndësishmja është se ky tekst pasqyron edhe konfliktet mes vetë mbretërive ilire, dardanëve dhe ardianëve, madje duke i përmendë edhe ndasitë mes udhëheqësve ilirë, disa prej të cilëve përkrahnin politikën romake e të tjerë atë maqedone. Shkaqet e disfatave të ilirëve kundruall romakëve ishin konfliktet e brendshme, tradhtia e njerëzve kryesorë të mbretërisë, papërgatitja ushtarake, dobësia ekonomike, e me radhë.⁶

5 Mlladenovski, Simo. *Historia 5*. Shkup: Prosvetno Dello, 2004, faqe 63-65; Axhievski, Kosta dhe Darinka Petreska, Violeta Ačkoska, Naum Dimoski dhe Vanço Gjorgjiev. *Historia 5*. Shkup: Tabernakul, 2005, faqe 48-53 dhe 88-9; Pavlovski, Gjorgji dhe Dime Maxhovski e Jovo Ratković. *Historia 1 për gjimnazin e reformuar*. Shkup: Prosvetno Dello, 2002, faqe 39; Boshkoski, Millan dhe Gjorgji Isajllovski, Miroslav Boshković, Jordan Illoski, Vllado Vellkoski, Simeon Naumovski. *Historia 1 për arsimin e mesëm profesional*. Shkup: Prosvetno Dello, 2006, faqe 40.

6 Boshkoski, Millan dhe Nebi Dervishi, Safet Neziri, Dime Maxhovski dhe Sasho Nikolloski. *Historia 1 - arsimit gjimnazor*. Shkup: Prosvetno Dello, 2009, faqe 50-64, 111-2 dhe 158-9.

Përmbledhje

Nga krahasimi i paraqitjes së prejardhjes të shqiptarëve në tekstet mësimore të historisë të Kosovës, Shqipërisë, Sërbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë, përvijohen dy grupe: në njërin grup janë tekstet e Kosovës e të Shqipërisë, kurse në tjetrin ato të Sërbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë.

Të përbashkëtat e teksteve të Kosovës dhe të Shqipërisë janë, në radhë të parë, teza për vazhdimësinë iliro-shqiptare dhe pastaj shumësia e njësive mësimore për ilirët. Vend qendror në to zënë luftërat. Ilirët glorifikohen, u thuren lavde entuziaste dhe jepen vlerësime pa mbulesë, sidomos ndër tekstet e Kosovës. Nuk paraqiten konfliktet mes fiseve ilire. Shkak i luftërave janë gjithherë prirjet e vazhdueshme hegjemoniste të armiqtve romakë, grekë e maqedonë për t'i futë nën kontroll territoret ilire, përkatësisht pakënaqësia e këtyre me politikën e pavarur të ilirëve, e cila ua prekte interesat, pa dhënë spjegime se cila ishte kjo politikë dhe cilët interesa prekeshin. Ndërsa, shkaku i disfatave të ilirëve janë karakteri lokal i luftërave të tyre mbrojtëse (megjithëse nuk ofrohet sqarim se pse ishin të tilla) ose intrigat që përdornin romakët për përçarjen e tyre. Po ashtu, flitet vetëm për krimet e kryera nga armiqtë romakë, grekë e maqedonë, por jo edhe për krimet e ilirëve ndaj anijeve tregtare romake dhe ngulimeve greke. Nuk përmendet fare as zhvillimi i ekonomisë dhe i kulturës. Ndërkohë 'armiqtë' e ilirëve stigmatizohen, kurse bashkëpunimet me ta ose asimilimi, përkatësisht romanizimi i ilirëve, sidomos në tekstet e Kosovës, nuk pasqyrohen, ndonëse vihet në pah se gjatë kësaj periudhe shumë figura qendrore të administratës ose të ushtrisë romake ishin ilirë në origjinë.

Në anën tjetër, të përbashkëtat e teksteve të Sërbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë janë se nuk merren thuajse fare me prejardhjen e shqiptarëve dhe se nuk i konsiderojnë ata pasardhës të ilirëve, ndajnë më pak njësi mësimore për ilirët, ku mbizotërojnë temat e luftërave dhe ilirët tipizohen negativisht. Këtu si shkaqe luftërash jepen shpeshimet e sulmeve kusare të ilirëve kundrejt romakëve e grekëve. Po ashtu, flitet vetëm për krimet e kryera nga ilirët ndaj anijeve tregtare romake dhe ngulimeve greke, dhe për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës, por jo edhe për krimet e romakëve, grekëve e të maqedonëve ndaj ilirëve. Ndërkaq, 'armiqtë' e ilirëve jo vetëm që nuk stigmatizohen, por pasqyrohen edhe bashkëpunimet e tyre me ilirët, e edhe asimilimi, përkatësisht romanizimi i ilirëve.

Meqë ky kapitull synon të trajtojë prejardhjen e shqiptarëve, po përqendrohemi kryekëput te qëndrimi kategorik i teksteve në Kosovë, e deridiku edhe i teksteve në Shqipëri, se "shqiptarët janë pasardhës të ilirëve", ndërsa shqiptarët e Kosovës pasardhës të fisit ilir të dardanëve. Duhet pasë

parasysh se kjo është një prej hipotezave, ndonëse më e spikatura dhe më mbizotëruesja, sepse përveç hipotezës që i identifikon shqiptarët e hershëm si ilirë (shqipja e ka prejardhjen nga ilirishtja) përvijohet edhe hipoteza rivale që i konsideron shqiptarët e hershëm si thrakë (shqipja e ka prejardhjen nga thrakishtja). Këto hipoteza, që kanë përpunime e variante të mëtejshme, do të ishte mirë të figuronin në tekstet në Kosovë e Shqipëri, por edhe në ato të Sërbisë, të Malit të Zi e të Maqedonisë.

Pohimet e autorëve mbi ngjashmërinë mes zakoneve shqiptare dhe atyre ilire, janë krejt të përgjithësuara dhe duhen marrë me shumë rezervë kur kundrohen secili brendapërbrenda kontekstit kohor vetjak, që fiset e ilirëve antikë i bën dukshëm të ndryshëm nga shqiptarët e sotëm. Njëllor, nuk mund të thuhet në mënyrë të prerë se gjuha ilire ngjante shumë me shqipen e sotme, sa kohë nuk zotërohet as edhe një tekst i ruajtur në ilirisht. Ekzistojnë disa “glosa”, pra komente që shpjegojnë domethëniet e fjalëve, por dëshmitë mbeten marginale dhe të pamjaftueshme për të nxjerrë konkluzione. Mungon çdo lloj njohurie për sistemin gramatikor të ilirishtes, ndërkohë që shtrihet një hendek i tërë kohor ndërmjet ilirishtes dhe shqipes, pasi dokumentimi i shqipes së shkruar fillon tek me “Mesharin” e Gjon Buzukut më 1555.

Përdorimi i sotëm i emrave të njerëzve, si Gent, Teutë, Agron, Bardhyl, e me radhë, nuk mund të përdoret si argument për të dëshmuar ngjashmërinë mes ilirishtes dhe shqipes së sotme. Përdorimi i sotëm i këtyre emrave pasqyron një ndikim të caktuar politik e kulturor të gjysmës së dytë të shekullit XX, ashtu sikurse përdorimi i antroponimeve turke te brezat më të vjetër të shqiptarëve muslimanë, ndër të cilët gjejmë Belkize, Hikmete, Nekibe, Mustafë, Hashim, Ramush, etj. pasqyron ndikim politik e kulturor nga periudha osmane. Duhet thënë këtu se edhe toponimet, pra emrat e vendeve, kryesisht janë mbetje të gjuhëve të mëhershme. Gjithashtu, qytetet, rrënojat e të cilave gjenden edhe sot në hapësirat ku jetojnë shqiptarët, nuk mund të konsiderohen provë e vazhdimësisë iliro-shqiptare, sepse nuk kemi prova nga mbetje materiale që të tregojnë se çfarë gjuhe kanë folë banuesit e tyre, përveç nëse ka mbishkrime, të cilat këtu mungojnë.

Edhe një herë: mund të ketë tregues të një vijimësie iliro-shqiptare, por mungojnë dëshmitë e mjaftueshme për deklarime përfundimtare. Në fund të fundit, siç e thotë me të drejtë Noel Malcolm, prejardhjet bëhen misterioze po i hetuam thellë në të kaluarën dhe gati krejt popujt, kur u hulumtojmë të shkuarën, del se kanë ardhë prej diku dhe kush ka ardhë i pari në një vend nuk është argument që çon farë peshe kur vendoset për të drejtat ose gabimet e një situatë të sotme politike; për më shumë, popujt ose fiset që kanë lëvizë më herët nuk mund të konsiderohen si ndonjë tërësi monolite që nuk i janë nënshtruar

ndryshimeve në identitet prej zhvendosjes nga një vend në tjetrin; dhe, në fund krejt, prejardhjet e të gjithë individëve janë të përziera dhe nuk mund të supozojmë se **të gjithë** paraardhësit tanë kanë qenë të të njëjtës popullatë.

Në fund edhe disa fjalë për glorifikimin e ilirëve, shkaqet e luftërave të ilirëve me fqinjët dhe disfatat e ilirëve nga këto luftëra, për romanizimin dhe bashkëpunimin e ilirëve me 'armiqtë': përtej teksteve të analizuara këtu, edhe libri "Të ndodhurat e Shqypnis prej një geqe që don vendin e vet", ndër librat më dashamirës për historinë e shqiptarëve deri më sot dhe i pari libër në shqip për historinë e shqiptarëve prej ilirëve e deri në fund të shekullit XIX, i botuar më 1898 me autor albanologun e njohur austro-hungarez, Ludwig Thalloczy, vë në pah se ilirët: "kanë plaçkitë anijet e romakëve sa herë kanë pasë mundësi", "kanë qenë të ndarë copë-copë dhe kanë luftuar ndër vete", "kanë refuzuar ta njohin deri edhe mbretin e vet", "kanë shkuar mirë me grekët, të cilët kanë ndërtuar qytete ndër ilirë, siç është Durrësi", "u kanë dhënë ushtarë romakëve dhe e kanë mësuar gjithnjë gjuhën e tyre", "punët e mëdha që ka bërë Leka i Madh i maqedonëve janë bërë me krye të tij e me krahë të ilirëve".⁷

.....
 7 Malcolm, Noel. *Kosova: A Short History*. London: Pan Books, 2002, faqe 22-40; Schmitt, Oliver. *Shqiptarët - një histori midis Lindjes dhe Perëndimit*. Tiranë: K&B, 2012, faqe 41-49; Matzinger, Joachim. *Shqiptarët si pasardhës të ilirëve nga këndvështrimi i gjuhësisë historike*. botuar në librin e përgatitur nga Oliver Schmitt dhe Eva Anne Frantz. *Historia e Shqiptarëve - gjendja dhe perspektivat e studimeve*. Tiranë: Botimet Përpjekja, 2012, faqe 13-39. Thalloczy, Ludwig. *Të ndodhurat e Shqypnis prej një geqe që don vendin e vet*. Shkodër: Botime Françeskane, 2008, faqe 95-122.

2. KOSOVA NË MESJETË DERI NË SUNDIMIN SËRB

Që nga ndarja e Perandorisë Romake në vitin 395 në Perandori të Perëndimit me seli në Romë dhe Perandori të Lindjes (Bizanti) me seli në Kostantinopojë, territori i Kosovës, që atëherë nuk kishte ndonjë rol, mbeti nominalisht nën sovranitetin e Bizantit. Në vitet 547-548 sllavët pushtuan territorin e Kosovës së sotme, e pastaj depërtuan deri në Durrës, kurse vite më vonë u futën deri thellë në Greqi. Gjatë viteve 610-620 sërbët u vendosën në zonën e Rashkës në veri-perëndim të Kosovës të sotme dhe në regionin e sotëm të Malit të Zi, ndërsa në mes të shek. 7, nga tokat bregdetare të Malit të Zi u shtrinë në Shqipërinë veriore. Në vitin 850 bullgarët futën nën kontroll Kosovën, e cila mbeti nën sundimtarë bullgarë deri në vitin 1014-18, kur mbreti Samuel vdiq dhe perandoria iu shthur. Më pas u rivendos pushteti bizantin nën perandorin Basil, dhe për gati dy shekuj Kosova ishte nën Bizantin.

Mungesa e burimeve për periudhat e lartpërmendura bën që prezentimi i tyre në tekstet mësimore të historisë të Kosovës dhe të vendeve përreth të mungojë ose të jetë kryesisht sipërfaqësor. Prandaj ky kapitull synon të hetojë vetëm se si paraqiten: dyndja e sllavëve/sërbëve në Ballkan/Kosovë; sundimi bullgar (850-1018); risundimi bizantin (1018-1216); qëllimet, bashkëpunimet dhe konfliktet e shqiptarëve me të tjerët gjatë këtyre periudhave.

Në tekstet e historisë të Kosovës, në raport me pyetjet e parashtruara, ndër momentet historike të këtyre periudhave mund t'i vërejmë këto pririje:

- fiset sllave dynden në Ballkan nga viti 550-700 dhe formojnë shtetin e tyre në Bullgarinë e sotme, ndërkaq më pas në tokat e të parëve tanë, deri buzë brigjeve të Adriatikut dhe Jonit, vendosen sërbët, kroatët dhe sllovenët; në viset ku sot ndodhen Sllovenia, Kroacia, Bosnja dhe Sërbia, popullsia “arbërore-shqiptare” u zhduk dalngadalë nga banorët sllavë; vetëm në trojet e Shqipërisë së sotme, të Kosovës, dhe të disa krahinave të Maqedonisë, të Malit të Zi e të Greqisë, populli i lashtë shqiptar nuk u zhduk dhe ruajti gjuhën, zakonet dhe kulturën e lashtë, të cilat shqiptarët i trashëguan brez pas brezi; nga shek. 7 ilirët filluan të quhen *arbër* e *albanë*, kurse emri i tyre Arbëri e Albani, sipas fisit ilir të albanëve, që shtrihej në një territor të gjerë mes Krujës e Durrësit; më pas ky emërtim përfshiu të gjithë trevat shqiptare dhe një nga vatrën e formimit të popullsisë arbërore ishte edhe Dardania e lashtë – Kosova e sotme, ku popullsia ilire i ka qëndruar politikës asimiluese të romakëve, të bizantinëve e të sllavëve; arbërit ishin pasardhës të ilirëve dhe ruajtën gjuhën, zakonet dhe kulturën e të parëve dhe ka shumë të dhëna që vërtetojnë si është ruajtur dhe zhvilluar gjuha nga ilirët tek arbërit dhe te shqiptarët e sotëm: shumë emra ilirë qytetesh, malesh, fushash,

lumenjsh, krahinash vazhdojnë të ekzistojnë edhe sot; sendet e gjetura në varret e shqiptarëve të hershëm, si vegla pune, stoli etj., ngjajnë shumë me sendet e këtij lloji që përdornin ilirët, pastaj ngjashmëria duket edhe në veshjet, zakonet, legjendat; shumë toka iliro-arbërore u kolonizuan nga banorë të ndryshëm, veçmas nga sllavët e rezultoi me përzierjen e vendasve dhe të ardhurve, çka në shumë treva diktoi humbjen e identitetit iliro-arbëror.

- sundimi bullgar gati dyshekullor (850-1018) nuk përmendet fare;
- para rreth njëmijë vjetësh, trojet arbërore ishin nën sundim të Perandorisë Bizantine, e këtu përfshiheshin arbërit, grekët, bullgarët, sërbët, rumunët, etj.; principata e parë e Arbërit me kryeqytet Krujën u themelua nga princi Progon më 1190 dhe shtrihej nga lumi Drin deri në lumin Shkumbin - në shtetin e Arbërit nuk përfshiheshin të gjitha vendet e banuara me arbër-shqiptarë; në vitin 1208 në krye të këtij shteti ishte Dhimitri, i cili e pavarësoi shtetin shqiptar nga Bizanti dhe lidhi marrëdhënie miqësore me disa shtete të Europës, duke u bërë shtet i njohur, por që me vdekjen e Dhimitrit (1216), e humbi dalëngadalë rëndësinë⁸.

Tekstet e historisë të Shqipërisë, kundrejt pyetjeve në krye, shfaqin prirjet e mëposhtme:

- sllavët e jugut filluan të hynin në tokat e Perandorisë Bizantine në mes të shek. 6, duke pushtuar një pjesë territoresh me forcë, ndërsa një tjetër ua dha perandori i atëhershëm bizantin; në fund të shek. 7 sërbët pushtuan territoret shqiptare deri në Kosovë e Dukagjin, ato të Malit të Zi të sotëm e rreth liqenit të Shkodrës, si dhe territoret ku sot shtrihet Maqedonia, pjesa lindore e të cilës banohej nga shqiptarët; ndryshe prej popujve të tjerë barbarë që erdhën, shkatërruan dhe u larguan, sllavët u ngulitën në Ballkan, diku i asimiluan vendasit, e diku-diku u tërhoqën ose u asimiluan prej ilirëve; vendosja e sllavëve në Ballkan ngushtoi territoret e ilirëve;
- sundimi bullgar (850-1018) në hapësirat ku aktualisht jetojnë shqiptarët përmendet vetëm telegrafikisht;
- principata e Arbërit me kryeqytet Krujën u themelua më 1190 nga princi Progon dhe shtrihej nga lumi Drin te lumi Shkumbin; trashëgimtarë të Progonit ishin djemtë Gjini e më pas Dhimitri, që lidhi aleanca me Raguzën, Sërbinë, Bizantin, Papatin, e me vdekjen e të cilit principata

8
 8 Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj, *Historia 5*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013, faqe 23-32; Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj, *Historia 6*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013, faqe 97-108; Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj, *Historia 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013, faqe 155-161.

humbi pavarësinë dhe u përfshi në Perandorinë Bizantine; gruaja e Progonit ishte Komnena, vajza e mbretit sërbi Stefan Nemanja.⁹

Në tekstet e historisë në Sëri prirjet janë këto:

- sllavët e jugut fillimisht i sulmonin territoret e Perandorisë Bizantine për t'i plaçkitur, e veç nga mesi i shek. 6 zunë të vendoseshin në gadishullin ballkanik, dhe vetëm në fillim të shek. 7 e pushtuan atë, duke i gjetë këtu grekët, trakët, keltët dhe ilirët e romanizuar – këta të fundit tashmë e kishin pranuar kulturën romake dhe flisnin dialekte të ndryshme të gjuhës latine; fiset sllave u përzier me vendasit dhe popujt fqinj, prandaj një numër i vogël i këtyre fiseve i ka humbur karakteristikat etnike; vendasit që jetonin së bashku dhe që tuboheshin në grupe më të mëdha nuk janë sllavizuar; shqiptarët i kanë ruajtur zakonet, gjuhën dhe karakteristikat e tjera kombëtare; një pjesë sllavësh të ardhur ua morën gjuhën dhe zakonet shqiptarëve duke u përzier;
- përmendet sundimi bullgar dhe bizantin në Sëri e në Ballkan, por jo shprehimisht edhe në Kosovë ose hapësirat ku asokohe jetonin shqiptarët;
- risundimi bizantin (1018-1216) nuk përmendet fare.¹⁰

Prirjet në tekstet e Malit të Zi janë këto:

- sllavët e jugut u vendosën në territorin e Ballkanit në gjysmën e parë të shek. 7 dhe ndërmorën fushata plaçkitëse, duke i sulmuar tokat dhe shkatërruar ekonominë e Bizantit në Ballkan; sllavët shkatërronin fshatra e qytete, zinin robër dhe vrisnin popullsinë greke, romake dhe atë gjysmë të romanizuar, për ç'arsye një pjesë e kësaj popullsie iku në qytetet e fortifikuara të bregdetit, një tjetër gjeti strehim në rajonet e padepërtueshme malore, e prej kësaj popullsie të romanizuar u zhvilluan vllahët e shqiptarët, që s'paraqisnin ndonjë rrezik për sllavët e prandaj mes tyre u vendosën marrëdhënie paqësore.
- sundimi bullgar gati dyqindvjeçar (850-1018) nuk prezantohet fare;
- në burimet historike, shqiptarët shfaqen që nga mesi i shek. 11 si luftëtarë në repartet komandantëve ushtarakë bizantinë, dhe e gjithë zona ku kanë

9 Treska, Tomi dhe Menduh Dërguti. *Historia 6*. Tiranë: Botime Shkollore Albas, 2013, faqe 74-77, 88-89; Dërguti, Menduh, Sonila Boçi dhe Ledia Dushku. *Historia 9*. Tiranë: Botime Shkollore Albas, 2013, faqe 19-21; Treska, Tomi, Menduh Dërguti dhe Abaz Mullaj. *Historia e qytetërimit botëror 11*. Tiranë: Botime Shkollore Albas, 2013, faqe 48-45; dhe Dërguti, Menduh, Ferit Duka, Ledia Dushku dhe Sonila Boçi. *Historia e shqiptarëve 12*. Tiranë: Botime Shkollore Albas, 2013, faqe 40-61.

10 Mihaljčić, Rade. *Istoria 6*. Beograd: Zavod za udžbenike, 2011, faqe 42; Katić, Tatjana dhe Dušan Iljin. *Istorija za I razred gimnazije*. Beograd: Zavod za udžbenike, 2013, faqe 184-87.

banuar ata ka qenë në përbërje të Bizantit; arbërit kanë qenë luftëtarë të zotë, prandaj pushtetmbajtësit i kanë shfrytëzuar në luftërat e shpeshta; kryqëzata e katërt dhe thyerja e Bizantit, ka mundësuar bashkimin e territoreve shqiptare, midis zotërinjve të shumtë feudalë është shquar Dhimitër Progoni, i cili kishte titullin e princit të Arbërit dhe drejtonte Krujën me rrethinën e saj. Progoni ka qenë i martuar me Komnenën, të bijën e Stefan Nemanjës. Pas vdekjes së Progonit, Principata humbi rëndësinë.¹¹

Më poshtë janë edhe prirjet e **teksteve të Maqedonisë:**

- në fund të shek. 6 dhe në dekadat a para të shek. 7 sllavët e jugut e populluan tërësisht gadishullin e Ballkanit, përfshi trevat ilire, deri në Durrës të Shqipërisë; këta i sulmonin dhe plaçkitnin rajonet bizantine në Ballkan; gjatë sulmeve dhe vendosjeve të sllavëve, një pjesë e popullsisë vendase u shpërngul nëpër qytete të fortifikuara, kurse një pjesë e vogël u tërhoq maleve. Vendasit e vjetër mbetën të mbrojtur në viset veriore të Shqipërisë dhe në provincat e dikurshme të Epirit të Ri dhe të Vjetër. Me kohë sllavët u përzien me popullsinë vendase që kishte kulturë më të lartë. Mbetja e popullsisë vendase në Ballkan janë vllahët e sotshëm. Me vendosjen e sllavëve në Ballkan nis sllavizimi: ndërrimi i emrave të qyteteve, fshatrave, maleve, lumenjve, etj.
- në shek. 8 Perandoria Bizantine në Ballkan formoi disa njësi administrative, që u quajtën thema, dhe trojet shqiptare ishin pjesë përbërëse e temës së Durrësit dhe të Nikopojës; në mesin e shek. 9 Bullgaria pushtoi disa rajone shqiptare (Berat, Devoll, rrethina të Vlorës), kurse më vonë, gjatë sundimit të perandorit bullgar Simeon (893-927), kufijtë e saj u zgjeruan më tej nëpër tokat shqiptare: Vlorë, Himarë, Butrint, e më pas edhe Nikopojë e Durrës; në gjysmën e dytë të shek. 10 territoret shqiptare u futën në përbërje të shtetit të perandorit Samoil (të cilin këto tekste e konsiderojnë maqedonas), por pushtimet e tij nuk qenë të qëndrueshme, prandaj shtetin ia shkatërroi perandori bizantin Vasili 2 në vitin 1018 dhe kësaj trojet shqiptare ranë prap në sundimin bizantin.
- shqiptarët në burimet historike për herë të parë përmenden në mesin e shek. 11, kurse në shek. 12 me emrin *shqiptar* quhen banorët që shtriheshin në territorin e sotëm të Shqipërisë. Në fund të shek. 12 në Shqipëri sundonte principata e Arbërit, me qendër Krujën, e udhëhequr nga Progoni, e pas vdekjes së tij nga bijtë Gjini e Dhimitri. Kulmin e fuqisë kjo

.....

11 Popoviq, Radovan dhe Dragan Miranoviq, *Historia 7*. Podgoricë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 2006, faqe 11-12, 21, 50-55 dhe 69; Popoviq, Radovan dhe Dragan Miranoviq e Dragoje Gjokiq, *Historia 2*. Podgoricë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 2006, faqe 100-101.

principatë e arriti nën drejtimin e Dhimitrit, i cili u martua me Komnenën, vajza e mbretit sërb Stefan Nemanja dhe mbesa e perandorit bizantin.¹²

Përmbledhje

Duke krahasuar portretizimin e periudhës së shfaqjes dhe vendosjes së sllavëve në Ballkan nëpër tekstet mësimore të historisë të Kosovës, Shqipërisë, Sërbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë, del në pah se plaçkitjet, sulmet dhe shkatërrimet e sllavëve gjatë shtirjeve të tyre, përmenden në të gjitha tekstet mësimore, por për çudi jo shprehimisht edhe nëpër tekstet e Kosovës. Gotët gjermanë, hunët dhe bullgarët, kishin provuar të vendosen në këto treva para sllavëve, por asnjë prej teksteve të këtyre vendeve nuk përmend se sllavët nuk ishin të parët që u vendosën në këto hapësira duke kërkuar jetë më të mirë. Asnjë popull tjetër nuk la gjurmë në Ballkan sikur sllavët, të cilët e shkatërruan kulturën antike qytetare, organizimin kishtar të krishterë dhe e ndryshuan përbërjen etnike të popullsisë, por shtrirja e tyre në Ballkan u bë në grupe të vogla e pa struktura të qarta, madje shpesh të komanduara nga elita luftarake joslave.

Në kapitullin paraprak u tha se e përbashkëta e teksteve të Kosovës dhe të Shqipërisë ishte teza për vazhdimësinë iliro-shqiptare. Në linjë me këtë, vendosja e sllavëve në Ballkan përshkruhet nëpër këto teskte edhe si ngushtim i territoreve iliro-arbërore. Edhe po ta marrim të mirëqenë prejardhjen ilire të shqiptarëve, kjo nuk nënkupton se të gjitha fiset ilire që jetonin nëpër gadishullin ballkanik – Sërbë, Mal i Zi, Bosnjë, Kroaci e Slloveni – janë paraardhës të shqiptarëve, siç pretendojnë tekstet e Kosovës, por edhe ato të Shqipërisë. Me pohimin se “populli shqiptar nuk u zhduk vetëm në Shqipëri, Kosovë, disa pjesë të Maqedonisë, Malit të Zi e Greqisë”, tekstet e Kosovës sikur tentojnë ta projektojnë qenësinë e sotme etnike të shqiptarëve edhe në mesjetë, por edhe shtrirjen e tanishme të tyre në Ballkan. Ky pohim bie ndesh me të dhënën se pas dyndjes së sllavëve në Ballkan, një pjesë e popullsisë vendase u shpërngul në qytetet bregdetare, ndërsa një tjetër gjeti strehim rajoneve të padepërtueshme malore, kryesisht në viset veriore të Shqipërisë së sotme.

Nderkaq, përzierjet e popullsisë vendase mesllavët, tekstet e Kosovës i prezantojnë njëkahshëm: “humbje e identitetit iliro-arbëror”, por kështu bëjnë edhe tekstet e

12 Boshkoski, Millan, Jordan Ilioski dhe Nebi Dervishi. *Historia 6*. Shkup: Prosvetno Dello, 2008, faqe 19-29 dhe 71-71; Boshkoski, Millan, Nebi Dervishi, Safet Neziri, Dime Maxhovski dhe Sasha Nikolloski. *Historia 1 arsimi gjimnazor*. Shkup: Prosvetno Dello, 2009, faqe 154-159; Pavlovski, Gjorgji, Dime Maxhovski dhe Jovo Ratković. *Historia 1 gjimnazi I reformuar*. Shkup: Prosvetno Dello, 2002, faqe 91-97; Boshkoski, Millan, Jordan Ilioski, Gjorgji Isajllovski, Vllado Vellkoski, Miroslav Boshković dhe Simeon Naumovski. *Historia 1 arsimi i mesëm profesional*. Shkup: Prosvetno Dello, 2006, faqe 77-80; Boshkoski, Millan, Nebi Dervishi, Silvana Sidorovska – Čupovska, Natasha Kotlar, Jordan Ilioski, Dimko Popovski. *Historia 2 arsimi gjimnazor*. Shkup: Prosvetno Dello, 2008, faqe 26-31.

Sërbisë: “humbje të karakteristikave etnike të fiseve sllave, që morën gjuhën dhe zakonet e shqiptarëve”. Për më tej, tekstet e Sërbisë thonë se “vendat që jetuan së bashku e që u tubuan në grupe më të mëdha nuk u sllavizuan”, dhe shtojnë se “shqiptarët i ruajtën zakonet, gjuhën dhe karakteristikat e tjera kombëtare”. Në tekstet e Shqipërisë këto përzierje prezentohen ndërsjelltazi, siç edhe kanë qenë: “kur sllavët u ngulën në Ballkan, diku i asimiluan vendat, e diku u asimiluan nga ata”. Tekstet e Malit të Zi thonë se “shqiptarët nuk paraqitnin ndonjë rrezik për sllavët, prandaj mes tyre u vendosën marrëdhënie paqësore”, kurse ato të Maqedonisë vetëm sa i përmendin përzierjet.

Sundimi gati dyshekullor (850-1018) bullgar / maqedon në Kosovë, përkatësisht nëpër hapësirat ku jetojnë sot shqiptarët, në tekstet e Kosovës, të Sërbisë dhe të Malit të Zi nuk përmendet fare, kurse në tekstet e Shqipërisë përmendet krejt shkurt, e në ato të Maqedonisë pakëz më gjerësisht. Me gjithë mungesën e burimeve për këtë periudhë, të përmendur në krye të këtij kapitulli, tekstet e Kosovës, Sërbisë, Malit të Zi, por edhe ato të Shqipërisë, do të duhej ta prezentonin të paktën në vija të trasha këtë sundim gati dy shekuj të gjatë, nga i cili kanë mbetë shumica e toponimeve në arealin shqiptar.

Risundimi bizantin (1018-1216) në Kosovë, përkatësisht në hapësirat e sotme me shqiptarë, nuk prezentohet fare në tekstet e Sërbisë, kurse në ato të Kosovës, Shqipërisë, Malit të Zi dhe të Maqedonisë, paraqitet vetëm principata e Arbërit (1190-1216), me qendër në Krujë, e themeluar nga Progoni dhe e udhëhequr më pas nga i biri, Dhimitri. Tekstet e Kosovës e paraqesin principatën e Arbërit si shtet, por në të vërtetë ndërsa Bizanti sundonte rajoneve bregdetare, në trevat maloret lejonte vetëqeverisje përmbytësore nga feudalët lokalë.

Sa i takon bashkëpunimeve të shqiptarëve me të tjerët, tekstet e Kosovës flasin për marrëdhëniet miqësore që Dhimitri kishte lidhë me disa shtete të Europës, por nuk thonë me cilat, e shumica e këtyre teksteve nuk e përmendin aleancën e tij me Sërbinë ose të dhënë se gruaja e tij, Komnena, ishte vajza e mbretit sërb Stefan Nemanja. Kjo e dhënë jepet në tekstet e Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë. Një tjetër bashkëpunim i shqiptarëve me të tjerët, që jepet vetëm në tekstet e Malit të Zi është se: “...shqiptarët, ngaqë ishin luftëtarë të zotë, pushtetmbajtësit i shfrytëzonin në luftërat e shpeshta si luftëtarë në repartet e komandantëve ushtarakë bizantinë”.¹³

13 Malcolm, Noel. *Kosova: A Short History*. London: Pan Books, 2002, faqe 40-44; Schmitt, Oliver. *Shqiptarët – një histori midis Lindjes dhe Perëndimit*. Tiranë: KËB, 2012, faqe 49-59; Schmitt, Oliver. *Kosova: histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*. Prishtinë: Koha, 2012, faqe 37-39; Schmitt, Oliver. “Monada e Ballkanit” *Shqiptarët në Mesjetë*. botuar në librin e përgatitur nga Oliver Schmitt dhe Eva Anne Frantz. *Historia e Shqiptarëve – gjendja dhe perspektivat e studimeve*. Tiranë: Botimet Përpjekja, 2012, faqe 67-90; Bartl, Peter. *Shqipëria nga Mesjeta deri Sot*. Prizren: Drita, 1999, 24-31.

3. KOSOVA NË MESJETË GJATË SUNDIMIT SËRB

Në vitin 1160 në Rashkë (embrioni i shtetit sërb) doli në skenë një familje e re sundimtarësh, që mbretëroi në Sërbë për gati 200 vjet, themelues i të cilës ishte Stefan Nemanja. Duke përfitur nga dobësimi i Perandorisë Bizantine në vitet 1180, me mbështetjen e Hungarisë dhe të Venedikut, Nemanja e përmbysi sundimin e Bizantit dhe e zgjeroi sundimin e vet në të gjitha drejtimet, përfshirë disa pjesë të Kosovës në vitet 1184-5. Kur Stefan Nemanja abdikoi, më 1196, Sërbë përfshinte tërë Kosovën Lindore. Trashëgimtari i tij Stefan Nemanjić, duke shfrytëzuar pasojat politike të pushtimit të Konstandinopojës nga avanturierët e Kryqzatës së Katërt, diku para vitit 1208, e pushtoi gati tërë Kosovën Perëndimore, pa Prizrenin, kurse më së voni më 1216 edhe Prizrenin, duke e futë kështu nën sundim pothuajse krejt territorin e Kosovës. Në vitin 1217 Stefani u kurorëzua Mbret i Sërbisë nga Legati i Papës, i dërguar enkas nga Roma, dhe në histori njihet si Stefani i Parë i Kurorëzuar. Deri më 1415 territori i Kosovës sundohet nga shteti sërb.

Ky kapitull heton konkretisht se si prezentohen nëpër tekste: pushtimi sërb i territorit të Kosovës (që fillon më 1184-5 dhe përmbyllet më së voni më 1216); sundimi sërb i Kosovës (1216 deri më 1389); Beteja e Kosovës (1389); dhe, krejt në fund, vitet e fundit të Sërbisë mesjetare në Kosovë (1389-1415).

Në raport me temat e mësipërme, kjo është bërthama e shtjellimeve që bëjnë **tekstet e Kosovës**:

- Në disa tekste, siç është ai i klasës së pestë, nuk përmendet fare pushtimi mesjetar sërb, e në disa tekste tjera, siç janë ato të klasës së dhjetë të të gjitha drejtimeve, përmendet krejt telegrafikisht se gjatë kësaj periudhe, viset e banuara me shqiptarë u pushtuan, mes tjerash, edhe nga shteti sërb.
- Tekstet e Kosovës përqendrohen vetëm te sundimi sërb nën Mbretin Stefan Dušan (1331-1355) dhe ky është përmbledhtazi narracioni nën këtë sundim: Mbreti Dušan pushtoi mbarë Shqipërinë dhe pjesën më të madhe të Ballkanit, me çka sundimi bizantin në trojet arbërore përfundoi përgjithmonë. Dušan-i nuk e njohu as formalisht ekzistencën e Principatës së Arbërisë. Në tokat e pushtuara vendosi administratën e vet dhe ngriti Kishën Sërbe në shkallë të patriarkanës, qendra e të cilës ishte në Pejë. Pushtuesit sërbë ushtruan shtypje dhe diskriminim të egër ekonomik, shoqëror e fetar ndaj shqiptarëve, por me gjithë këto vështirësi, shqiptarët e ruajtën qenien e vet, madje herë-herë u ngritën edhe në kryengritje kundër sundimit të Mbretit Dušan. Qëndresa shqiptare gjeti përkrahjen e vendeve europiane, madje papët e Romës reagonin, jo vetëm kundër konvertimit me dhunë të shqiptarëve katolikë në ortodoksë, por edhe kundër shtypjes së shqiptarëve. Megjithëse gjatë

pushtimit procesi i kolonizimit të tokave shqiptare, veçmas në Kosovë, mori përpjestime të gjera, popullsia shqiptare i bëri ballë këtij presioni, duke e vazhduar qëndresën dhe duke e ruajtur shqiptarësinë e këtyre trojeve.

- Me vdekjen e Mbretit Dušan më 1355, që shënon fundin e perandorisë së tij, bujarët shqiptarë filluan përpjekjet për të krijuar principatat e pavarura (Principata e Shkodrës – Balshajt, Principata e Durrësit – Topiajt, dhe Principata e Artës - Shpatajt). Principata e Balshajve, me qendër Shkodrën, përfshinte në zotërimet e veta një pjesë të madhe të territorit të Kosovës dhe një pjesë e territorit të sotëm të Malit të Zi (Zeta). Balsha II ishte princi më i shquar i kësaj familjeje. E quante veten Princ i Arbërisë dhe synonte bashkimin e të gjitha trojeve etnike shqiptare në një shtet të vetëm, por nuk ia doli, ndonëse principata e tij mori përmasat e një shteti pothuajse mbarëshqiptar. Sundimtari i ri i kësaj principate u bë Gjergji II Balsha, por ajo më nuk e pati as fuqinë e as shtrirjen e mëparshme territoriale. Kishte konflikte mes principatave shqiptare, si p.sh. mes principatës së Topiajve dhe të Balshajve.
- Në gjysmën e dytë të shekullit 14, për t'i bërë ballë kanosjes së pushtimit osman, feudalët shqiptarë, sërbë, bullgarë, rumunë, etj., formuan një bashkim ushtarak, në krye me princin sërb Lazar, ku merrnin pjesë edhe repartet shqiptare të drejtuara nga princat e tyre: Muzaka, Balsha, etj. Në vitin 1389 u zhvillua një betejë e ashpër afër Prishtinës, ku mendohet se luftëtari Millosh Kopili, nga fshati Kopiliq i Drenicës, e vrau Sulltan Muratin. Të dy ushtritë pësuan humbje të mëdha. Në këtë betejë u vra edhe princi shqiptar Teodor Muzaka dhe shumë princa të vendeve të tjera. Në përfundim të luftës, ushtritë ballkanike u thyen. Osmanët vazhduan pushtimin e vendeve ballkanike një nga një. Ndërkaq teksti 'Historia 7' jep: "...thuhet se Sulltanin e vrau Millosh Kopiliqi, por burimet nuk e sqarojnë këtë çështje mirë, e nuk është e qartë as përkatësia e tij etnike; ende për shumë çështje nuk është thënë fjala e fundit e historianëve". I njëjti tekst për Betejën e Kosovës thotë "...ka mjaft të dhëna gojore, këngë epike, por vërtetësia e tyre është e pasigurtë; janë sajuar shumë situata të paqena".
- Pas përfundimit të sundimit të Mbretit Dušan më 1355, përveç Betejës së Kosovës më 1389, nuk prezentohet asnjë episod i sundimit sërb në Kosovë, i cili zgjatë deri më 1415.¹⁴

.....
 14 Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj, *Historia 5*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013, faqe 25-36; Bicaj, Isa dhe Arbër Salihu. *Historia 7*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013, faqe 40-52, 55-57; Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj. *Historia 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013, faqe 155-168.

Bërthama e shtjellimeve që bëjnë **tekstet e Shqipërisë** është kjo:

- Stefan Nemanja (1168-1196) vlerësohet si themelues i shtetit serb. I biri i tij, Sava, më 1250, në qytetin e Pejës e vendosi qendrën e kishës autoqefale serbe. Kulmin e vet ky shtet e arriti në kohën e Mbretit Stefan Uroš II, kur, me nënshkrimin e paqes me Bizantin në vitin 1299, Mbretërisë Serbe i njihen territoret e pushtuara mbi Ohër e Durrës. Në periudhën e fuqizimit, shteti serb vendosi sundimin e vet mbi Kosovën.
- Në çerekun e dytë të shekullit 14 shteti serb filloi të forcohej dhe, nën sundimin e Mbretit Dušan, arriti të pushtojë pjesën më të madhe të Ballkanit, përfshi të gjitha territoret shqiptare, duke e formuar kështu Perandorinë Serbe. Pronarët shqiptarë u zëvendësuan me pronarë serbë. Serbët vendosën kudo kolonë, veçanërisht në Kosovë, ndërtuan shumë manastire ortodokse serbe dhe shumë emra vendesh i zëvendësuan me emra sllavë. Edhe në postet më të larta të administratës shtetërore gjendeshin vetëm serbë. Sot nga ajo periudhë kanë mbetur disa toponime me origjinë sllave. Gjatë sundimit serb u organizuan mjaft kryengritje të fuqishme antisërbe, që përfshinë të gjitha trojet. Lëvizja antisërbe u bë edhe më e fuqishme pas vdekjes së Mbretit Dušan, më 1355, duke i detyruar shumë sundimtarë serbë të largoheshin nga zotërimet e tyre.
- Me vdekjen e Mbretit Dušan dhe rënien e Perandorisë Serbe feudalët e nënshtruar josërbë u bënë të pavarur dhe krijuan principatat e tyre. Shumë qytete u zhvilluan dhe u bënë qendra të kulturës kombëtare. Në territoret shqiptare u krijuan disa principata, si ajo e Artës, Muzakajve, Topiajve, Balshajve, etj. Principata e Balshajve zotëronte territoret e Shqipërisë Veriore, përfshinte edhe territoret perëndimore të Kosovës, siç janë qytetet Pejë e Prizren. Kjo principatë sundohej nga Plaku Balsha dhe tre djemtë e tij: Strazimi, Gjergji dhe Balsha II. Balshajt u afruan me Papatin, u kthyen në ritin katolik (më parë ishin ortodoksë). Krijuan një shtet të organizuar me aparat administrativ, gjykata, burgje, thesar, etj. Në politikën për zgjerim, Balshajt u kundërshtuan nga Topiajt, me të cilët zhvilluan shumë beteja, por kryesorja ishte ajo në fushën e Savrës, afër Lushnjës, ku, me ndihmën e ushtrisë turke, Topiajt thyen Balshajt. Pushtimet osmane i dhanë fund sundimit të Balshajve.
- Ndër ngjarjet më të rëndësishme të fillimit të pushtimit osman nën drejtimin e Sulltan Muratit I në Ballkan ishte edhe Beteja e Kosovës e vitit 1389, e zhvilluar në Fushë Kosovë ose në Fushë Dardani (afër Prishtinës). Ushtria ballkanase drejtohej nga Mbreti serb Lazar. Në betejë morën pjesë princa shqiptarë, si Gjergj Balsha II, Gjon Kastrioti, Teodor Muzaka, etj. Gjatë luftimeve, trimi shqiptar Millosh Kopili vrau Sulltan Muratin I, por ballkanasit pësuan humbje dhe ushtria osmane i

nënshtroi plotësisht territoret e Ballkanit dhe shumë mbreta e princa e pranuan sundimin osman dhe u kthyen në vasalë të sulltanit. Teodor Muzaka u vra në betejën që u zhvillua në Fushë Kosovë (1389).

- Pas përfundimit të sundimit të Mbretit Dušan më 1355, përveç Betejës së Kosovës më 1389, nuk prezentohet asnjë episod i sundimit sërb në Kosovë, i cili zgjatë deri më 1415.¹⁵

Prirjet në **tekstet e Sërbisë** janë këto:

- Duke shfrytëzuar trazirat në Perandorinë Bizantine, Stefan Nemanja (1166-1196), i cili synonte bashkimin e të gjitha tokave sërbe, zgjeroi konsiderueshëm shtetin sërb. Përveç zonave përreth Moravës Perëndimore, Moravës së Madhe dhe Kosovës, ai futi nën kontroll edhe pjesë të Shqipërisë së Veriut. Djali i tij, Nemanjić, e pavarësoi shtetin sërb, kurse dy vite më vonë djali tjetër, Sava, e pavarësoi kishën sërbe.
- Sundimi sërb në Kosovë vihet në pah kur përmendet kultura mesjetare sërbe: Manastiri i Graçanicës, ndërtuar nga Mbreti Milutin, Manastiri i Deçanit, ndërtimin e të cilit e kishte nisë Stefan Dečanski, e e kishte përfunduar biri i tij Stefan Dušan; Kisha e Levishës në Prizren, Patriarkana e Pejës, e me radhë. Ky sundim spikatet edhe kur përmenden minierat që kanë ndikuar në forcimin e ekonomisë të Sërbisë, si Brskova dhe Rudnik në territorin e Sërbisë dhe në Kosovë Trepça e Novobërda. Sa i takon Perandorisë Sërbe nën Mbretin Dušan thuhet se ajo përfshinte edhe një pjesë të madhe të territoreve shqiptare.
- Sulltan Murati kishte mbledhë skuadra nga pjesë aziatike dhe europiane të Perandorisë Osmane dhe ishte ndihmuar edhe nga luftëtarë të krishterë. Djemtë e tij Bajaziti dhe Jakupi ishin udhëheqës ushtarak. Mbreti Lazar nuk kishte arritë t'i mbledhte të gjithë fisnikët dhe luftëtarët sërbe. Nga sundimtarët regjional sërb i ishte bashkuar Vuk Branković, sundimtar i Kosovës, si dhe Mbreti boshnjak Tvrtko I. Beteja është zhvilluar më 28 qershor 1389 në Fushë Kosovë afër Prishtinës. Rezultatet përfundimtare të betejës nuk dihen. Në të dy anët ka pasë mjaft të vdekur, ku kanë humbë jetën të dy sundimtarët, Mbreti L Lazar dhe Sulltan Murati, i cili u vra nga luftëtari fisnik sërb Miloš Obilić (Kobilić), për të cilin historia nuk ka të dhëna të tjera. Dhëndri i Mbretit Lazar, Vuk Branković, nën sundimin e të cilit ka qenë territori ku është

.....
 15 Treska, Tomi dhe Menduh Dërguti. *Historia 6*. Tiranë: Botime Shkollore Alban, 2013, faqe 121-125; Dërguti, Menduh, Sonila Boçi dhe Ledia Dushku. *Historia 9*. Tiranë: Botime Shkollore Alban, 2013, faqe 22-23, 27; dhe Dërguti, Menduh, Ferit Duka, Ledia Dushku dhe Sonila Boçi. *Historia e shqiptarëve 12*. Tiranë: Botime Shkollore Alban, 2013, faqe 55, 58-59, 73.

zhvilluar beteja, ka marrë pjesë në betejë, por jo edhe dhëndri tjetër i Lazarit, Gjuraq II Balshić, i cili kishte pasë lidhje me turqit.

- Nuk prezentohet asgjë për themelimin e principatave shqiptare pas vdekjes së Mbretit Dušan, e as për principatën e Balshajve që kishte nën zotërim një pjesë të territorit të Kosovës.
- Pas përfundimit të sundimit të Mbretit Dušan më 1355, përveç Betejës së Kosovës më 1389, nuk prezentohet asnjë episod i sundimit sërb në Kosovë, i cili zgjatë deri më 1415.¹⁶

Në **tekstet e Malit të Zi** bërthama e zhvillimeve është kjo:

- Pas vdekjes së Perandorit bizantin Komnen (1143-1180), duke shfrytëzuar dobësimin e Bizantit dhe ndihmën e hungarezëve, Stefan Nemanja (1166-1196) e zgjeroi shtetin feudal sërb, duke pushtuar, mes tjerash, Kosovën e Hvosnën (Metohinë) dhe pjesë nga veriu i Shqipërisë së sotme.
- Më pas, i biri i Mbretit Nemanja, Nemanjić (1196-1228) e ngriti shtetin sërb në rang mbretërie (1217) dhe mori kurorën nga Papa i Romës si Stefani I i Kurorëzuar, duke e pavarësuar më 1219 kishën sërbe. Gjatë sundimit të djalit të tij, Uroš I (1243-1276), shteti sërb u zhvillua ekonomikisht – minierat më të rëndësishme të kohës, mes tjerash, ishin: Rudnik, Brskovo, Trepça, Janjeva dhe Novobërda, që ishte më e njohura. Me zhvillimin e minierave në Sëri u formuan vendbanimet qytetare: Rasi, Lipjani, Prizreni, më vonë Nishi, Shkupi, e me rëndësi ishin edhe qytetet bregdetare si Kotori, Budva, Bari, Ulqini, dhe Shkodra. Ky zhvillim u mundësoi sundimtarëve të ardhshëm t'i pushtonin territoret e fqinjëve. Djali i Uroš-it I, Milutin-i (1282-1321), i cili ndërtoi Manastirin e Graçanicës, e pushtoi Maqedoninë Veriore dhe e çoi kryeqytetin e vet në Shkup. Politikën e zgjerimit e vazhdoi edhe pasardhësi i Milutin-it, Dečan-i (1321-1331), që njihet për ndërtimin e Manastirit të Deçanit, e më pas edhe djali i tij, Dušan-i (1331-1355), i cili pushtoi Maqedoninë, Shqipërinë, Greqinë Veriore e të Mesme dhe rrezikoi edhe ekzistencën e Perandorisë Bizantine. Sundimi i tij u ndërpre me vdekjen e tij të papritur, në prag të sulmit të planifikuar në Konstantinopojë.
- Gjatë sundimit të Stefan Dušan-it, me përjashtim të Durrësit, në përbërje të shtetit sërb ishte gjithë territori i Shqipërisë së sotme, të cilin ky e pushtoi me përkrahjen e fisnikërisë shqiptare. Fisnikë të veçantë shqiptarë fituan tituj të lartë oborrtarë dhe ishin məkëmbës të territoreve të mëdha. Pas vdekjes së Dušan-it u forcua pushteti i këtyre feudalëve

16 Mihaljčić, Rade. *Istoria 6*. Beograd: Zavod za udžbenike, 2011, faqe 86-98, 104-114, 118-119; Katić, Tatjana dhe Dušan Ilijin. *Istoriya za I razred gimnazije*. Beograd: Zavod za udžbenike, 2013, faqe 243-245;

arbërorë. Fisnikët shqiptarë luftonin mes vete për ta zgjeruar pushtetin vetjak në territore sa më të mëdha, e nganjëherë i përfshinin në këto luftime edhe venedikasit dhe osmanët. Nga gjysma e shekullit 14 e deri tek pushtimi osman, u ndërruan shpesh zotërinjtë e mëdhenj, të lindur nga radhët e drejtuesve të fiseve, familjet më të njohura të të cilave ishin: Topiajt, Muzakajt, Arianiti, Zenebishti, Shpati etj. Në hapësirat malore, shqiptarët, deri në shekullin 15 jetonin nëpër bashkësi fisnore, tek të cilat ndihej krejt pak ndikimi i pushtetit shtetëror që ndërrohej shpesh. Falë të drejtës tradicionale, drejtuesit e fiseve të këtyre bashkësive kishin pozitë të veçantë. Ata luanin rolin e ndërmjetësuesit mes fisit dhe pushtetit shtetëror, prandaj sundimtarët bizantinë, anzhuinë dhe sërbë u jepnin tituj dhe ua besonin drejtimin e fiseve. Arbërit ishin luftëtarë të zotë, prandaj pushtetmbajtësit i shfrytëzonin në luftërat e shpeshta.

- Në këto tekste nuk përmenden Balshajt në mesin e familjeve feudale shqiptare. Thelbi i narracionit për këtë familje është ky: pas vdekjes së Dušan-it, shteti sërb nuk mundi t'u rezistonte trysnive të fisnikërisë, prandaj tre djemtë e Balshës, Strazimiri, Gjuragji dhe Balsha II Balshiq, shfrytëzuan këtë gjendje dhe rreth vitit 1360 rindërtuan shtetin e Zetës (Malit të Zi), ku Gjuragj I ishte më i rëndësishmi dhe kishte fjalën kryesore në familje. Ai e futi nën sundim edhe Prizrenin, kurse pas martesës të të vëllait, Balshës II, me vajzën e despotit të Vlorës, edhe Vlorën, Beratin e Himarën. Po ashtu, nipi i Balshës II, Gjuragj II, u martua me Elenën, vajzën e Mbretit sërb Lazar. Mbreti hungarez Zigmund i jep titullin "Sundimtar i Shqipërisë". Gjuragj II që trashëgohet nga Balsha III, sjell në ushtri mercenarë, shqiptarë e osmanë. Ai shkon te daja i vet Stefan Lazarević në Beograd, ku edhe vdes, ndërsa pronat ia lë dajës, meqë nuk kishte trashëgimtarë mashkuj. Nëna e tij u bë vasale e Perandorisë Osmane.
- Pas vdekjes së Dušan-it, shteti sërb u dobësua dhe kështu zotërinjtë feudalë mëvetësuan territoret e veta. Në mesin e të parëve që u mëvetësuan ishin Ballshiqët në Mal të Zi. Në ndeshjet e vazhdueshme mes feudalëve, si sundimtar më i fuqishëm doli Lazar Hrebëlanović, i cili arriti që para luftës kundër osmanëve t'i mblidhte feudalët e ngatërruar, të vinte paqen me Hungarinë, dhe ta siguronte ndihmën ushtarake të Bosnjës. Në Vidovdan, më 28 qershor 1389 në Fushë Kosovë, afër Prishtinës, u ndeshën ushtria turke (e udhëhequr nga Sulltan Murati I, e komanduar nga djemtë e tij Bajaziti dhe Jakupi) dhe ushtria sërbe (e udhëhequr nga Mbreti Lazar dhe e komanduar nga dhëndri i tij Vuk Branković, sundimtar i Kosovës dhe Metohisë, si dhe Vlatko Vuković, i dërguar nga Mbreti boshnjak Tvrtko). Pak dihet për zhvillimin e kësaj beteje. Sipas tregimit të Kostandin Filozofit, biografit të Lazar-it, një fisnik

sërb, në një moment të përshtatshëm, duke u shtirë se po dorëzohej, e vret Sulltan Muratin. Më vonë kënga popullore këtë fisnik e quajti Miloš Obilić. Pas vdekjes së Sulltan Muratit, i biri i tij, Bajaziti, e vrau vëllanë e vet, Jakupin, mori komandën dhe korri fitore. Princi Lazar u zu rob dhe u vra menjëherë. Serbia mbeti shtet vasal nën pushtetin osman. Beteja e Kosovës është bërë objekt legjendash, të stolisura me një varg trillimesh: Darka e Kosovës, Mbreti Lazar kalon në Perandorinë e Qiellit, Tradhtia e Vuk Branković-it, etj.

- Pas përfundimit të sundimit të Mbretit Dušan më 1355, përveç Betejës së Kosovës më 1389, nuk prezantohet asnjë episod i sundimit sërb në Kosovë, i cili zgjatë deri më 1415.¹⁷

Përmbajtja e **teksteve të Maqedonisë** ka këtë thelb:

- Pushtimi mesjetar sërb i territorit të Kosovës nuk prezantohet fare, ndërkaq sa i takon sundimit sërb mesjetar thuhet se në fund të shekullit 12 e në fillim të shekullit 13 kultura sërbe shënoi zhvillim të madh dhe gjatë kësaj periudhe u ndërtua edhe kisha luksoze e Graçanicës afër Prishtinës, Studenica, Manastiri i Deçanit dhe Manastiri i Hilandarit.
- Këto tekste përqendrohen vetëm në kohën e Stefan Dušan-it, Serbia e zotëronte shtrirjen më të madhe, sepse në luftimet me Bizantin, ai ia dyfishoi territorin. Në vitin 1346, në Shkup, Dušani u kurorëzua si perandor, por Bizanti nuk ia njohu këtë titull. Në vitin 1348, Dušani e pushtoi tërë Shqipërinë. Feudalët shqiptarë ishin të pakënaqur nga pushtimi sërb, sepse iu ndërpre vetadministrimi i përhershëm lokal, prandaj herë pas here bënë revolta e kryengritje kundër sundimtarëve sërbe. Pas vdekjes, Dušan-in e trashëgoi i biri, Uroš-i, që ishte sundimtar i dobët, pasi në kohën e tij Perandoria Sërbe u shkatërrua në principata më të vogla. Në Shqipëri u forcuan feudalët e vendit dhe filluan të shkëputeshin nga shteti.
- Pas vdekjes së Dušan-it dhe dobësimit të perandorisë sërbe, u përforcuan feudalët e vendit. Familjet më të mëdha feudale që krijuan principatat e veta ishin: Topiajt, që udhëhiqnin Principatën e Durrësit, në krye të të cilës qëndronte Karl Topia, i quajtur “Princ i Shqipërisë”); Balshajt që drejtonin Principatën e Shkodrës, e që u zgjeruan në veri kah territoret sërbe; Muzakajt; Zenebishtët, etj. Principata e Balshajve, në krye me Balshën II, synonte të krijonte një shtet të përbashkët, por lufta me

17 Popoviq, Radovan dhe Dragan Miranoviq, *Historia 7*. Podgoricë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 2006, faqe 25, 52-55, 64-67, 69-73; Popoviq, Radovan dhe Dragan Miranoviq e Dragoje Gjokiq, *Historia 2*. Podgoricë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 2006, faqe 39-40, 80-83, 100-104.

Principatën e Durrësit dhe disfata në Betejën e Savrës nga osmanët në vitin 1385 e dobësuan atë.

- Në vitin 1389, Sulltan Murati I me një ushtri të madhe u nis drejt Sërbisë. Kjo i detyroi feudalët ballkanikë të krijonin një koalicion antiosman. Beteja vendimtare u zhvillua në Fushë Kosovë. Ushtrinë sërbe e udhëhoqi princi Lazar, të cilit i erdhi në ndihmë edhe sundimtari i Bosnjës. Në këtë betejë u vranë të dy sundimtarët: Princi Lazar dhe Sulltan Murati. Udhëheqësi ushtarak sërb Miloš Obilić, me dinakërinë se po dorëzohej, hyri në tendën e Sulltan Muratit I dhe e vrau me shpatë. Beteja e Kosovës ishte vendimtare për rënien e viseve ballkanike nën sundimin osman. Princi Lazar u trashëgua nga i biri, i cili u bë vasal osman. Shtetet feudale ballkanike, të përçara, u bënë vasale të sulltanit. Principatat shqiptare u bënë shpejt pre e lehtë, ndërsa ato sërbe bënë qëndresë më gjatë.
- Pas përfundimit të sundimit të Mbretit Dušan më 1355, përveç Betejës së Kosovës më 1389, nuk prezantohet asnjë episod i sundimit sërb në Kosovë, i cili zgjat deri më 1415.¹⁸

Përmbledhje

Pushtimi sërb i territorit të Kosovës, që fillon më 1184-5 dhe përmbyllet më së voni më 1216, prezantohet krejt telegrafikisht në tekstet e Kosovës, Shqipërisë, Sërbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë. Ndërkaq, sa i përket sundimit sërb në Kosovë prej përmbylljes së pushtimit sërb më 1216 e deri te Beteja e Kosovës më 1389, përvijohen dy grupe: në njërin anë janë tekstet e Kosovës e të Shqipërisë, e në tjetrën, në një farë mënyre, ato në Sërbisë, deri diku të Malit të Zi, si dhe tekstet e Maqedonisë.

Ndërsa pushtimin e Kosovës nën Mbretin Stefan Nemanja (1168-1196), tekstet e Kosovës e të Shqipërisë e përmendin krejt përciptazi, sundimin nën pasardhësit e tij, Stefan Nemanjić (1196-1228) dhe Stefan Uroš I (1236-1271) nuk e përmendin fare. Për më shumë, këto tekste nuk e zënë në gojë as sundimin nën Mbretin Milutin (1282-1321), e as pasurimin e tij kryesisht nga shfrytëzimi i minierave të Kosovës (Trepça, Janjeva, Novobërda), e madje as

.....
 18 Boshkoski, Millan, Jordan Ilioski dhe Nebi Dervishi. *Historia 6*. Shkup: Prosvetno Dello, 2008, faqe 70, 73-74, 78-80, 82-83; Pavlovski, Gjorgji, Dime Maxhovski dhe Jovo Ratković. *Historia 1 gjimnazi I reformuar*. Shkup: Prosvetno Dello, 2002, faqe 96-97; Boshkoski, Millan, Jordan Ilioski, Gjorgji Isajllovski, Vllado Vellkoski, Miroslav Boshković dhe Simeon Naumovski. *Historia 1 arsimit i mesëm profesional*. Shkup: Prosvetno Dello, 2006, faqe 79-80; Boshkoski, Millan, Nebi Dervishi, Silvana Sidorovska – Cupovska, Natasha Kotlar, Jordan Ilioski, Dimko Popovski. *Historia 2 arsimit gjimnazor*. Shkup: Prosvetno Dello, 2008, faqe 36-38.

ndërtimin e mëpastajmë të një morie kishash, tri prej të cilave në Kosovë, mes tyre edhe kryevepra kompakte e komplekse e Graçanicës. Po ashtu, në këto tekste nuk figuron as sundimi i pasardhësit të Milutin-it, Dečanski-t (1322-1331), e as kryevepra e tij arkitekturale, Manastiri i Deçanit. Në anën tjetër, këto që u thanë në këtë paragraf, figurojnë në tekstet e Sërbisë, e sidomos në ato të Malit të Zi, e deri-diku edhe në ato të Maqedonisë.

Nga gjithë sundimi gati dyshekullor mesjetar sërb në Kosovë (1216-1415), sundimi nën Mbretin Dušan, pasardhësin e Dečanski-t, është më i rëndësishmi, mes tjerash edhe për shkak se nën sundimin e tij Sërbia kishte arritë lulëzimin më të madh, duke e futë nën kontroll një territor të madh, që përfshinte deri edhe Shqipërinë e Jugut, pjesë të Greqisë së Veriut, e madje e kishte kërcënuar edhe vet ekzistencën e Bizantit.

Nga tërë ky sundim gati dyshekullor mesjetar sërb në Kosovë (1216-1415), tekstet në Kosovë e në Shqipëri fokusohen vetëm te sundimi nën Stefan Dušan-in (1331-1355), të cilin e portretizojnë me terma ekskluzivisht negativë: "...pushtuesit sërbë ushtruan shtypje dhe diskriminim të egër ekonomik, shoqëror e fetar, kolonizuan në masë të madhe tokat shqiptare", dhe "...pronarët shqiptarë u zëvendësuan me pronarë sërbë, shumë emra vendesh i zëvendësuan me emra sllavë, në postet më të larta të administratës shtetërore gjendeshin vetëm sërbë...". Mirëpo, këto shtypje, diskriminime e kolonizime nuk përmenden askund në botimet e studiuesve ndërkombëtarë që trajtojnë historinë e Kosovës.

Më tej, këto tekste thonë se popullsia shqiptare i bëri ballë represionit, diskriminimit e kolonizimit, duke e ruajtur qenien e vet dhe shqiptarësinë e këtyre trojeve. Sa i takon 'ruajtjes së qenies shqiptare' këto tekste duhet ta kenë parasysh se ka pasë një proces të vazhdueshëm sërbizimi të josërbëve, që qartazi ishin ose shqiptarë ose vllahë, dhe ky nuk ishte proces i njëkahshëm, por duke marrë parasysh mbizotërimin e ortodoksisë sërbë, sundimin e sërbëve ortodoksë dhe të gjuhës sërbë mesjetare, ka arsye për t'u besuar se rrjedha e përgjithshme e asimilimit ishte në favor të sërbëve. Ndërkaq, sa i përket 'ruajtjes së shqiptarësisë së këtyre trojeve' duhet thënë se nëse bazohemi në 'krisobula', shqiptarët ishin pakicë në rënie; pa dyshim shqiptarët kanë prani të vazhdueshme në këtë rajon, por të gjitha dëshmitë sugjerojnë se në Kosovën Mesjetare ata përbënin vetëm një pakicë.

Në anën tjetër, tekstet e Sërbisë nuk prezantojnë asgjë nga sundimi sërb në Kosovë nën Mbretin Dušan, kurse ato të Maqedonisë ngushtohen vetëm te revoltat e herëpashershme të feudalëve shqiptarë kundër sundimtarëve sërbë, pasi '...u ishte ndërpre vetadministrimi i përhershëm lokal'. Ndërkaq, tekstet

e Malit të Zi nuk përmendin fare revolta të shqiptarëve kundër sundimtarëve sërbë, por dallojnë rrënjësisht nga tekstet e tjera, ngaqë vënë në pah se ‘...Mbreti Dušan e kishte pushtuar Shqipërinë me përkrahjen e fisnikëve shqiptarë, disa prej të cilëve kishin fituar tituj të lartë oborrtarë dhe ishin məkëmbës të territoreve të mëdha’.

Tekstet në Kosovë e në Shqipëri thonë se kishte kryengritje të fuqishme antisërbe që përfshinin të gjitha trojet, e që madje përkraheshin nga vendet europiane, kurse për motiv të tyre përmendin represionin, diskriminimin dhe kolonizimin, por as këto nuk figurojnë askund në botimet e studiuesve ndërkombëtarë që trajtojnë historinë e Kosovës. Me pohimin se ‘kryengritjet antisërbe përkraheshin nga vendet europiane’, këto tekste sikur tentojnë të thonë se kryengritjet shqiptare antisërbe qenë mbështetur nga vendet europiane jo vetëm më 1998-1999, por edhe gjatë sundimit mesjetar sërb.

Tekstet në Kosovë, në Shqipëri, në Sëربي dhe në Maqedoni, duke përjashtuar ato në Mal të Zi, nuk e pohojnë askund që në Perandorinë e Dušan-it shqiptarët kishin në të vërtetë një rol të madh: ushtria e Mbretit Dušan që e kishte pushtuar Greqinë e Veriut, përbëhej kryesisht nga shqiptarë, që u hakmerreshin bizantinëve për shkak të sulmeve të mëhershme kundër trojeve të veta. Pas këtij pushtimi madje një numër i madh shqiptarësh dhe vlllehësh shqiptarë qenë shpërngulë për në Greqi. Po ashtu, nuk pohohet se Mbreti Dušan, nga selia e tij në Shkodër ishte nisë, në krye të një ushtrie, në të cilën me gjasë kishte pasë një numër të madh shqiptarësh, për ta sulmuar babanë e vet, Dečanski-n, në Nerodime, ku e kishte zënë rob dhe e kishte ekzekutuar.

Në tekstet në Kosovë, Shqipëri, Sëربي dhe Maqedoni, sërish duke përjashtuar deri diku tekstet në Mal të Zi, askund nuk pohohet se në mbretërinë sërbe në mesjetë, ishin dy grupe njerëzish që gëzonin trajtim të veçantë: shqiptarët dhe vlllehët. Këto dy grupe përmendeshin disa herë, zakonisht së bashku, në Kodin e Mbretit Dušan, madje në një deklaratë të Mbretit Dečanski thuhej se ‘...sërbi nuk bën të martohet me vllhe’, çka nuk vlente edhe për shqiptarët, kurse një deklaratë e Mbretit Milutin i barazonte shqiptarët me sërbit.

Edhe lidhur me Betejën e Kosovës të vitit 1389, përvijohen dy grupe. Në të parin janë tekstet e Kosovës e të Shqipërisë, të cilat e vënë në pah pjesëmarrjen e shqiptarëve në këtë betejë, ku, përveç pjesëmarrjes së familjes bujare Muzaka – të prirë nga Teodor Muzaka, i vrrarë në këtë betejë – përmendin edhe pjesëmarrjen e familjes Balshaj, të udhëhequr nga sërbo-shqiptari Gjergj Balsha, i konsideruar në këto tekste si figurë shqiptare. Balshaj ka gjasë të mos ketë marrë pjesë fare në betejë, ngaqë kur ishte zhvilluar ajo, ndodhej në Ulqin, gjë që përmendet vetëm në tekstet e Sërbisë. Po ashtu, këto tekste, luftëtarin që

e kishte vuarë Sulltan Muratin, e paraqesin si shqiptar – Millosh Kopiliq nga fshati Kopiliq i Skënderajt. Në grupin e dytë janë tekstet e Sërbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë, që nuk e vënë fare në pah pjesëmarrjen e shqiptarëve në këtë betejë, kurse vrasësin e Sulltan Muratit, e paraqesin si sërb – Miloš Obilić.

Duke marrë parasysh situatën e ndërlikuar politike në territorin e Shqipërisë dhe ndikimin e vendosur osman në disa pjesë të Shqipërisë, ka mjaft mundësi që në Betejën e Kosovës disa shqiptarë, e madje edhe disa vazalë sërbë, të kenë marrë pjesë në anën e osmanëve, gjë që nuk përmendet askund në tekstet e Kosovës, Shqipërisë, Sërbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë. Po ashtu, në asnjërin nga këto tekste, me përjashtim të tekstit për klasën 7 në Kosovë, nuk thuhet se përkatësia etnike e vrasësit të Sulltan Muratit është e paqartë; ai mund të ketë qenë sërb, shqiptar, vlleho-shqiptar, hungarez, e me radhë. Për më tej, është tërësisht e pakuptimtë ngarendja e teksteve në Kosovë e Shqipëri dhe e atyre në Sërbë – por jo edhe e atyre në Mal të Zi e Maqedoni – për ta portretuar vrasësin e Sulltan Muratit si shqiptar, respektivisht sërb, ngaqë kjo vrasje nuk ishte bërë në fushë të mejdanit, por pabesisht, pra ishte një vrasje dinake.

Për fund, pas periudhës nën sundimin e Mbretin Dušan (1355), përveç Betejës së Kosovës më 1389, kur popujt ballkanikë udhëhiqeshin nga Mbreti Lazar, askund në tekstet e Kosovës, Shqipërisë, Sërbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë nuk prezantohet as edhe një episod i vetëm i sundimit mesjetar sërb në Kosovë, që zgjat të paktën deri më 1415. Pra, nuk përmendet fare sundimi i pjesës më të madhe të territorit të Kosovës nga Vuk Branković-i deri më 1395-6, më pas nga Stefan Lazarević-i, e pas disa vjetësh, nga bijtë e Vuk Branković-it, të cilët kishin qeverisur në saje të kushteve të vasalitetit turk.

Ndërkaq, duhet thënë edhe se, themelimi i principatave shqiptare pas Mbretin Dušan më 1355, e sidomos i Principatës së Balshajve, me qendër Shkodrën, e cila përfshinte në zotërimet e veta edhe territoret perëndimore të Kosovës, siç janë qytetet Pejë e Prizren, prezantohet në tekstet e të gjitha vendeve, me përjashtim të teksteve të Sërbisë. Tekstet e Kosovës pohojnë se synimi i Principatës së Balshajve ishte 'bashkimi i të gjitha trojeve etnike shqiptare në një shtet të vetëm'; tekstet e Shqipërisë, të Maqedonisë e të Malit të Zi thonë vetëm se kjo principatë synonte të zgjerohej, ndërsa tekstet e Sërbisë nuk sqarojnë asgjë për qëllimet e kësaj principate. Çuditërisht, tekstet e Kosovës e të Shqipërisë, e edhe ato të Maqedonisë, vënë në pah konfliktet mes principatave shqiptare të Balshajve e të Topiajve, gjë që nuk e bëjnë tekstet e Sërbisë dhe të Malit të Zi. Lidhur me këto konflikte, vetëm tekstet e Shqipërisë e potencojnë që Topiajt i mposhtin Balshajt me ndihmën e ushtrisë osmane. Tekstet e Kosovës e të Shqipërisë nuk e përmendin asnjë bashkëpunim të Balshajve me sunduesit sërbë, as që nipi i Balshës II, Gjergji II, ishte martuar

me Elenën, vajzën e Mbretit sërb Lazar, e as që pasardhësi i fundit i Balshajve ishte vendosur te daja i vet Stefan Lazarević në Beograd, ku edhe kishte vdekë, duke ia lënë pronat dajës, në mungesë të trashëgimtarëve mashkuj, kurse nëna e tij ishte bërë vasale e Perandorisë Osmane.¹⁹

.....

19 Malcolm, Noel. *Kosovo: A Short History*. London: Pan Books, 2002, faqe 42-95; Schmitt, Oliver. *Kosova: histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*. Prishtinë: Koha, 2012, faqe 39-46; Schmitt, Oliver. "Monada e Ballkanit" *Shqiptarët në Mesjetë*. botuar në librin e përgatitur nga Oliver Schmitt dhe Eva Anne Frantz. *Historia e Shqiptarëve - gjendja dhe perspektivat e studimeve*. Tiranë: Botimet Përpjekja, 2012, faqe 67-90; Bartl, Peter. *Shqipëria nga Mesjeta deri sot*. Prizren: Drita, 1999, 24-31. Schmitt, Oliver. *Shqiptarët - një histori midis Lindjes dhe Perëndimit*. Tiranë: K&B, 2012, faqe 49-59.

4. KOSOVA NË PERANDORINË OSMANE

4.1. Nga Gjergj Kastrioti-Skënderbeu deri te Rilindja Kombëtare Shqiptare

Si paraqiten epoka e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, kryengritja e Pjetër Bogdanit, familjet feudale shqiptare, (mos)hapja e shkollave shqipe dhe islamizimi i shqiptarëve?

Lidhur me temat e mësipërme, ja cila është bërthama e shtjellimeve që bëjnë **tekstet e Kosovës**:

- Rekrutimi me forcë i fëmijëve të krishterë prej vendeve europiane ishte tatimi më i vështirë. Këta fëmijë dërgoheshin në oborrin e Sulltanit, ku shkolloheshin e konvertoheshin dhe, pasi bëheshin njerëzit më besnikë të sulltanit, arrinin deri në pozitat më të larta shtetërore. Kjo formë rekrutimi i përfshinte të gjitha viset e pushtuara e më së shumti Arbërinë, qëndresa e të cilës ndaj sundimit osman nuk pushoi asnjëherë. Principata e Kastriotëve udhëhiqej nga familja fisnike e Kastriotëve me origjinë nga Hasi. Gjon Kastrioti ishte i martuar me Vojsavën, e cila vinte nga një familje bujare e Tetovës. Djali i tyre më i vogël, Gjergji, në moshën 9 vjeçare u mor peng nga osmanët, ku ndoqi shkollat ushtarake të Sulltanit dhe për meritat e treguara mori emrin Skënder dhe titullin Bej, ndaj u quajt Skënderbe. Meqë ishte ushtarak i dalluar, Sulltani e kishte emëruar Skënderbeun sundimtar të Krujës, gjë që i mundësoi ta njihte gjendjen në vendlindje dhe ta planifikonte në heshtje kthimin në atdhe. Skënderbeu e kishte pritë momentin e volitshëm për t'u kthyer në atdhe dhe kështu më 3 nëntor 1443, në betejën e osmanëve kundër hungarezëve (të cilët udhëhiqeshin nga Janosh Huniadi), e gjeti rastin për t'u larguar. Kjo bëri që osmanët të pësonin humbje. Më 28 nëntor 1443, Skënderbeu e ngriti flamurin me shqipnonjën dykrenare në Krujë. Më 2 mars 1444 në Lezhë u themelua Besëlidhja Shqiptare në krye me Skënderbeun, ku u bashkuan të gjithë princat shqiptarë, u krijua ushtria shqiptare dhe u çliruan qytetet shqiptare, me ç'rast u hodhën themelet e shtetit shqiptar të asaj kohe. Skënderbeu zhvilloi shumë beteja, sidomos me Perandorinë Osmane, por edhe me Venedikun; më të rëndësishmet beteja ishin rrethimi i parë i Krujës korrik-tetor 1450, luftërat shqiptaro-osmane më 1452-1465, rrethimi i dytë i Krujës maj-korrik 1466 dhe rrethimi i tretë i Krujës maj-tetor 1467. Në vjeshtë të vitit 1448 hungarezët i sulmuan osmanët, mirëpo pësuan disfatë të rëndë në Fushë Kosovë për shkak se Skënderbeu nuk arriti t'u shkonte në ndihmë hungarezëve, ngaqë u pengua nga despoti sërb Đurađ Branković. Më 1455 Skënderbeu synoi ta fuste nën sundim Beratin, por dështoi dhe kjo ishte humbja e tij e vetme gjatë 25 vjetëve – disa prijës arbërorë, si Moisi Golemi e Hamza Kastrioti, kaluan në anën e

osmanëve, mirëpo Skënderbeu tregohej i mëshirshëm dhe human edhe me ata që e kishin tradhtuar e që më vonë ishin penduar. Skënderbeu dhe arbërit shikoheshin si mbrojtës të krishterimit në Ballkan, andaj Papët e Romës e mbështetën atë moralisht e materialisht. Skënderbeu kishte raporte të mira me Papën, Napolin, Venedikun, Dubrovnikun, Zetën dhe Hungarinë. Vepra e Skënderbeut ngriti lart respektin për të kudo nëpër Ballkan e në Europë. Luftërat e Skënderbeut i penguan osmanët ta pushtonin Europën. Skënderbeu është figurë madhështore kombëtare e europiane. Osmanët e shfrytëzuan vdekjen e Skënderbeut për t'i futë sërish viset shqiptare nën sundim dhe në shenjë hakmarrjeje vranë shumë shqiptarë dhe shumë të tjerë i detyruan të shpërnguleshin nga atdheu.

- Përprjekjet e shqiptarëve për ta fituar lirinë e humbur pas vdekjes së Skënderbeut, nuk pushuan asnjëherë. Në Kosovë më 1689 shpërtheu një kryengritje e përgjithshme antiosmane me rreth 20 mijë kryengritës, në krye të të cilëve ishte arqipeshkvi nga Shkupi, Pjetër Bogdani. Kjo kryengritje nuk u përkrah nga popujt e tjerë të Ballkanit dhe nuk pati sukses. Në fillim të vitit 1690 në Kaçanik ushtria austriake bashkë me kryengritësit shqiptarë u mposht nga ushtria osmane. Tërheqja e austriakëve dhe disfata e shqiptarëve krijoi një gjendje të rëndë për popullsinë vendase. Bashkë me ushtarët austriakë u tërhoqën edhe disa banorë kosovarë, por nuk mund të flitet për ndryshim demografik të Kosovës në atë kohë.
- Edhe pas pushtimit osman kishte familje feudale, më të njohurat e të cilave ishin: familja Bushati, që themeloi Pashallëkun e Shkodrës; familja Janina, që e themeloi Pashallëkun e Janinës, pastaj familjet Begolli, Kryeziu, e me radhë. Këto familje kishin rivalitete mes vete. Pasi u fuqizuan shumë dhe nisën të pavarësoheshin, osmanët e shkatërruan pashallëkun e Janinës dhe e vranë udhëheqësin e tij Ali Pashë Tepelena, e më pas e shkatërruan edhe Pashallëkun e Shkodrës.
- Shqiptarët e ndienin veten të pushtuar, nuk mund t'i realizonin të drejtat e tyre kombëtare e qytetare dhe u mohohej shkollimi në gjuhën amtare. Shqiptarët e mërguar jashtë atdheut për shkak të dhunës osmane, e ndihmonin vendin e tyre nga shtetet ku jetonin. Pushteti osman frikësohej nga shkollimi i shqiptarëve në gjuhën e tyre amtare. Intelektualët dhe patriotët shqiptarë ndiqeshin, burgoseshin dhe vriteshin nga pushteti osman që nuk lejonte hapjen e shkollave shqipe. Përkundër këtyre vështirësive, shqiptarët nuk u ndalën së vepruari dhe hapën shkollat e tyre kombëtare: shkolla e parë u hap më 7 mars 1887. Pas përfundimit të shkollimit të lartë dhe për aftësitë intelektuale që tregoi, rilindasi shqiptar Hoxhë Tahsini u emërua rektor i Universitetit të Stambollit.

- Pas pushtimit osman, vendi ishte pothuajse tërësisht i shkatërruar nga luftërat dhe në trojet arbërore filloi të përhapej feja islame. Në fillim fenë islame e morën djemtë e bujarëve shqiptarë, që dërgoheshin në pallatin e Sulltanit dhe ktheheshin në vendin e tyre për të marrë pozita në administratë ose në ushtri. Osmanët mendonin se kështu më lehtë përhapej feja islame te shtresat e tjera të popullsisë. Islamizimi u përhap së pari në qytetet shqiptare, shumë më ngadalë në fshat, ndërsa në zonat malore nuk u përhap. Faktorët që ndikuan në përhapjen e fesë islame ishin presioni përmes taksës për tokë që e paguanin vetëm të krishterët, marrja e djemve nga familjet e krishtera shqiptare dhe dërgimi i tyre në Stamboll, reprezaljet e organeve shtetërore mbi popullsinë, etj.²⁰

Bërthama e shtjellimeve që bëjnë **tekstet e Shqipërisë** është kjo:

- Pushtimet osmane sollën pasoja të rënda ekonomike e politike. U shkatërruan shumë toka bujqësore, u dogjën e u plaçkitën shumë qytete. Princërit arbërorë u zhveshën nga pronat, u detyruan të shndërroheshin në vasalë të Sulltanit dhe t'i paguanin haraç e t'i shërbenin në ushtri. Këto nxitën shpërthimin e kryengritjeve antiosmane. Principata e Kastriotëve, e udhëhequr nga Gjon Kastrioti, të parët e të cilit kishin prejardhje nga Hasi, ishte njëra ndër principatat që po fuqizohej më së shumti në shekullin 15. Në vitin 1415, Gjon Kastrioti, e dërgoi djalin e vet Gjergjin peng te Sulltani, ku ky u edukua në shkollat ushtarake dhe mori emrin Skënder, titullin Bej dhe gradën gjeneral. Skënderbeu mori pjesë në shumë beteja dhe mbajti shumë poste në administratën osmane. Në vitin 1443, ushtria osmane, ku bënte pjesë edhe Skënderbeu, zhvilloi luftime afër qytetit të Nishit me forcat hungareze, që udhëhiqeshin nga Janosh Huniadi. Në këtë betejë forcat osmane u shpartalluan dhe Skënderbeu gjykoi se ky ishte momenti më i përshtatshëm për t'u kthyer në atdhe e për ta çliruar vendin nga pushtuesit osmanë. Gjatë betejës së Nishit, Skënderbeu i mori sekretarit të Sulltanit një dokument me vulën e Sulltanit, sipas të cilit Skënderbeu emërohej sundimtar i kështjellës së Krujës. Me luftëtarët e vet mbërriti në Krujë, e mori kështjellën dhe i dëboi forcat pushtuese osmane, kurse më 28 nëntor 1443 e uli flamuri osman dhe e ngriti flamurin me stemën e Kastriotëve duke e shpallë fitoren. Ngaqë e dinte se Sulltani do të dërgonte forca të mëdha ushtarake për të ripushtuar territoret arbërore, më 2 mars 1444, Skënderbeu thirri një kuvend popullor të princërve shqiptarë në Lezhë, ku u vendos që të

.....

20 Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj. *Historia 5*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013, faqe 37-54 dhe 55-74; Bicaj, Isa dhe Arbër Salihi. *Historia 7*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013, faqe 58-72 dhe 113-132; Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj. *Historia 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013, faqe 169-185.

krijohet një aleancë, kryetar i të cilës u zgjodh Skënderbeu. Ai zhvilloi dhjetëra beteja të suksesshme kundër pushtuesve osmanë, si Beteja e Torviollit 1444, thyerja e ekspeditave turke 1445-1447, por betejat më të mëdha ishin ato për mbrotjen e Krujës (1450, 1466, 1467). Fitoret e Skënderbeut tërhoqën vëmendjen e të gjithë Europës dhe Shqipëria filloi të vlerësohej si një mburojë e fuqishme antiosmane. Beteja e Beratit (1455) ishte beteja më e vështirë, ku forcat e shtetit të Skënderbeut pësuan humbje të thellë dhe disa fisnikë arbërorë, si Moisi Golemi dhe Hamza Kastrioti, u lëkundën, e tradhtuan Skënderbeun dhe fshehurazi shkuan te Sulltani. Në Betejën e Oronikut, forcat osmane që drejtoheshin nga Moisi Golemi u thyen, kurse vetë Moisi Golemi, i penduar për qëndrimin e tij, u kthye te Skënderbeu, i cili e fali. Hamza Kastrioti, nipi i Skënderbeut, që ishte në krye të forcave osmane në Betejën e Ujit të Bardhë, pësoi disfatë të thellë, u zu rob, u dërgua në burg në Itali, e më vonë u fal nga Skënderbeu. Të njëjtin fat e pësuan edhe forcat osmane në fushën e Vajkalit (Bulqizë), të cilat drejtoheshin nga një komandant i aftë, Ballaban Pasha, me origjinë arbërore. Skënderbeu mbajti lidhje me shumë shtete, si me Papatin, Napolin, Milanon, Raguzën, Hungarinë, e me radhë. Skënderbeu ndërroi jetë më 17 janar 1468 në moshën 63 vjeçare. Pas vdekjes së tij territoret shqiptare ranë nën sundimin osman. Përpyetje për çlirim bënë edhe djali i tij Gjoni e më pas nipi i tij Gjergji, por që të dy pas disa viteve ishin të detyruar të tërhiqeshin. Skënderbeu ka hyrë në histori si figurë me vlera kombëtare e ndërkombëtare.

- Në vitet 1614-1620 u bënë përpjekje për të organizuar një lëvizje antiosmane ballkanike, për çka u organizuan katër kuvende ballkanike, në të cilat morën pjesë shqiptarë, malazezë, sërbë e maqedonas, por, meqë nuk u sigurua mbështetja ndërkombëtare, këto përpjekje dështuan. Në vitin 1689, në luftën mes Perandorisë Osmane dhe asaj Habsburgase, shqiptarët u nxitën nga fitoret e ushtrisë austriake dhe shpërthyen në një kryengritje të fuqishme që u zgjerua shpejt dhe përfshiu territoret e Kosovës. Në krye të kësaj kryengritjeje të përgjithshme, që numëronte 20 mijë veta, ishte arqipeshkvi nga Shkupi, Frang Bardhi, një figurë e shquar e kulturës sonë kombëtare. Ushtria austriake përparoi drejt Prishtinës, Prizrenit dhe Shkupit dhe në çdo qytet u prit si çlirimtarë. Një pjesë e kryengritësve u bashkuan me ushtrinë austriake. Fitoret e kryengritësve dhe të ushtrisë austriake u ndërpre në Betejën e Kaçanikut më 1690, ku ushtria austriake u thye nga forcat osmane, të cilat rivendosën sundimin e tyre në territoret e Kosovës.
- Pashallëku i Shkodrës u krijua nga familja shkodrane Bushatliu. Themelues ishte Mehmet Pashë Bushatliu. Pasardhësi i tij, Mahmut Pasha, ishte përpjekë të krijojnë një aleancë ballkanike dhe për këtë

kishte thirrë një kuvend në Podgoricë, ku kishin marrë pjesë shqiptarë, malazezë, sërbë e maqedonas dhe kishin vendosë të krijojnë një aleancë me emrin “Konfederata Ilirike” e të luftojnë kundër Perandorisë Osmane. Mahmut Pasha organizoi dy kryengritje dhe në të dyjat doli fitues. U vra më 1796 në sulmin që kishte ndërmarrë kundër Malit të Zi. Sundimtari i fundit i këtij pashallëku ishte Mustafë Pashë Bushatliu. Krahas Pashallëkut të Shkodrës u krijua edhe Pashallëku i Janinës, historia e të cilit lidhet me figurën e Ali Pashë Tepelenës. Ai e vuri nën kontroll Pashallëkun e Janinës më 1787 dhe e shndërroi atë në një vend të fuqishëm e me autoritet. Pati marrëdhënie me fuqitë e mëdha të kohës: Francën, Anglinë dhe Rusinë. Politika e pavarur që e ndiqte, e futi në konflikt me Perandorinë Osmane, e cila dërgoi ushtri kundër Ali Pashës. Pasi që e tradhtuan shumë nga bashkëpunëtorët, madje edhe djemtë, u vra në ishullin e Janinës, kokën ia prenë dhe ia dërguan Sulltanit. Pashallëqet hodhën hapa drejt krijimit të një shteti kombëtar.

- Në shekullin 16 ekonomia filloi të gjallërohej, qytetet u zgjeruan, u krijuan qendra tregtare, pazare e çarshi, u zhvilluan zejtaria e tregtia. Tregtarët shqiptarë rritën veprimtarinë e tyre jo vetëm brenda vendit, por edhe nëpër Ballkan e në Europë. Ndryshime ndodhën edhe në arsim, kulturë e fe. Gjatë shekullit 17 u hapën shkolla fetare fillore e të mesme në shqip, u hartuan tekste shkollore, u përkthyen vepra letrare dhe u hodhën themelet e letërsisë shqipe: Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani, etj. Po ashtu, zhvillim të veçantë njohu edhe letërsia me alfabet arab e njohur si “letërsia e bejtexhinjve”. Në të gjitha qytetet shqiptare u hapën shkollat islame (medresetë), ku mësimi zhvillohej në turqisht ose arabisht. Në Shqipërinë Veriore u hapën shkolla në shqip, kurse në Shqipërinë Jugore u hapën shkolla në gjuhën greke. U bënë shumë ndërtime të reja: xhami e kisha, hamame, çezma, kulla sahati, etj. të cilat u zbuluan nga piktorë të mëdhenj si Onufri, Selenica, Shpataraku, etj.
- Krahas fesë katolike e ortodokse, hyri edhe feja islame, e cila u përhap shpejt, veçanërisht në shekullin 18.²¹

Prirjet në **tekstet e Sërbisë** janë këto:

- Pas shpërbërjes së mbretërisë sërbe, në territorin e Shqipërisë, në skenën politike dolën në rrafshin e parë familje të mëdha shqiptare, si Shpataj, Matrënga dhe Topiaj, e më vonë edhe Muzaka, Kastrioti, Dukagjini e

21 Dërguti, Menduh, Sonila Boçi dhe Ledia Dushku. *Historia 9*. Tiranë: Botime Shkolllore Albas, 2013, faqe 29-43; Dërguti, Menduh, Ferit Duka, Ledia Dushku dhe Sonila Boçi. *Historia e shqiptarëve 12*. Tiranë: Botime Shkolllore Albas, 2013, faqe 73-84.

Arianiti, të cilat krijuan krahinat e tyre. Rreziku osman, i cili shtrihej mbi tërë Ballkanin, përfshiu edhe rajonet shqiptare. Luftërat ndërmjet familjeve të mëdha shqiptare, karakteristike për tërë territorin e Ballkanit, e lehtësuan ndërhyrjen e ndikimit osman, sidomos gjatë kohës së Sulltan Bajazitit 1. Pjesa më e madhe e dinastëve shqiptarë kaluan në vasalë të osmanëve. Në dekadat e para të shekullit 15 ndodhën pushtimet e reja osmane të territoreve shqiptare. Në këtë kohë u formua sanxhaku shqiptar si pjesë integrale e Perandorisë Osmane. Ky regionalizim përfshiu rrethin e familjes së Kastriotëve. Gjergj Kastrioti, djali i Gjon Kastriotit, i quajtur nga turqit Skënderbeg, gjatë viteve 40 të shekullit 15, u shmang nga pushteti osman, pushtoi qytetin e Krujës dhe filloi luftën për çlirimin e territoreve. Rreth tij u grumbulluan dinastët e tjerë shqiptarë dhe deri në vdekjen e tij (1468) me sukses u rezistuan sulmeve osmane. Skënderbeu u bë sinonim i rezistencës shqiptare kundër pushtetit osman, personalitet qendror i traditës popullore e më vonë edhe temë e patejkalueshme e formimit të identitetit kombëtar. Pas vdekjes së tij, osmanët i shtypën edhe fiset e tjera të mëdha dhe vazhduan pushtimin tujtje.

- Kur turqit filluan të korrnin suksese në luftën kundër austriakëve, sidomos pas Betejës së Kaçanikut, atëherë pasoi e ashtuquajtura Shpërngulje e Madhe e sërbeve në vitin 1690. Patriku Arsenije 3, duke ikur nga turqit në përcjelljen e klerikëve dhe popullit nga hapësira e Maqedonisë, Kosovës e Metohisë dhe Rashkës, i mori me vete vlerat kishtarë. Sërbët e shpërngulur e kaluan Savën dhe Danubin dhe u shpërngulën në hapësirat e Hungarisë jugore. Supozohet se janë shpërngulur rreth 60.000 frymë. Në Kosovë dhe Metohi, pas vitit 1690, vatrat e lëshuara sërbe në masë të madhe filluan të popullzohen me fiset e islamizuara shqiptare nga Shqipëria e Veriut dhe e Mesme. Shpërngulja e ardhshme e rëndësishme, sërish për në Hungari, ndodhi gjysmë shekulli më vonë, në kushte të ngjashme, gjatë luftës austro-turke (1737-1739). Kjo shpërngulje ishte numerikisht më e vogël dhe përveç sërbeve përfshiu edhe fisin shqiptar Kelmendi.
- Nuk ka asgjë për familjet feudale shqiptare.
- Nuk ka asgjë për (mos)hapjen e shkollave shqipe.
- Islamizimi më së shumti i përfshiu dy popuj - shqiptarët dhe sërbiët. Që nga ardhja e turqve e deri sot, këta dy popuj predikojnë tri fe - ortodokse, katolike dhe myslimane, me një dallim që te sërbiët ka më së shumti ortodoksë, ndërsa te shqiptarët muslimanë. Sërbiët më së shumti u islamizuan në hapësirat nga Lika e deri në Metohi, në krahinën e Rashkës dhe në Bosnjë e Hercegovinë. Islamizimi ka qenë proces i gjatë - më së shumti u shpreh në shekullin 16, por ndërrimi i fesë nuk u

ndërpre deri me fillimin e shekullit 20. Me pranimin e islamit, njerëzit i ndërjuan besimet, mënyrën e jetesës, të menduarit, bile edhe dukjen, pasi myslimanët dalloheshin edhe me veshje. Krejt kjo ndikoi që bota e islamizuar të merrte veti të tjera mentale. Në hapësirat e Sërbisë së Vjetër (Kosovë) kalimi në islam mori edhe një veti përcjellëse: shqiptarët, të favorizuar në kuptimin e popullzimit dhe të privilegjuar si muslimanë, ua imponuan sërbeve emrat, gjuhën dhe zakonet. Ky proces është i njohur si albanizim (arbanizim).²²

Në **tekstet e Malit të Zi** bërthama e zhvillimeve është kjo:

- Në shekullin 15 pushteti osman u shtri mbi të gjitha këto territore. Për t'i ruajtur pozitat dhe privilegjet, shumica e feudalëve shqiptarë e pranuan vasalitetin. Rezistencën ndaj pushtuesit osman, populli shqiptar e bëri nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut. Në shekullin e 15 më të rëndësishmet ishin familja e Dukagjinëve në Veri dhe e Kastriotëve në rrethinën e Krujës, të cilat u përballën me vërshimin pushtues të osmanëve. Komandanti i njohur ushtarak shqiptar, Skënderbeu, zhvilloi një luftë heroike kundër osmanëve. Duke shfrytëzuar vështirësitë e osmanëve në kohën e luftës së vitit 1443-44, u arratis prej Sulltanit, vendosi sundimin mbi Krujën dhe ripërtëriu territorin e familjes së vet. Kjo i inukrajoj feudalët e tjerë shqiptarë, të cilët iu bashkuan Skënderbeut dhe bënë një qëndresë të fortë kundër turqve deri në vdekjen e tij (1468). Skënderbeu sundoi i pavarur për 25 vjet mbi një pjesë të Shqipërisë. Në këtë periudhë, ai iu kundërvu me trimëri dhe me sukses osmanëve, për ç'gjë fitoi lavdi të madhe. Pas vdekjes së tij, Sulltani Mehmeti 2 e ripushtoi të gjithë territorin. Shqipëria ishte njëri nga territoret ku sundimi osman pati pikëmbështetje të fuqishme.
- Nuk përmendet fare që në Kosovë më 1689 kishte shpërthyer një kryengritje antiosmane me rreth 20 mijë kryengritës, në krye të të cilëve ishte arqipeshkvi nga Shkupi, Pjetër Bogdani.
- Në gjysmën e parë të shekullit 19 Perandorisë Osmane iu kundërvu fuqishëm lëvizja e fuqishme anti-reformiste e oligarkisë feudale shqiptare në Pashallëkun e Janinës dhe të Shkodrës. Pashallëku i Janinës udhëhiqej nga Ali Pashë Tepelena, i cili pa skrupuj rrëmbente territoret e fqinjve dhe i largonte mëkëmbësit e Perandorisë Osmane nga Shqipëria. Në territorin e tij ai sundonte me despotizëm dhe i shtypte njësoj si të krishterët ashtu edhe muslimanët. Për realizmin e ambicieve të veta

22 Smilja Marjanović-Dušanić dhe Marko Šuica. *Istorija za II razred gimnazije*. Beograd: Zavod za udžbenike, 2009, faqe 217; Radoš Ljušić. *Istorija za I razred gimnazije*. Beograd: Zavod za udžbenike, 2008, faqe 88-89.

vendosi lidhje me Francën dhe Anglinë dhe nën sundimin e tij Janina u bë qendër e zhvilluar ekonomike. Pas rrethimit që nisi më 1820, ushtria osmane vendosi sundimin në këtë pashallëk, kurse Ali Pasha u vra më 1822. Pashallëku i Shkodrës udhëhiqej nga Mahmut Pashë Bushati, kurse më pas nga Ibrahim Pashë Bushati, njeri besnik i Sulltanit, që i ndihmoi Perandorisë Osmane për shtypjen e të gjitha revoltave në Traki, Bullgari, Sërbi. Pasardhës i Ibrahimit ishte Mustafa, të cilin e ndihmoi Perandoria Osmane që t'i zgjeronte zotërimet e veta për ta vënë në konflikt me Ali Pashë Tepelenën. Marrëdhëniet e Mustafës me Perandorinë Osmane u prishën pasi që e braktisi frontin grek dhe sabotoi pjesëmarrjen në luftën ruso-osmane (1828-1829). Në vitet 1830-31, Mustafa udhëhoqi lëvizjen antireformiste në Shqipëri, vendosi lidhje me Hysein Gradašević, Miloš Obrenović, Petar Njegoš duke kërcënuar kështu sundimin e Sulltanit në Ballkan. Pas dobësimit dhe dorëzimit të Mustafës, mori fund sundimi i Bushatlinjve. Gjatë zbatimit të reformave, sunduesit osmanë bënë raprezalje të shumta, për ç'arsye shpërthyen revolta dhe kryengritje të reja në Shqipëri.

- Nuk përmendet asgjë për (mos)hapjen e shkollave shqipe.
- Popullsia shqiptare iu nënshtrua procesit të fuqishëm të islamizimit në shekullin 17 dhe 18 dhe mori pjesë në fushatat e osmanëve. Gjatë Luftës së Madhe të viteve 1683-1699 dhe pas saj, edhe popullsia shqiptare u përfshi nga shpërnguljet të cilat herë pas here u kthyen në procese migruese për në territoret fqinje.²³

Përmbajtja e **teksteve të Maqedonisë** ka këtë thelb:

- Vendosja e pushtetit osman në Shqipëri e vështirësoi shumë gjendjen e popullit shqiptar. Shumë banorë që nuk e kishin pranuar sundimin osman qenë tërheqë në viset malore, ndërsa të tjerët e kishin braktisë Arbërinë. Qendër e rezistencës antisomane ishte bërë Principata e Kastriotëve. Përforcimin më të madh kjo principatë e kishte arritë në fillim të shekullit 15 nën udhëheqjen e Gjon Kastriotit, me prejardhje nga krahina e Hasit (Kosovë). Në pamundësi që t'i rezistonte Perandorisë Osmane, Gjoni ishte detyruar ta pranonte vasalitetin ndaj Sulltanit dhe ta jepte djalin e vet 9 vjeçar, Gjergjin, si peng te Sulltani. Gjergji ishte detyruar ta pranonte fenë islame dhe të merrte emër mysliman – Skënder. Edhe pse në shërbim të osmanëve, Skënderbeu e kishte ruajtë dashurinë

.....
 23 Popoviq, Radovan dhe Dragan Miranoviq. *Historia 7*. Podgoricë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 2006, faqe 70; Popoviq, Radovan dhe Dragan Miranoviq e Dragoje Gjokiq. *Historia 2*. Podgoricë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 2006, faqe 101; Borozan Gjorgje, Sasha Knezheviciq dhe Sait Shabotiq. *Historia 3*. Podgoricë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 2009, faqe 29 dhe 90.

ndaj atdheut dhe lidhjet me vendlindjen dhe popullin. Ai e kishte pritur momentin e volitshëm për t'i lënë obligimet ndaj Sulltanit, prandaj pas disfatës së osmanëve në Nish në shtator të vitit 1443 prej hungarezëve të udhëhequr nga Janosh Huniadi, Skënderbeu, i cili merrte pjesë në anën e osmanëve, gjeti rastin për t'u kthyer në atdhe e për të luftuar për çlirimin e tokave shqiptare. Para pushtetmbajtësve osmanë në Krujë ishte prezentuar si drejtues i ri nga Sulltani. Pas marrjes së Krujës, më 28 nëntor 1443 e kishte ngritur flamurin me shqiponjën e zezë dykrerëshe. Kryengritja e vitit 1443 kishte çliruar pjesën më të madhe të Shqipërisë. Më 2 mars 1444 në Lezhë, për t'i kundërshtuar me sukses forcat osmane, Skënderbeu thirri një kuvend popullor të princërve shqiptarë, ku u vendos që të krijohet një aleancë ushtarako-politike nën komandën e Skënderbeut. Paraqiten luftërat e Skënderbeut me Perandorinë Osmane dhe me Venedikun, rrethimi i parë i Krujës (korrik-tetor 1450), luftërat shqiptaro-osmane (1452-1465), rrethimi i dytë i Krujës (maj-korrik 1466) dhe rrethimi i tretë i Krujës (maj-tetor 1467). Paraqiten edhe lidhjet e Skënderbeut me vendet europiane: Hungarinë, Italinë, Napolin, Venedikun, Dubrovnikun dhe me vendet e tjera të rajonit. Perandoria Osmane arriti ta pushtonte Krujën vetëm më 1478, dhjetë vjet pas vdekjes së Skënderbeut. Për herë të parë nën Skënderbeun principatat shqiptare u bënë bashkë në një shtet. Skënderbeu e pengoi përparimin osman kah Europa.

- Qytetet shqiptare përjetuan sulm të rëndë gjatë pushtimeve osmane, pjesa më e madhe e popullsisë ose u vra ose emigroi. Pati tentime që edhe në nivel ballkanik të organizoheshin luftëra antiosmane, ku merrnin pjesë përfaqësues shqiptarë, serbë, malazezë e maqedonë: më 1614 në Kuç, më 1616 në Prokuple, më 1620 në Beograd. Në shtator 1689 ushtria austriake me në krye gjeneralin Piccolomini, u drejtua kah Kosova. Ai u prit me nderime të larta në Prishtinë e në Prizren. Atij iu bashkëngjitën mbi 20 mijë kryengritës shqiptarë të udhëhequr nga Pjetër Bogdani. Pas vdekjes së Piccolominit (nëntor 1689), qëndrimi i shqiptarëve ndaj austriakëve ndryshoi për disa arsye: pasardhësi i Piccolominit, Holshtajn, i shihte shqiptarët me mosbesim dhe kishte tentuar t'i çarmatoste, i ofendonte dhe sillej keq me ta; austriakët nuk ua zvogëluan tatimet shqiptarëve; shkak tjetër ishte vdekja e Pjetër Bogdanit, i cili me autoritetin e vet i qetësonte bashkëkombasit. Megjithatë, një numër i madh i shqiptarëve vazhdoi edhe më tutje të luftonte me austriakët. Gjendja e ushtrisë austriake dhe e kryengritësve shqiptarë u përkeqësua kur Veziri i Madh, shqiptari Mustafa Pasha Qyprili, u emërua komandant i ushtrisë shqiptare. Forcat austriake dhe kryengritësit shqiptarë u detyruan të tërhiqeshin. Osmanët kryen krime të paparashikueshme. Me ushtrinë austriake u tërhoq edhe një numër i

madh i popullatës nga Sërbia dhe Kosova, kryesisht kryengritës besnikë të Austrisë. Numri më i madh i të shpërngulurve ishin shqiptarë. Me termin “sërbët” që përdoret në dokumente, nënkuptohet se bëhet fjalë për shqiptarët ortodoksë, të cilët ishin kryengritës kosovarë dhe iu bashkëngjitën austriakëve.

- Pas një lufte të gjatë për pushtet mes Begollëve nga Peja dhe Çaushollëve nga Shkodra, pushtetin në Pashallëkun e Shkodrës e mori familja Bushatliu nga Shkodra. Mehmet Pashë Bushatliu u emërua nga Sulltani si Pashë i Shkodrës dhe llogaritej si themelues i këtij pashallëku. Pasardhësi i tij, Mahmut Pasha, ishte sundimtari më i fuqishëm i këtij pashallëku, ngaqë e zgjeroi edhe më tutje territorin e vet dhe kjo ndikoi në keqësimin e marrëdhënieve me Perandorinë Osmane. Sulltani e hoqi nga funksioni Mahmut Pashën dhe dërgoi ushtri të fuqishme kundër tij. Palët u ndeshën në Kosovë, ku Mahmut Pasha kori fitore të madhe. Pas kësaj, Mahmut Pasha thirri një kuvend në Podgoricë, ku morën pjesë edhe përfaqësues nga Mali i Zi e nga Bosnjë-Hercegovina dhe vendosën të krijonin një aleancë me emrin “Konfederata Ilirike” e të luftonin kundër Perandorisë Osmane. Ai organizoi dy kryengritje dhe në të dyjat fitoi. U vra më 1796 në sulmin që ndërmori kundër Malit të Zi. Në vendin e tij erdhi Ibrahim Bushatliu, i cili ndoqi një politikë paqësore ndaj Perandorisë Osmane. Sundimtari i fundit i këtij pashallëku qe Mustafë Pashë Bushatliu. Në gjysmën e dytë të shekullit 18 pati konflikte të shpeshta mes familjeve feudale shqiptare në Shqipërinë e Mesme e veçanërisht në Janinë. Më 1786, Ali Pashë Tepelena, pasi e mori pushtetin në Janinë, i sulmoi kundërshtarët feudalë dhe i eliminoi bandat hajdute dhe e zgjeroi pashallëkun e vet. Ai u njoh si sundimtar i Janinës nga Sulltani. Kishte lidhje edhe me vendet europiane: Francën, Anglinë dhe Rusinë, të cilat i dërguan përfaqësuesit e vet diplomatik në Janinë. Forcimi i Pashallëkut të Janinës ndikoi në acarimin e raporteve me Perandorinë Osmane, e cila dërgoi ushtrinë kundër Ali Pashës. Gjatë konfliktit, shumë komandantë të Ali Pashës u dorëzuan, e gjendja u keqësua kur u dorëzuan edhe bijtë e Ali Pashës. Ali Pasha u vra më 1822.
- Nuk ka asgjë për (mos)hapjen e shkollave shqipe.
- Nuk ka asgjë as për islamizimin e shqiptarëve.²⁴

.....
 24 Boshkoski, Millan, Nebi Dervishi, Silvana Sidorovska – Cupovska, Natasha Kotlar, Jordan Iljoski, Dimko Popovski. *Historia 2 arsimit gjimnazor*. Shkup: Prosvetno Dello, 2008, faqe 64-80, 121-123.

Përmbledhje

Kryengritjet e shqiptarëve kundër Perandorisë Osmane në periudhën 1443-1468, të udhëhequra nga Gjergj Kastrioti – Skënderbeu, bënë që shqiptarët për herë të parë të mbërrijnë në vetëdijen e Perëndimit. Këto nuk ishin kryengritjet e vetme, por falë figurës karizmatike të Skënderbeut, ishin kryengritjet më të forta të të krishterëve në Ballkan. Duhet thënë se, me përjashtim në tekstet e Shqipërisë, nuk pohohet askund se Skënderbeu u arratis prej Sulltanit e u kthye në Krujë, duke shfrytëzuar vështirësitë e osmanëve në kohën e luftës së vitit 1443-44, gjatë betejës me hungarezët në Nish, dhe duke i marrë sekretarit të Sulltanit një dokument me vulë të Sulltanit, sipas të cilit Skënderbeu emërohej sundimtar i Krujës.

Kryengritjet e Skënderbeut, ndonëse ishin zhvilluar në një territor të vogël dhe kryesisht në male e jo në qytete, ishin të përmasave të jashtëzakonshme, ngaqë kishin përballë perandorinë më të madhe të kohës. Por, këto kryengritje ishin bërë të mundshme, mes të tjerash, falë *vasalitetit* të Skënderbeut karshi shteteve italiane, që në tekstet e Kosovës dhe të Shqipërisë, por edhe në ato të Maqedonisë, paraqitet si *aleancë*, kurse në ato të Sërbisë e të Malit të Zi nuk paraqitet fare. Më tej, tekstet e Kosovës, të Shqipërisë dhe të Maqedonisë i paraqesin luftërat e Skënderbeut kryesisht si një varg fitoresh, e jo si luftëra me fitore e humbje, siç vërtet ishin. Madje, edhe kur paraqesin ndonjë humbje të Skënderbeut, atë ua faturojnë ekskluzivisht ‘tradhëtarëve’ si Moisi Golemi e Hamza Kastrioti.

Motivet e kryengritjeve të udhëhequra nga Skënderbeu, sidomos në tekstet e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë, paraqiten si kombëtare – për ta udhëhequr popullin shqiptar drejt lirisë – por, motivet e tyre ishin kryesisht fetare, pronësore, e edhe hakmarrje për babanë e vvarë me urdhër të Sulltanit. Ta zëmë, Kuvendi i Lezhës paraqitet si bashkim ose besëlidhje kombëtare dhe nuk potencohet askund se në këtë kuvend kishte edhe sundimtarë të familjeve të etnive të tjera, siç ishte familja Crnojević. Po ashtu, në të vërtetë kjo nuk ishte lidhje kombëtare, por ushtarake dhe secili anëtar i kësaj lidhjeje ruante mëvetësinë e plotë, ku Skënderbeu ishte vetëm i pari në mesin e të parëve, e jo, siç thuhet në këto tekste, sundimtar i ndonjë shteti shqiptar.

Kur thuhet se Skënderbeu e ngriti flamurin me shqiponjën dykrenare në Krujë, në asnjërin prej këtyre teksteve nuk saktësohet se flamuri që ngriti ai ishte me shqiponjën e Bizantit. Pastaj, në asnjërin prej këtyre teksteve nuk përmendet se babai i Skënderbeut vinte nga Dibra, një trevë e përzier (shqiptare, sërbe, bullgare e vllahe), as se ai ishte i martuar me një grua nga një derë shumë e njohur sërbe, Vojsava Branković, e as që fëmijëve u kishte vënë emra bizantinë

ortodoksë (Konstantin, Gjergj) e sllavë (Reposh, Stanisha, Mamica, Vllaica, Jela).

Sidomos në tekstet e Kosovës, pushtimi osman paraqitet fund e krye negativisht, por pushtimi i hapësirave shqiptare nuk mund të krahasohet me pasojat e pushtimit të popujve tjerë të Ballkanit, sidomos të Bullgarisë e të Sërbisë, ngase shqiptarët para pushtimit osman nuk kishin organizim kishtar, as traditë shtetërore, e as art e letërsi që do të mund të quhej shqiptare. Duhet mbajtur parasysh se dinastët shqiptarë para pushtimit osman lëshonin dokumente në gjuhët greke, latine e sllave, e as edhe një dokument të vetëm në shqip.

Sidoqoftë, më tej, çuditërisht vetëm tekstet e Shqipërisë e të Maqedonisë i përmendin përpjekjet për të organizuar një lëvizje antiosmane ballkanike në vitet 1614-1620, për çka u organizuan disa kuvende ballkanike – më 1614 në Kuç, më 1616 në Prokuplë, më 1620 në Beograd – ku morën pjesë shqiptarë, sërbë, malazezë e maqedonë, por që dështuan meqë nuk u sigurua mbështetja ndërkombëtare.

Sa i takon përlëshjes mes forcave osmane dhe atyre austriake në vjeshtë të vitit 1689, tekstet e Kosovës, të Shqipërisë dhe të Maqedonisë e paraqesin vetëm pjesëmarrjen e shqiptarëve, në krye me argjipeshkvin katolik shqiptar, Pjetër Bogdani, në anën e forcave austriake që udhëhiqeshin nga Enea Piccolomini. Këto tekste kryengritjen e Pjetër Bogdanit (tekstet e Shqipërisë thonë gabimisht “kryengritja e Frang Bardhit”) e pasqyrojnë si një prej përpjekjeve të parreshtura të shqiptarëve për ta fituar lirinë e humbur pas vdekjes së Skënderbeut.

Mirëpo, këto tekste nuk përmendin se forcat osmane, që luftonin kundër forcave austriake, udhëhiqeshin nga shqiptari Mahmut Mahmutbegolli, i cili ishte pashë i Pejës dhe kishte rreth 10 mijë ushtarë, shqiptarë e sërbë. Të njëjtat tekste nuk shënojnë as se në këtë kohë – përjashtim këtu bëjnë tekstet e Maqedonisë – kryevezir osman ishte Mehmet Kyprly, pjesëtar i një dinastie të fuqishme shqiptare në shërbimet publike të Perandorisë Osmane. Po ashtu, këto tekste e shpërfillin tërësisht pjesëmarrjen e sërbëve në këtë kryengritje, përkrah forcave austriake e kundër atyre osmane, në krye me patriarkun Arsenije Črnojević, madje tekstet e Kosovës thonë se kjo kryengritje antiosmane dështoi ngaqë nuk u përkrah nga popujt e tjerë ballkanikë.

Në anën tjetër, tekstet e Sërbisë dhe ato të Malit të Zi nuk e paraqesin fare pjesëmarrjen e shqiptarëve në këtë përlëshje mes forcave osmane dhe atyre austriake. Tekstet e Sërbisë e paraqesin vetëm pjesëmarrjen e sërbëve në luftë kundër forcave osmane dhe përqendrohen veçanërisht te tërheqja e ushtrisë

austriake në ditët e para të vitit 1690 pas vërsuljes së ushtrisë osmane, e cila kishte plaçkitur, vrrarë e dëbuar shumë banorë nga Kosova. Këto tekste pretendojnë se nga territori i Kosovës janë larguar vetëm sërëbët dhe se ky dëbim, i njohur si ‘Shpërngulja e Madhe’, ka pasë përmasa të mëdha.

Historiografia sërëbe përgjithësisht pretendon se të larguarit ishin vetëm nga Kosova dhe numri i tyre shkonte në 400-500 mijë, mirëpo tekstet e Sërëbisë vënë në pah se të larguarit nuk ishin vetëm nga territori i Kosovës, por edhe nga hapësira e Maqedonisë dhe e Sërëbisë, kurse për numrin e të shpërngulurve thonë se supozohet të ketë qenë rreth 60 mijë. Megjithatë, sa i takon numrit të të shpërngulurve, studiuesit ndërëkombëtarë, si Malclom, thonë se ishte rreth 30-40 mijë. Tekstet e Sërëbisë pretendojnë se vatrat e braktisura nga sërëbët në Kosovë e Metohi në masë të madhe u populluan prej fisesh të islamizuara shqiptare nga Shqipëria e Veriut dhe e Mesme. Tekstet e Kosovës thonë se bashkë me ushtarët austriakë u tërhoqën edhe disa banorë kosovarë, por se nuk mund të flitet për ndryshim demografik të Kosovës në atë kohë. Në të vërtetë, shumica e të shpërngulurve nga territori i Kosovës kishin qenë sërëbë dhe është e padiskutueshme se struktura etnike e Kosovës ka ndryshuar për shkak të kësaj shpërnguljeje dhe ardhjes së shqiptarëve nga territori i Shqipërisë së sotme – kjo ardhje ndodhte për arsye ekonomike dhe të gjakmarrjes, por edhe për të neutralizuar grupet plaçiktëse e kryengritëse të popullsisë.

Sa i takon familjeve feudale shqiptare, në të gjitha tekstet, me përjashtim në ato të Sërëbisë, paraqiten familjet feudale shqiptare, por me theks të veçantë familja Bushati, që themeloi Pashallëkun e Shkodrës, dhe familja Janina, që e themeloi Pashallëkun e Janinës. Në asnjërën prej këtyre teksteve, nuk pasqyrohen familjet feudale shqiptare në Kosovë, me përjashtim në disa prej teksteve të Kosovës, ku përmenden krejt telegrafikisht familja Begolli e Kryeziu. Tekstet e Kosovës, por edhe të vendeve përreth, do të duhej t’i prezentonin denjësisht familjet feudale shqiptare të Kosovës, si Begolli në Pejë, Kryeziu në Gjakovë, Rrotlla në Prizren, Gjinolli në Prishtinë e Gjilan, e kështu me radhë. Sidomos familja Gjinolli ishte aq e fuqishme në fillim të shekullit 19, saqë pjesëtarët e saj u quajtën “sundimtarë të dytë” të Kosovës, pas Sulltanit.

Përhapja e islamit te shqiptarët përmendet krejt telegrafikisht në tekstet e Shqipërisë dhe të Malit të Zi, në ato në Maqedoni nuk përmendet fare, ndërëkaq tekstet e Kosovës dhe të Sërëbisë përqendrohen më shumë te ky proces, duke i theksuar edhe faktorët që ndikuan në përhapjen e tij. Tekstet e Kosovës thonë se për përhapjen e fesë islame ndikuan: presioni përmes taksës për tokë që e paguanin vetëm të krishterët; marrja e djemve nga familjet e krishtera shqiptare dhe dërgimi i tyre në Stamboll; si dhe reprezaljet e organeve shtetërore. Në të vërtetë, arsyet kryesore të ndërrimit të fesë te shqiptarët ishin më shumë

materiale: interesi ekonomik, ngaqë lehtësoheshin taksat; mundësitë e karrierës; pastaj statusi, përkatësisht prestigji; prandaj vrulli i islamizimit të shqiptarëve në qytet ishte më i hovshëm. Po ashtu, një tjetër arsye e ndërrimit të fesë te shqiptarët ishte se shqiptarët katolikë kishin edhe më pak priftërinj sesa gjatë sundimit mesjetar sërb. Duhet thënë se ndërrimi i fesë me dhunë nuk ka qenë i shpeshtë.

Gjatë shekujve 15-16 është zhvilluar një metodë sistematike e rekrutimit me dhunë të fëmijëve të vegjël e njohur si *devshirme*: zakonisht merrej nga një fëmijë për çdo dyzet shtëpi, fëmijët dërgoheshin në Stamboll, ku e ndërronin fenë, e mësonin turqishten dhe stërviteshin për të shërbyer si ushtarë. Në fshatrat e krishtera kuptohet që devshirme nuk ishte popullore, prandaj më 1565 në Shqipëri kishte shpërthyer një kryengritje kundër saj. Por, nuk përmendet askund në këto tekste se disa vise, si Novobërda, ishin liruar nga detyra për të dhënë devshirme, çka konsiderohej si privilegj i posaçëm. Po ashtu, nuk pohohet askund se shqiptarët çmoheshin veçanërisht nga mbledhësit e devshirmes për shkak të qëndrueshmërisë fizike dhe zotësive luftarake, madje nuk thuhet kundër as se shumë nga ta arritën të bëheshin pushtetarë në pozitë më të larta shtetërore në shpërputhje me numrin e tyre si popullsi: dy kryevezirë të shekullit 15, Ahmet Pasha e Daut Pasha, dihet se janë me prejardhje shqiptare, kurse numri i përgjithshëm i kryevezirëve shqiptarë në historinë e Perandorisë Osmane, duke përfshirë edhe shumë shqiptarë të Kosovës, mendohet se arrin në 42. Nga 92 vezirët e mëdhenj që kanë qeverisur nga shekulli 15 e deri në shekullin 17, me prejardhje shqiptare kanë qenë 25, kurse me prejardhje turke 19.

Të krishterët ishin të privuar nga disa të drejta, siç ishte mbajtja e armëve, por kjo nuk respektohej aspak në hapësirat shqiptare. Në përgjithësi, të krishterët kishin marrë statusin e një popullate të dorës së dytë dhe i nënshtroheshin një pabarazie të dukshme në përvojën juridike osmane: dëshmia e tyre nuk konsiderohej e vlefshme kundër një myslimani në gjyq, por nga ana tjetër ka shumë shënime për dëshmitë e myslimanëve në favor të të krishterëve, kundër myslimanëve të tjerë. Mirëpo, të krishterëve u lejohej që t'i përmbaheshin jetës së tyre fetare, t'i ruanin kishat dhe t'i kishin gjyqet e veta civile, madje edhe të zgjerorin e të ndërtonin kisha të reja – për shembull, në gjysmën e dytë të shekullit 16, në zonën e Patriarkanës së Pejës u lejua ndërtimi i kishave dhe manastireve.

Në dy shekujt e fundit të pushtetit osman pati mjaft raste të sundimit të dhunshëm në Ballkan, por nuk mund të vlerësohet i gjithë sundimi osman si i dhunshëm, ngaqë në vitet e tij të hershme (të paktën deri në fund të shekullit 16) ishte sistem i rregullt sundimi. Pretendimi se pushteti turk e ka shtypur

identitetin kombëtar në periudhën e hershme është i paqëndrueshëm, sepse koncepti i identitetit modern kombëtar nuk ishte shfaqur në këtë pjesë të Europës në këtë kohë.

Për fund, në shumicën dërrmuese të teksteve të Kosovës, por jo edhe në ato të Shqipërisë, nuk figuron asnjë nga objektet fetare të ndërtuara kryesisht gjatë periudhës së sundimit gati pesëshekullor osman, siç janë: objektet për ritet fetare (xhamitë, mesxhidet, tyrbet, teqetë); objektet arsimore (medresetë e bibliotekat); dhe objekte e tjera (hamamet, urat e gurit, krojet publike, shtëpitë e banimit, kullat e sahatit, shatërvanet, hanet, çarshitë, e me radhë). Po ashtu, në tekstet në Kosovë, por jo edhe në ato të Shqipërisë, nuk paraqiten shkrimtarët me preardhje shqiptare që shkruanin në gjuhët orientale ose që shkruanin shqip me alfabet arab, si Suzi nga Prizreni, Mesih nga Prishtina, Jahja Dukagjini, Koçi Beu, Lytfa Pasha, Nazim Berati, Mehmet Akif Ersoj, Sheh Maliqi i Rahovecit e shumë të tjerë. Tekstet e Sërbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë nuk merren fare me këto çështje.

Ndërkaq, sa u takon shkollave, në tekstet e Kosovës thuhet se pushteti osman nuk lejonte hapjen e shkollave në gjuhën shqipe, por shqiptarët nuk u ndalën dhe hapën shkollën e parë shqipe më 7 mars 1887. Kurse tekstet e Shqipërisë janë më korrekte, ngaqë thonë se në të gjitha qytetet shqiptare u hapën shkollat islame (medresetë), ku mësimi zhvillohej në turqisht ose arabisht dhe shtojnë se në Shqipërinë Veriore u hapën shkolla në shqip, kurse në Shqipërinë Jugore u hapën shkolla në gjuhën greke. Vlen të theksohet se shqiptarët në Jugosllavi kanë vazhduar të shkruajnë me alfabet arab deri në prag të Luftës së Dytë Botërore.²⁵

.....

25 Malcolm, Noel. *Kosovo - A Short History*. London: Pan Macmillan, 2002, faqe 181-201 dhe 116-180; Schmitt, Oliver. *Kosova: histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*. Prishtinë: Koha, 2012, faqe 87-127; Schmitt, Oliver. *Shqiptarët - një histori midis Lindjes dhe Perëndimit*. Tiranë: K8B, 2012, faqe 56-81 dhe 120-135; Bartl, Peter. *Shqipëria - nga mesjeta deri sot*. Prizren: Drita, 1999, faqe 44-78; Gawrych, George. *Gjysmëhëna dhe shqiptarët - sundimi otoman, islamizimi dhe shqiptarët 1874-1913*. Tiranë: Bota Shqiptare, 2007; Revista Përpjekja 28-29. *Skënderbeu i kërkimit shkencor*. Tiranë: 2012.

4.2. Rilindja Kombëtare Shqiptare

Si paraqiten reformat e Tanzimatit dhe kryengritjet shqiptare, pastaj Rilindja Kombëtare Shqiptare, deportimi i shqiptarëve myslimanë nga trevat e Sanxhakut të Nishit më 1877-1878, si dhe Lidhja e Prizrenit me Lidhjen e Pejës, përkatësisht grupet politike të shqiptarëve në këtë periudhë, qëllimet politike të tyre, bashkëpunimi i tyre me 'armiqtë'?

Lidhur me temat e mësipërme, kjo është bërthama e shtjellimeve që bëjnë **tekstet e Kosovës:**

- Në vitet 30 të shekullit 19 u ndërmorën një varg reformash administrative, financiare, ushtarake dhe arsimore, që i takojnë periudhës së Tanzimatit. Tokat shqiptare u ndanë në katër vilajete, filloi rekrutimi i ushtarëve të rregullt që duhej të shërbenin për shumë vjet larg vendit të vet. Këto reforma e keqësuan gjendjen dhe për rrjedhojë shpërthyen një sërë kryengritjesh antiosmane që nisën në vitet 30 dhe vazhduan deri në vitet 70 të shekullit 19. Ndër kërkesat e kryengritësve, më e rëndësishmja ishte ajo për qeverisjen e vendit nga shqiptarët. Kryengritjet e periudhës së Tanzimatit kishin karakter popullor; në to morën pjesë shqiptarë krahinash të ndryshme, pa dallim feje. Kryengritësit luftuan kundër shtypjes kombëtare dhe shfrytëzimit ekonomik, duke e detyruar Perandorinë Osmane që në mjaft krahina, sidomos në ato maloret, ta shtyente zbatimin e reformave, mirëpo nuk arritën suksesin e dëshiruar, ngaqë u shtypën me ashpërsi nga ushtria osmane.
- Rilindja Kombëtare Shqiptare ishte një lëvizje e gjërë që synonte çlirimin dhe bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare në një shtet të vetëm e të pavarur. Ka filluar në vitet 30 të shekullit 19 dhe ka përfunduar më 1912 me shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë. Ndër preokupimet e rilindasve ishte krijimi i një alfabeti të përbashkët. Naum Vexhillarxhi në vitin 1825 hartoi alfabetin shqip, kurse më 1844 abetaren e parë në shqip.
- Ushtria serbe ka kryer gjenocid e terror ndaj popullsisë shqiptare në vitet 1877-1878, i ka detyruar të shpërngulen me dhunë nga 640 vendbanime nga trevat e Sanxhakut të Nishit dhe të tjera përreth 160 mijë banorë shqiptarë, të cilët u detyruan të strehohen në thellësi të Vilajetit të Kosovës – e që edhe sot njihen si muhaxhirë (refugjatë). Këto shpërngulje të dhunshme e masive bënë spastrimin etnik të këtyre vendbanimeve shqiptare dhe kolonizimin e tyre me popullsi serbe.
- Shqiptarët zhvilluan luftë të pandërprerë për t'u çliruar nga pushtuesit osmanë që ua kanë mohuar të drejtat kombëtare e qytetare: shkollimin në gjuhën amtare, administratën, gjyqet. Përfaqësuesit shqiptarë të të

gjitha viseve, pa dallim feje, janë bashkuar në qershor 1878 dhe kanë themeluar Lidhjen e Prizrenit, e cila ka organizuar ushtrinë e vet për t'i dëbuar pushtuesit dhe për ta formuar shtetin e pavarur shqiptar. Perandoria Osmane në vitin 1881 me forca të mëdha ushtarake e ka shuar Lidhjen e Prizrenit, duke burgosë e vrarë udhëheqësit kryesorë të saj, por shqiptarët në asnjë moment nuk e kanë ndërpre qëndresën kundër pushtuesve osmanë.

- Edhe pas shuarjes së Lidhjes së Prizrenit vazhdoi lufta e shqiptarëve për çlirim e për bashkim kombëtar. Për këtë arsye më 1899 u formua Lidhja e Pejës. Ideologu i formimit të kësaj lidhjeje gjithëshqiptare ishte Haxhi Zeka. Në Kuvendin e Lidhjes së Pejës morën pjesë rreth 500 përfaqësues nga shumë vise shqiptare dhe u vendos të formoheshin degë të Lidhjes në gjithë Shqipërinë. Në disa tekste thuhet edhe se: Detyrë e Lidhjes së Pejës ishte lufta kundër copëtimit të trojeve shqiptare nga shtetet fqinje, por kërkesa për autonomi nuk u shtrua nga Haxhi Zeka dhe përkrahësit e tij, për shkak të situatës jo të favorshme politike dhe qëndrimit të elementëve konservatorë.²⁶

Bërthama e shtjellimeve që bëjnë **tekstet e Shqipërisë** është kjo:

- Reformat e Tanzimatit përfshinin reforma në administratë, ushtri, financa dhe arsim. Territoret shqiptare u ndanë në katër vilajete (Shkodër, Kosovë, Manastir dhe Janinë). Në administratë u vendosën nëpunës të huaj të emëruar nga Stambolli, në ushtri u vendos shërbimi i detyruar ushtarak pa shpërblim, kurse taksat u rritën dhe mblihdeshin nga nëpunës osman, ndërkaq në arsim, krahas shkollave fetare u hapën edhe shkolla shtetërore. Shteti osman barazonte kombësinë me fenë dhe për pasojë nuk e njëjtte kombin shqiptar, duke e mohuar të drejtën e gjuhës dhe të drejtën për të hapur shkolla në gjuhën shqipe. Shqiptarët kundërshtuan reformat e Tanzimatit dhe që nga vitet 30 e deri në vitet 70 të shekullit 19 në territoret shqiptare shpërthyen kryengritje të mëdha kundër sundimit osman. Kryengritjet u shtypën pasi Sulltani përdori forca të mëdha ushtarake.
- Rilindja Kombëtare Shqiptare u zhvillua gjatë shekullit 19 dhe u shtri deri në vitin 1912, si qëllim kryesor duke e pasë çlirimin dhe pavarësinë e vendit përmes luftës së armatosur, bashkimin e të gjithë shqiptarëve në një komb pa dallim feje e krahine, për bashkimin e të gjitha tokave

.....
26 Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj. *Historia 5*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013. faqe 57-60; Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj. *Historia 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013. faqe 53-65; Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj. *Historia 11*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013. faqe 37-47; Bajraktari, Jusuf dhe Arbër Salihu. *Historia 12*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013. faqe 52-65;

shqiptare në një shtet. Në rrafshin e arsimit kombëtar, rilindësi Naum Veqilharxhi hartoi alfabetin dhe abetaren e parë në shqip më 1844. Sërbia, Mali i Zi dhe Greqia synonin t'i zgjeronin shtetet e tyre duke përfshirë toka shqiptare. Në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare ishin dy rryma: e para kërkonte shtet autonom brenda Perandorisë Osmane, që më vonë do të çonte në pavarësinë e Shqipërisë, ngaqë në fillim Shqipëria e pavarur nuk do të mund t'i përballonte kërcënimet e shteteve fqinje; kurse rryma e dytë kërkonte shpalljen e menjëhershme të pavarësisë së Shqipërisë, madje qoftë edhe duke luftuar me pushtuesit osmanë. Këto dy rryma do të ekzistojnë deri në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë.

- Nuk paraqitet gjë për dëbimin e shqiptarëve nga trevat e Sanxhakut të Nishit më 1877-1878.
- Lufta Ruso-Turke, që shpërtheu në prill 1877, përfundoi me fitoren e Rusisë në shkurt 1878 me Traktatin e Paqes në Shën Stefan, sipas të cilit Perandorisë Osmane i shkëputeshin rreth 80% e territoreve që zotëronte në Ballkan. Shqipëria nuk zihej fare në gojë dhe, e përbërë nga tri besime fetare, nuk njihej si një komb. Kjo i shqetësoi shqiptarët dhe i nxiti të reagonin. Në dhjetor 1877 u krijua Komiteti Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare (Komiteti i Stambollit) i drejtuar nga Abdyl Frashëri. Më 10 qershor 1878 në Prizren u themelua Lidhja e Prizrenit, ku morën pjesë delegatë nga shumica e krahinave shqiptare, por nuk arritën të merrnin pjesë të gjithë delegatët nga jugu. Lidhja e Prizrenit kundërshtonte copëtimin e viseve shqiptare. Brenda saj ekzistonin dy rryma: rryma kombëtare që synonte t'ia jepte Lidhjes karakterin kombëtar dhe rryma fetare, prapa të cilës qëndronte Perandoria Osmane, e që mëtonte t'ia jepte Lidhjes karakterin mysliman dhe t'i përfshinte të gjithë myslimanët e Ballkanit. Më 17 qershor 1878 u miratua Kararname (Akti i Vendimeve), në të cilin, për shkak të ndikimit të rrymës proosmane, shprehej besnikëria ndaj Perandorisë Osmane dhe Lidhja paraqitej organizatë që mbronte myslimanët në Ballkan. Mirëpo, në shumë degë të Lidhjes, si në veri, ashtu edhe në jug të Shqipërisë, mbizotëroi platforma kombëtare. Kështu, në korrik 1878 u mbledhën sërish Kuvendi i Lidhjes, që miratoi statutin e ri i cili Lidhjen e Prizrenit e shpalli Lidhje Shqiptare. Kongresi i Berlinit e rishikoi Traktatin e Shën Stefanit, por prapëprap iu dhanë Greqisë, Sërbisë dhe Malit të Zi toka të banuara me shqiptarë. Po ashtu, Kongresi i Berlinit nuk i mori parasysh kërkesat e shqiptarëve dhe i trajtoi ata sipas feve: myslimanët si turq, ortodoksët si grekë, katolikët si latinë. Perandoria Osmane nuk u tregua e zonja t'ia mbronte territoret shqiptare, prandaj raportet e Lidhjes së Prizrenit me Perandorinë Osmane u acaruan: forcat e Lidhjes së Prizrenit nuk iu bindën Perandorisë Osmane dhe i kundërshtuan me

armë forcat e kësaj, madje duke vrarë të dërguarin e Sulltanit, Mehmet Ali Pashë Maxharrin. Lidhja e Prizrenit kërkoi krijimin e një vilajeti shqiptar autonom brenda Perandorisë Osmane. Kjo Lidhje u shtyp me forcë nga Perandoria Osmane, kurse udhëheqësit e saj u burgosën e u dënuan me burg të përjetshëm. Ajo ishte lëvizja e parë çlirimtare me karakter kombëtar në të cilën morën pjesë të gjitha viset shqiptare.

- Në fund të shekullit 19 shqiptarët ringritën çështjen e autonomisë për viset shqiptare, që nënkuptonte bashkimin e katër vilajeteve shqiptare dhe përdorimin e gjuhës shqipe në administratë e në shkolla. Për këtë arsye, udhëheqësit e Lidhjes Kombëtare Shqiptare menduan ta formonin një organizatë të ngjashme me atë të Lidhjes së Prizrenit. Në janar 1899 në Pejë u formua Lidhja e Pejës në krye të të cilës u vu Haxhi Zeka. Detyrë themelore e saj ishte mbrojtja e viseve shqiptare nga copëtimi. Në pranverë të vitit 1900 Lidhja e Pejës u shpërnda.²⁷

Prirjet në **tekstet e Sërbisë** janë këto:

- Në Sërbinë e vjetër, sërbët ortodoksë jetonin të përzier me vendasit myslimanë dhe arbërit (shqiptarët). Sërbia e Vjetër ndahej në disa sanxhaqe, prej të cilave më të njohurat ishin: Novopazari, Nishi dhe Prizreni. Sërbët ishin shumicë gjithkund, përveç në Metohi dhe në disa pjesë periferike të Kosovës. Aty shumicën e popullsisë e përbënin shqiptarët e besimit mysliman, të shpërngulur nga veriu i Shqipërisë, kryesisht pas vitit 1690. Qendra e punëve nacionale sërbe ishin manastiret (Deçani, Peja, Graçanica) dhe disa qendra të mëdha qytetare (Prishtinë, Gjilan, Prizren, Shkup).
- Pjesa qendrore e Sërbisë së vjetër, posaçërisht Kosova e Metohija, nga viti 1804 e deri më 1875 ishte e zhytur në anarki. Sërbët e Kosovës kanë marrë pjesë në numër të konsiderueshëm në kryengritjen e parë sërbe, por më vonë, më 1820-tat, në Kosovën Qendrore ata u janë nënshtruar masave të ashpra të pashallarëve mashtrues shqiptarë. Për t'i krijuar hapësirë fafesisit të tyre nga Shqipëria e veriut që t'i popullonte fushat pjellore të Metohisë dhe Kosovës, ata i përzunë sërbët dhe i populluan fshatrat e tyre. Metropolitët sërbë të Prizrenit kanë qenë shpesh në shënjestër të nënçmimeve dhe sulmeve shqiptare, ndërsa manastiret sërbe janë mbrojtur prej plaçkitjeve të përhershme duke u paguar shuma të larta dhunuesve shqiptarë lokalë. Sërbët e Sërbisë së Vjetër pritnin se çlirimi do të vinte nëpërmjet Krizës Lindore. Paraardhësit e

.....

27 Dërguti, Menduh, Sonila Boçi dhe Ledia Dushku. *Historia 9*. Tiranë: Botime Shkollore Alban, 2013, faqe 44-64; Dërguti, Menduh, Ledia Dushku, Ferit Duka dhe Sonila Boçi. *Historia 12*. Tiranë: Botime Shkollore Alban, 2013, faqe 85-94.

sërbëve, nën komandën e majorit Radomir Putnik, mbërritëm në fillim të vitit 1878 deri në Graçanicë dhe aty mbajtën një përkujtim festiv për trimat e Betejës së Kosovës. Megjithatë, paqja ruso-turke i detyroi sërbët ta lëshonin Kosovën. Në mes të shekullit 19, gjatë kryengritjeve të shpeshta të arbërve kundër pushtetarëve lokalë dhe reformave të sulltanëve, çarshitë sërbë në Prishtinë, Prizren, Mitrovicë dhe qytete të tjera u plaçkitën dhe u mbyllën.

- Nuk paraqitet asgjë për Rilindjen Kombëtare Shqiptare.
- Nga Serbia jugore e çliruar, në Kosovë arritën shqiptarët e dëbuar nga Toplica e Jabllanica. Shqiptarët, për shkak të humbjes së pasurive në Sërbë, iu hakmorën sërbëve të Kosovës. Për shkak të kësaj, një numër i madh sërbësh nga zonat kufitare kaloi në Mbretërinë e Sërbisë, duke ua lënë pasurinë e vet shqiptarëve.
- Lidhja Shqiptare e Prizrenit (e ashtuquajtura Lidhja e Prizrenit 1878-1881) u mundua që tërë territorin e Sërbisë së Vjetër, Shqipërisë dhe Maqedonisë ta paraqiste si territor të pakontestueshëm shqiptar. Për këtë arsye, Serbia e Vjetër (Kosova) do të jetë hapësirë prej të cilës popullata sërbë përherë dhe pandëshkueshëm do të shtypet edhe do të shpërngulet prej përzënieve nga ana e shqiptarëve.
- Nuk paraqitet asgjë për Lidhjen e Pejës.²⁸

Në **tekstet e Malit të Zi** bërthama e zhvillimeve është kjo:

- Nuk ka asgjë për reformat e Tanzimatit dhe kryengritjet shqiptare nga vitet 30 deri në vitet 70 të shekullit 19.
- Për shkak të jetës shumëshekullore në kuadër të Perandorisë Osmane dhe të popullatës shumicë myslimane, shqiptarët filluan mjaft vonë të ndërtonin kulturën e vet kombëtare. Shqiptarët myslimanë kanë përdorur shkrimin turk/arab/persian, kurse shqiptarët katolikë shkrimin latin. Për shkak të identifikimit me osmanët, shqiptarët kanë mësuar në shkolla osmane. Vetëm në vitet 40 të shekullit 19 nis lufta e shqiptarëve për gjuhën dhe shkrimin vetjak. Në krye të kësaj lëvizje ishte Naum Veqilharxhi, i cili hartoi alfabetin e shqipes dhe botoi abetaren e parë shqipe.
- Nuk paraqitet asgjë për dëbimin e shqiptarëve nga trevat e Sanxhakut të Nishit më 1877-1878.

.....
28 Bataković, Dušan. *Istoria 7*. Beograd: Zavod za udžbenike, 2011, faqe 174-175.

- Në vitet 1875-1878 një grup shqiptarësh me ndikim themeloi në Stamboll Komitetin për Mbrojtjen e të Drejtave të Shqiptarëve dhe hartoi programin e autonomisë territoriale të shqiptarëve të katër vilajeteve (Shkodër, Kosovë, Manastir dhe Janinë). Mirëpo, me kushtet që Rusia ia impononte Perandorisë Osmane me Paqen e Shën Stefanit, u vu në pikëpyetje programi për autonomi territoriale, pasi që pjesët anësore të këtyre vilajeteve u takuan Bullgarisë, Sërbisë, Malit të Zi dhe Greqisë. Krerët shqiptarë shfrytëzojnë pakënaqësinë e Austro-Hungarisë dhe të Fuqive të Mëdha të tjera për ta rishikuar Paqen e Shën Stefanit në Kongresin e Berlinit. Në prag të Kongresit të Berlinit, shqiptarët themeluan Lidhjen e Prizrenit. Udhëheqësit e Lidhjes kërkuan që të shqyrtohet edhe çështja shqiptare, por kërkesat e tyre s'u morën parasysh. Lidhja iu kundërvu ushtarakisht vendimeve për t'i lëshuar Plavën dhe Gucinë Malit të Zi dhe Greqisë pjesë të Epirit të Veriut. Konflikti shqiptaro-malazez u zgjidh me ndërmjetësimin e Fuqive të Mëdha duke i dhënë Malit të Zi Ulqinin në vend të Plavës e të Gucisë. Meqë Lidhja me kërkesën për autonomi të plotë ra në konflikt të hapur me Perandorinë Osmane, kjo e fundit e përdori forcën dhe e shtypi Lidhjen në fund të vitit 1881 duke i burgosë ose internu udhëheqësit e saj.
- Më 1899 në Pejë, mbi programin e Lidhjes së Prizrenit, u themelua Lidhja e Pejës. Pas revolucionit xhonturk në vitin 1908, të pakënaqur me qëndrimin e pushtetit, nga viti 1909 deri me 1912 shqiptarët u përpoqën ta realizonin autonominë me kryengritje, por pa e vënë në pikëpyetje integritetin territorial të Perandorisë Osmane. Fatin e tyre politik, shqiptarët e lidhën me mbrojtjen e Perandorisë Osmane.²⁹

Përmbajtja e **teksteve të Maqedonisë** ka këtë thelb:

- Në vitet e 30 të shekullit 19, në periudhën e Tanzimatit u ndërmorën një varg reformash administrative, financiare, ushtarake dhe arsimore, qëllimi i të cilave ka qenë vendosja e një administrate të centralizuar dhe përforcimi i ushtrisë, me çka të gjithë shtetasit e Perandorisë Osmane do të ishin të barabartë, pa marrë parasysh religjionin ose kombin. Kështu, Perandoria Osmane vendosi funksionarë të lartë osmanë në administratë, që nuk e njihnin as gjuhën e as zakonet e shqiptarëve, filloi rekrutimin e ushtarëve të rregullt, rriti tatimet, e me radhë. Meqë Perandoria Osmane e identifikonte kombin me fenë, nuk i njohu

.....
 29 Andrijasheviq, Zhivko, Sait Shabotiq, Dragutin Papoviq dhe Slobodan Drobnjak. *Historia B*. Podgoricë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 2008, faqe 85; Borozan Gjorgje, Sasha Knezheviq dhe Sait Shabotiq. *Historia 3*. Podgoricë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 2009, faqe 138-139.

shqiptarët si komb më vete dhe nuk ua pranoi të drejtën e zhvillimit të arsimit në tërë Shqipërinë. Këto reforma keqësuan gjendjen dhe për rrjedhojë shpërthyen një sërë kryengritjesh antiosmane që nisën në vitet 30 e vazhduan deri në vitet 70 të shek. 19. Ndër kërkesat e kryengritësve, më e rëndësishmja ishte ajo për qeverisjen e vendit nga shqiptarët. Kryengritësit shqiptarë kërkonin nga Sulltani që të liroheshin nga reformat dhe t'u njihet drejta për vetëqeverisje autonome. Kryengritjet e periudhës së Tanzimatit kishin karakter popullor dhe në to morën pjesë shqiptarë të krahinave të ndryshme, pa dallim feje. Kryengritësit luftuan kundër shtypjes kombëtare dhe kundër shfrytëzimit ekonomik, duke e detyruar Perandorinë Osmane që në viset malore ta shtyente zbatimin e reformave.

- Rilindja Kombëtare Shqiptare ishte lëvizje e gjërë që synonte çlirimin dhe bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare në një shtet të vetëm e të pavarur. Ajo filloi në vitet 30 të shekullit 19 dhe përfundoi më 1912 me shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë.
- Nuk paraqitet deportimi i shqiptarëve muslimanë nga trevat e Sanxhakut të Nishit më 1877-1878.
- Me Marrëveshjen e Shën Stefanit mes Perandorisë Osmane dhe Ruisë, të nënshkruar më 3 mars 1878, parashihej që një pjesë e konsiderueshme e tokave shqiptare t'u jepeshin Bullgarisë, Sërbisë dhe Malit të Zi. Kjo nxiti pakënaqësi ndër shqiptarët. Edhe Fuqitë e Mëdha (Gjermania, Anglia, Franca, Italia, Austro-Hungaria dhe Rusia) ishin të pakënaqura, prandaj kishin vendosë të thirrnin një kongres ndërkombëtar në Berlin. Në këtë situatë, përfaqësuesit shqiptarë nga të gjitha trojet, më 10 qershor 1878 themeluan në Prizren një lidhje të përgjithshme me karakter kombëtar për mbrojtjen e tokave etnike shqiptare nga copëtimi. Kur Perandoria Osmane e vërejti se nuk mund ta pengonte mbajtjen e Kuvendit të Lidhjes së Prizrenit, tentoi ta shfrytëzonte për qëllimet e veta dhe u mundua t'i jepte karakter islamik. Kongresi i Berlinit i ndryshoi disa vendime të Shën Stefanit, por edhe vendimet e këtij Kongresi nxitën pakënaqësi te shqiptarët për shkak të rrënimit të tërësisë territoriale dhe të interesave kombëtare të tyre. Lidhja e Prizrenit organizoi forcat e veta të armatosura për mbrojtjen e tokave shqiptare. Për shkak të trysnisë nga Fuqitë e Mëdha, Perandoria Osmane synoi t'i bindte shqiptarët të mos i kundërshtonin vendimet e Kongresit të Berlinit dhe prandaj e dërgoi marshallin Mehmet Ali Pasha në Kosovë, të cilin forcat e Lidhjes së Prizrenit e vranë në Gjakovë. Lidhja e Prizrenit synoi autonominë si hap të parë drejt pavarësisë. Në vitin 1881 Perandoria Osmane iu kundërvu ushtarakisht Lidhjes së Prizrenit, duke kry terror të paparë.

- Me qëllim që t'i kundërshtonin pretendimet e shteteve fqinje ndaj tokave shqiptare, patriotët shqiptarë formuan një lidhje të re sipas shembullit të Lidhjes së Prizrenit, që u quajt Lidhja e Pejës. E udhëhequr nga Haxhi Zeka, ajo u themelua në janar të vitit 1899 me pjesëmarrjen e rreth 500 vetave, kryesisht nga Kosova. Detyrë e Lidhjes së Pejës ishte lufta kundër copëtimit të trojeve shqiptare nga shtetet fqinje, ndërkaq kërkesa për autonomi u la për më vonë. Lidhja e Pejës e shqetësoi Perandorinë Osmane, prandaj përmes forcave të mëdha ushtarake, në vitin 1900, e shpërndau Lidhjen e Pejës.³⁰

Përmbledhje

Në gjysmën e parë të shekullit 19 Perandoria Osmane, me qëllim që të shndërrohet në një shtet bashkëkohor, filloi zbatimin e një morie reformash në ushtri, siç ishin: pezullimi i njësisve të jeniçerëve, pezullimi i sistemit të vjetruar të timareve, dërgimi i oficerëve për stërvitje në Francë, mbajtja e uniformave të stilit perëndimor, e me radhë. Këto u shoqëruan me reforma në arsim duke zhvilluar sistem shkollor shtetëror, si dhe duke shpallë të drejta të barabarta për jomyslimanët. Tekstet mësimore të historisë në Kosovë e në Shqipëri, por edhe në Maqedoni, i paraqesin këto reforma vetëm si shtypje të shqiptarëve që po luftonin për liri nga pushtuesit osmanë, kurse tekstet e Sërbisë dhe të Malit të Zi s'i paraqesin fare. Në të vërtetë, për t'i jetësuar këto reforma, Perandoria Osmane kishte nevojë të merrte pushtetin real nga krerët e provincave, të cilët bënë çmos për t'i ruajtur perandoritë e veta të vogla lokale.

Në fillim të shekullit 19, përhapja e ideve nacionaliste – dëbimi i sundesve osmanë dhe krijimi i shteteve të pavarura kombëtare – çonte në kundërshtime edhe me sundimtarët provincialë e edhe me Stambollin, prandaj ky opsion nuk merrej me mend në këtë kohë nga popullatat myslimane, përfshi këtu shqiptarët, të cilët mbetjen në Perandorinë Osmane e shihnin si garanci kundër pushtimit dhe dëbimit nga të tjerët. Kjo gjë që në mënyrë korrekte paraqitet vetëm në tekstet e Malit të Zi. Në fakt, ndër arsyet kryesore të rebelimeve nuk ishin kërkesat për autonomi e çlirim kombëtar, por kërkesa për të mos u rekrutuar, kundërshtimi i uniformave të stilit perëndimor, taksat e reja, përpjekjet për çarmatosjen e popullatës, e kështu me radhë.

Në asnjërën prej teksteve të këtyre vendeve nuk përmendet që myslimanë e të krishterë, shqiptarë e sërbë, më 1822 kishin organizuar një protestë të madhe

30 Boshkoski, Millan, Nebi Dervishi, Silvana Sidorovska – Cupovska, Natasha Kotlar, Jordan Ilioski, Dimko Popovski. *Historia 2 arsimi gjimnazor*. Shkup: Prosvetno Dello, 2008, faqe 126-138.

– që nuk ishte kryengritje, por ankesë drejtuar pushtetit më të lartë – për të kërkuar dorëheqjen e sundimitarit tiranik, Maliq Pashë Gjinolli, që sundonte nga Prishtina. Po ashtu, në asnjërën prej teksteve të këtyre vendeve nuk përmenden sundimtarët lokalë të Prizrenit gjatë kësaj periudhe nga familja Rrotlla – Rustem Rrotlla e më pas edhe Mahmut Rrotlla, që kishin dashamirësi të theksuar ndaj sërbevëve.

Duhet shtuar se në këtë kohë u imponua një sistem i ri i shkollave shtetërore në Kosovë në gjuhën turke për myslimanët, në gjuhën sërbe për ortodoksët, kryesisht për sërbyt, dhe në gjuhën italiane për katolikët. Çdo bashkësi lejohej të hapte shkollat në gjuhën e vet dhe lejohej edhe financimi i këtyre shkollave nga shtetet fqinje, por shteti osman megjithatë u mohonte shqiptarëve të drejtën për të hapur shkolla. Kjo përmendet në tekstet e Kosovës, të Shqipërisë e të Maqedonisë, por pa u potencuar arsyet e këtij mohimi, të cilat gjenden vetëm në tekstet e Malit të Zi: shumica e shqiptarëve ishin myslimanë, përdornin shkrimin arab, identifikoheshin me osmanët dhe mësonin në shkolla osmane.

Tekstet e Kosovës, të Shqipërisë dhe të Maqedonisë e paraqesin Rilindjen Kombëtare Shqiptare, që filloi në vitet 30 të shekullit 19 dhe përfundoi me shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë më 1912, si një lëvizje të gjërë që synonte çlirimin dhe bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare në një shtet të vetëm e të pavarur. Tekstet e Sërbisë nuk e pasqyrojnë fare Rilindjen Kombëtare Shqiptare, kurse ato të Malit të Zi e pasqyrojnë në mënyrë shumë më korrekte, duke pohuar se shqiptarët në shumicën dërrmuese të rasteve përpiqeshin ta realizonin autonominë pa e vënë në pikëpyetje integritetin territorial të Perandorisë Osmane.

Në këtë pikë përjashtim bëjnë vetëm tekstet e Shqipërisë që i portretojnë dy rryma brenda Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, por duke ua shtrembëruar qëllimet. Sipas tyre, njëra rrymë kërkonte shtet autonom brenda Perandorisë Osmane, që më vonë do të çonte në pavarësinë e Shqipërisë, kurse tjetra kërkonte shpalljen e menjëhershme të pavarësisë së Shqipërisë, madje qoftë edhe duke luftuar me pushtuesit osmanë. Në të vërtetë, në masë të madhe, rrymat brenda Lëvizjes Kombëtare Shqiptare ndaheshin për formën e autonomisë brenda Perandorisë Osmane.

Dëbimi masiv i shqiptarëve myslimanë prej Sërbisë nga trevat e Sanxhakut të Nishit më 1877-1878, nuk përmendet fare në tekstet e Malit të Zi e të Maqedonisë, e madje as në ato e Shqipërisë. Çuditërisht, tekstet e Sërbisë thonë se nga Serbia jugore e çliruar, në Kosovë arritën shqiptarët e dëbuar nga Toplica e Jabllanica, por nuk e specifikojnë se kush dhe pse i kishte dëbuar. Po ashtu, këto tekste shtojnë se shqiptarët për shkak të humbjes së pasurive në Sërbi, iu hakmorën

sërbëve të Kosovës, për çka një numër i madh i sërbëve nga zonat kufitare kaloi në Mbretërinë e Sërbisë, duke ua lënë pasurinë e vet shqiptarëve.

Natyrisht, ky dëbim figuron në tekstet e Kosovës, por shifrat që japin këto tekste për 160 mijë shqiptarë të dëbuar nga këto treva, ka të ngjarë të jetë e fryrë. Noel Malcolm thotë se megjithëse mungojnë shifra të sakta, një studim bashkëkohor bie në përfundimin se në krejt këtë rajon kishte pasë 110 mijë shqiptarë, kurse numri i muhaxhirëve (refugjatëve) që ishin vendosë në territorin e Kosovës në vitet 1877-1878, nga një vlerësim i përafërt, del të jetë rreth 50 mijë. Po ashtu, këto tekste nuk theksojnë kund se përveç shqiptarëve, në territorin e tanishëm të Kosovës u vendos edhe një numër i vogël sllavësh myslimanë. Në këto tekste nuk jepen shembuj si, ta zëmë, rasti i një komandanti të armatës sërbë që nuk kishte pranuar t'i dëbonte shqiptarët nga qyteti Vranjë me arsyetimin se ata ishin të urtë dhe të qetë.

Në asnjërin prej këtyre teksteve, përveç në ato të Sërbisë, nuk zihet askund në gojë se ky dëbim i shqiptarëve myslimanë nga këto treva dhe vendosja e tyre në territorin e tanishëm të Kosovës ka ndikuar që të ashpërsohen raportet mes myslimanëve dhe të krishterëve në Kosovë – muhaxhirët (refugjatët) kishin një qëndrim tejet armiqësor ndaj të krishterëve vendas, sidomos ndaj sërbëve ortodoksë. Po ashtu, nuk përmendet askund se pjesërisht edhe për shkak të këtij qëndrimi, ka pasur një shpërngulje të vazhdueshme të sërbëve nga Kosova (natyrisht, kishte edhe arsye të tjera të shpërnguljes si amullia e përgjithshme, administrata e dobët, jeta më e mirë në Sëri, e me radhë). Lidhur me shifrat e sërbëve të shpërngulur nga Kosova në periudhën 1878-1912, Malcolm thotë se 60 mijë duket të jetë supozim i arsyeshëm.

Sa i takon Lidhjes së Prizrenit, duhet thënë se në Prizren nuk janë mbledhë – ashtu siç pretendojnë sidomos tekstet e Kosovës e të Shqipërisë, por edhe ato të Maqedonisë – të gjithë përfaqësuesit e trojeve shqiptare, ngaqë shumica dërmuese e përfaqësuesve në Kuvendin e Prizrenit kanë qenë nga Kosova dhe nga Malësia, kurse nga Shqipëria e Jugut kanë qenë vetëm dy përfaqësues, njëri prej të cilëve Abdyl Frashëri. Lidhur me përkatësinë fetare të pjesëmarrësve të Lidhjes së Prizrenit, sidomos tekstet e Kosovës e të Shqipërisë, por edhe ato të Maqedonisë, pretendojnë përfshirjen e të gjitha komuniteteve fetare shqiptare, por vetëm pesë nga delegatët e mbledhur në Prizren ishin të krishterë, madje në fund të dokumentit të parë të nxjerrë nga Lidhja e Prizrenit thuhet 'ky dokument është nënshkruar nga 47 deputetë **myslimanë**, që të gjithë nga qytete të Shqipërisë Veriore e të Bosnjës'. Në këtë dokument, që quhet Kararname ose Akti i Vendimeve, miratuar më 18 qershor 1878, nuk thuhet kurrëgjë për shkollat, për bashkimin e trojeve shqiptare në një vilajet, për autonominë, e aq më pak për shtetin e pavarur shqiptar.

Në tekstet e Kosovës përmendet vetëm se Perandoria Osmane në vitin 1881 me forca të mëdha ushtarake e ka shuar Lidhjen e Prizrenit, duke i burgosë e vra udhëheqësit kryesorë të saj, por nuk përmendet bashkëpunimi mes Lidhjes së Prizrenit dhe Qeverisë së Perandorisë Osmane (gjë që përmendet vetëm në tekstet e Malit të Zi), ndonëse në fillim pushteti osman kishte simpati të madhe për Lidhjen e Prizrenit dhe nuk krijoi kurrfarë pengesash për formimin e saj, sepse kjo e fundit synonte po ashtu t'i ruante hapësirat e banuara me shqiptarë që deri atëherë ishin nën sundimin e Perandorisë Osmane. Prandaj, qysh në nenin 1 të Kararnames thuhet se Lidhja e Prizrenit formohet me qëllim që të kundërshtonte çdo qeveri, përveç asaj të Portës së Lartë, kurse në nenin 2 theksohet se qëllimi i Lidhjes së Prizrenit është "...t'i mbrojtë të drejtat perandorake të personit të papërllyeshëm të madhërisë së Tij Sulltanit, sundimtarit tonë". Tutje, ky dokument i referohet shariatit për sa i takon mbrojtjes së jetës, të pasurisë dhe të nderit të shokëve besnikë të besimit jomysliman, ndërkaq në nenin e fundit thuhet se "Lidhja do të kalojë brez pas brezi, tek fëmijët e fëmijëve tonë dhe ai që shkëputet prej saj do të konsiderohet 'tradhtar i fesë islame' e do të mallkohet e përbuzet prej anës sonë."

Bashkëpunimi i Lidhjes së Prizrenit me Perandorinë Osmane mori fund pasi që një turmë e mllefosur shqiptarësh e vrau në Gjakovë Mehmet Ali Pashën, të dërguarin e Perandorisë së Osmane që vinte për t'i bindur shqiptarët t'i pranojnë vendimet e Kongresit të Berlinit për ndryshimin e kufijve. Vetëm një vit e pak pas themelimit të Lidhjes së Prizrenit, në tetor 1879, në një mbledhje që mbahet në Prizren, Lidhja pajtohet ta pranojë programin e autonomisë, kurse pas gati tre vjetëve, në një tubim të madh në Prizren, Lidhja deklaroi se do të angazhohet për pavarësinë e plotë, gjë që përforcon vendosmërinë e Perandorisë Osmane për ta shtypë atë. Pas shtypjes së dhunshme të Lidhjes së Prizrenit nga Perandoria Osmane, gjatë tri dekadave të ardhshme pati kryengritje të ndryshme në Kosovë, por të gjitha ishin lokale dhe jetëshkurtra.

Po ashtu, në asnjë prej teksteve nuk prezentohen as grupimet politike gjatë periudhës së Lidhjes së Prizrenit. Tekstet e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë thonë vetëm "lëvizja kombëtare shqiptare", duke lënë të kuptohet se ekzistonte vetëm një forcë politike me vazhdimësi historike që zhvillonte luftë të pandërprerë për t'u çliruar nga pushtuesi osman. Në Lidhjen e Prizrenit ekzistonin dy rryma: *tradicionalistët myslimanë*, të cilët kanë dominuar sidomos në Kosovë dhe *intelektualët autonomistë*, të cilët gëzonin simpati kryesisht jashtë Kosovës. Këto rryma nuk përmenden në tekstet e Sërbisë dhe Malit të Zi, të cilat e paraqesin Lidhjen e Prizrenit fare sipërfaqësisht.

Lidhja e Pejës, e kryesuar nga kleriku i zjarrtë mysliman, Haxhi Zeka, nuk pasqyrohet fare në tekstet mësimore të Sërbisë e të Malit të Zi, por pasqyrohet

në ato të Kosovës, të Shqipërisë e të Maqedonisë. Kjo lidhje u angazhua për një autonomi të shkallës së lartë në kuadër të Perandorisë Osmane, e jo për pavarësi ose bashkim kombëtar, siç pretendojnë disa prej teksteve mësimore të historisë në Kosovë. Në asnjë prej këtyre teksteve nuk përmendet kund se rivali i Haxhi Zekës, Riza bej Kryeziu nga Gjakova, kërkonte që përpjekjet e lëvizjes të drejtoheshin vetëm kundër armiqve të Sulltanit, e jo kundër Sulltanit. Po ashtu, tekstet e Kosovës e të Shqipërisë, por jo edhe ato të Maqedonisë, thonë se pjesëmarrësit e Kuvendit të Lidhjes së Pejës ishin nga shumë vise shqiptare, por, në të vërtetë, shumica dërrmuese e tyre ishin nga Kosova.

Pikësynimi i parë Lidhjes së Pejës ishte armëpushimi dhe ndërprerja e hakmarrjeve ndërmjet të gjithë shqiptarëve, prandaj edhe u njoh si Besa ose Besa-Besë. Lidhja e Pejës u përqendrua kryesisht rreth mbrojtjes territoriale. Programi 12-pikësh i Lidhjes së Pejës fillonte me besnikërinë e shprehur ndaj Sulltanit dhe me besën mbi Kuranin, gjë që nuk përmendet në asnjë prej teksteve. Autonomia nuk përmendej në këtë listë, siç pretendojnë tekstet e Kosovës e të Shqipërisë, por kishte disa elemente autonomiste si: bashkimi i katër vilajeteve në një njësi unike shqiptare, themelimi i komiteteve vendase myslimane që do të ruanin rendin publik dhe do t'i zbatonin Sheriatin dhe Kanunin e Lekës. Detyrë e Lidhjes së Pejës ishte lufta kundër copëtimit të trojeve shqiptare nga shtetet fqinje, por kërkesa për autonomi nuk u shtrua nga Haxhi Zeka dhe përkrahësit e tij, për shkak të situatës jo të favorshme politike dhe qëndrimit të elementëve konservatorë.

Për sulmet ndaj objekteve ortodokse sërbe në Kosovë bëjnë fjalë vetëm tekstet e Sërbisë, të cilat thonë se ato kanë qenë shpesh në shënjestër të nënçmimeve dhe sulmeve shqiptare, që janë mbrojtur prej plaçkitjeve të përhershme duke u paguar shuma të larta dhunuesve shqiptarë lokalë. Ndërkaq, për përkujdesjen ndaj këtyre objekteve nuk flitet në asnjërën palë të teksteve. Fjala vjen, nuk përmendet askund se Isa Boletini kishte ruajtur bashkësinë ortodokse sërbe në rajonin e Mitrovicës, madje ishte shpërblyer me dekoratë nga konsulli sërb për këtë. Nuk përmendet askund as se rojtarët shqiptarë e kishin mbrojtur Manastirin e Deçanit.³¹

.....

31 Malcolm, Noel. *Kosovo - A Short History*. London: Pan Macmillan, 2002, faqe 181-201 dhe 217-238; Schmitt, Oliver. *Kosova: histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*. Prishtinë: Koha, 2012, faqe 47-133; Schmitt, Oliver. *Shqiptarët - një histori midis Lindjes dhe Perëndimit*. Tiranë: KËB, 2012, faqe 136-168; Bartl, Peter. *Shqipëria - nga mesjeta deri sot*. Prizren: Drita, 1999, faqe 78-105; Gawrych, George. *Gjysmëhëna dhe shqiptarja - sundimi otoman, islamizimi dhe shqiptarët 1874-1913*. Tiranë: Bota Shqiptare, 2007; Teksti i plotë i Kararnameve ose Aktit të Vendimeve të Lidhjes së Prizrenit mund të gjendet në Belegu, Xhafer "Lidhja e Prizrenit dhe veprimet e saj", Tiranë, 1939.

5. KOSOVA NËN SUNDIMIN SËRB 1912-2000

5.1. Kosova 1912-1913

Ky nënkaptull heton konkretisht se si prezentohet kryengritja shqiptare e vitit 1912, çlirimi/okupimi i Kosovës në tetor e nëntor të vitit 1912 bashkë me krimet e kryera nga forcat serbe në periudhën tetor 1912 – mars 1913, shpallja e pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912, si dhe Konferenca e Londrës më 1912-1913.

Lidhur me temat e mësipërme, kjo është bërthama e shtjellimeve që bëjnë **tekstet e Kosovës**:

- Shqiptarët kërkonin me ngulm shtetin e tyre të pavarur, por Perandoria Osmane nuk pranonte t'ua njihte dhe prandaj shqiptarët në të gjitha trevat u hodhën në luftë kundër pushtuesve. Por, shqiptarët u gjendën në pozitë të vështirë, pasi në njërin anë duhej të luftonin kundër osmanëve për t'u çliruar, kurse në tjetrën kundër shteteve fqinje – Serbisë, Malit të Zi, Bullgarisë dhe Greqisë – për t'u mbrojtur. Në fillim Perandoria Osmane nuk i pranoi kërkesat për autonomi, por kur kryengritësit iu drejtuan Shkupit, kryeqytetit të vilajetit të Kosovës dhe e çliruan atë, ajo i pranoi ato kërkesa, por me disa ndryshime. Për shkak të provokimeve të armatosura të Malit të Zi, kryengritësit pranuan marrëveshjen me osmanët dhe shpallën përfundimin e kryengritjes.
- Ushtria serbe e pushtoi Kosovën në tetor të vitit 1912 dhe iu drejtua pjesëve të tjera të Shqipërisë së Veriut dhe të Mesme. Pushtimi nga ushtritë e shteteve fqinje u shoqërua me veprime terroriste e gjakatare kundër popullsisë shqiptare, e cila iu nënshtrua dhunës dhe terrorit të shovinizmit të shteteve ballkanike.
- Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë ishte rezultat i luftës disashekullore të shqiptarëve kundër pushtuesve osmanë. Pengesë për zhvillimin e aktivitetit të Qeverisë së Shqipërisë ishin Greqia, Serbia dhe Mali i Zi, që kishin hyrë në territorin shqiptar. Shtetet europiane në Konferencën e Ambasadorëve në Londër më 1912-13 morën vendim për copëtimin e viseve shqiptare, duke u dhënë shumë toka shqiptare shteteve fqinje, ku u përfshinë Kosova dhe Çamëria.³²

Bërthama e shtjellimeve që bëjnë **tekstet e Shqipërisë** është kjo:

- Kryengritja shqiptare e vitit 1912 kundër Perandorisë Osmane filloi në vilajetin e Kosovës, e më pas u përhap edhe në vilajetet e tjera.

.....
32 Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj. *Historia 5*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013, faqe 68-77; Bajraktari, Jusuf, Fehmi Rexhepi dhe Frashër Demaj. *Historia 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2011, faqe 74-81; Abdylti, Ramiz dhe Emine Bakalli. *Historia 11*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2012, faqe 188-195; Bajraktari, Jusuf dhe Arbër Salihu. *Historia 12*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013, faqe 144- 154.

Kërkesa e kryengritësve shqiptarë ishte autonomia brenda Perandorisë Osmane. Perandoria Osmane nuk i pranoi kërkesat për autonomi, andaj kryengritësit e morën Shkupin, kryeqytet i vilajetit të Kosovës. Kjo shqetësoi Perandorinë Osmane, por edhe shtetet ballkanike. Perandoria Osmane pranoi pjesën më të madhe të kërkesave të shqiptarëve, por me disa ndryshime. Kryengritësit i pranuan ndryshimet, sepse situata e jashtme po keqësohej nga përpjekjet e shteteve ballkanike për t'i copëtuar midis tyre viset shqiptare.

- Ushtria sërbe e pushtoi Kosovën dhe iu drejtua pjesëve të tjera të Shqipërisë së Veriut dhe të Mesme. Pushtimi i Kosovës dhe i viseve shqiptare nga ushtria sërbo-malazeze u shoqërua me rrënimin e fshatrave, qyteteve dhe me humbje njerëzore. Qeveria sërbe dhe ajo malazeze ndryshuan përbërjen e popullsisë së viseve shqiptare përmes largimit me dhunë të shqiptarëve, detyrimit për të ndërruar fenë dhe favorizimit të kolonizimit të tokave shqiptare me popullsi sllave. Udhëheqësit kosovarë që ndodheshin në Shqipëri organizuan një kryengritje të armatosur në tokat që kishin kaluar nën sundimin sërëb e malazez, me qëllim që të bashkoheshin me Shqipërinë. Ushtria sërbe e shtypi këtë kryengritje duke djegur, shkatërruar fshatra dhe dhunuar popullatën vendase. Për të shpëtuar, një pjesë e banorëve u shpërngul në Shqipëri.
- Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë pati rëndësi të madhe sepse i dha fund sundimit pesëshekullor dhe kurorëzoi luftën e bërë prej shqiptarëve. Konferenca e Londrës vendosi që Shqipëria të shpallej principatë autonome, sovranë, e trashëgueshme nën garancitë e gjashtë Fuqive të Mëdha. Kjo konferencë vendosi për kufijtë e Shqipërisë, duke lënë jashtë saj Kosovën dhe Çamërinë.³³

Prirjet në **tekstet e Sërbisë** janë këto:

- Nuk pasqyrohet hiç kryengritja shqiptare e vitit 1912.
- Armata e Tretë Sërbe me depërtim të rrufeshëm e çliron **Kosovën**, dhe më tej përmes Shqipërisë veriore depërton në **Detin e Adriatikut**. Më 23 tetor 1912, në fushën ku është zhvilluar Beteja e Kosovës e vitit 1389, sërëbët e festojnë çlirimin e Kosovës, djepit të shtetësisë së Sërbisë, që e kishin pritë shumë gjenerata gjatë shekullit 19. Nuk ka asnjë fjalë për krimet e kryera nga forcat sërbe në tetor 1912 – mars 1913.

.....
 33 Dërguti, Menduh, Sonila Boçi dhe Ledia Dushku. *Historia 9*. Tiranë: Botime Shkollore Alban, 2013, faqe 64-73; Dërguti, Menduh, Ferit Duka, Ledia Dushku dhe Sonila Boçi. *Historia 12*. Tiranë: Botime Shkollore Alban, 2013, faqe 84-86.

- Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912 praktikisht nënkuptonte që Sërbia nuk do të fitonte dalje në det.³⁴

Në **tekstet e Malit të Zi** bërthama e zhvillimeve është kjo:

- Me kryengritje nga viti 1909 e deri në gjysmën e vitit 1912 shqiptarët e Vilajetit të Kosovës e të Shkodrës i imponuan Perandorisë Osmane zgjidhjen urgjente të çështjes shqiptare. Me qëndresën e fuqishme të lëvizjes kryengritëse kosovare në vitin 1912 dhe me hartimin e programit të 14 pikave u përcaktuan suazat e autonomisë shqiptare. Bashkëpunimi mes shqiptarëve dhe anëtarëve të Aleancës Ballkanike nuk u realizua.
- Në fillim të tetorit të vitit 1912 forcat malazeze i nisën me sukses operacionet ushtarake në drejtim të Metohisë (Peja, Gjakova). Më pas ushtria sërbe, pas marrjes së Kosovës dhe pjesës më të madhe të Maqedonisë, kaloi nëpër Shqipëri, arriti në brigjet e Adriatikut dhe mori Durrësin në fund të nëntorit të vitit 1912. Në vend të luftës për çlirim të bashkatdhetarëve, mbizotëruan interesat e elitave politike, që të gjitha përpjekjet e luftës i kthyen në grabitje territoriale, në larje hesapesh, në plaçkitje dhe në mosrespektim të të drejtave kombëtare të popujve të veçantë, veçmas të maqedonasve.
- Në kohën e mbizotërimit të plotë të Aleancës Ballkanike, kur Perandoria Osmane u detyrua të kërkonte armëpushim, në kuvendin e krerëve shqiptarë në Vlorë, në nëntor të vitit 1912, përfaqësuesit shqiptarë nga të gjitha viset, të udhëhequr nga Ismail Qemali, e shpallën pavarësinë e Shqipërisë. Në Konferencën e Londrës mbizotëroi çështja e Shqipërisë. Konferenca e njohu Shqipërinë si shtet të ri autonom dhe hapi çështjen e kufijve të saj. Me këtë u prishën planet e aleatëve ballkanikë. Sërbia u detyrua ta tërhiqte ushtrinë nga Shqipëria dhe të hiqte dorë nga dalja në det. Sërbisë iu njohën territoret që mori në Novi Pazar, në Kosovë dhe në Maqedoni.³⁵

Përmbajtja e **teksteve të Maqedonisë** ka këtë thelb:

- Kryengritja e përgjithshme shqiptare e vitit 1912 filloi për shkak se Perandoria Osmane nuk i plotësoi kërkesat shqiptare për autonomi kombëtare. Qendra e kryengritjes ishte Kosova. Perandoria Osmane dhe krerët proturq ishin kundër autonomisë.

.....
34 Đurić, Đorđe dhe Momčilo Pavlović. *Istorija 3*. Beograd: Zavod za udžbenike, 2010, faqe 67.

35 Andrijasheviq, Zhivko, Sait Shabotiq, Dragutin Papoviq dhe Sllobodan Drobnjak. *Historia 8*. Podgoricë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 2008, faqe 121-122, 130-133; Borozan Gjorgje, Sasha Knezheviq dhe Sait Shabotiq. *Historia 3*. Podgoricë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 2009, faqe 156-160.

- Forcat aleate ballkanike, paralelisht me luftën kundër forcave osmane, filluan pushtimin e tokave shqiptare dhe maqedonase. Forcat sërëbe pushtuan Kosovën dhe u drejtuan kah pjesët e tjera të Shqipërisë Veriore dhe të Mesme. Në Kosovë ishte vendosur regjim ushtarako-policor, ndaloheshin shkollat, alfabeti shqip, flamuri, etj. Gjendja e re ishte shumë e vështirë për shqiptarët, prandaj për ta shpëtuar atdheun nga rreziku, organizuan rezistencë kundër ushtrisë sërëbe.
- Pasi Lufta Ballkanike zhvillohej me shpejtësi të madhe dhe pasi Perandorisë Osmane kishte filluar t'i binte fuqia në Ballkan, nuk ishte më i drejtë vendimi për ta kërkuar autonominë e deriatëhershme, por kërkohej pavarësia e tërësishme. Prandaj më 28 nëntor në Vlorë u shpall pavarësia e Shqipërisë, e cila ishte rezultat i luftërave shekullore të popullit shqiptar kundër sundimit osman. Shpallja e pavarësisë ishte fitore e madhe kundër sundimit të gjatë osman dhe kundër planeve pushtuese të shteteve fqinje. Në Konferencën e Londrës, ku vend të rëndësishëm zuri çështja shqiptare, nuk u mor parasysh parimi i vetëvendosjes, por e drejta e forcave fitimtare. Konferenca, në kundërshtim me vullnetin e popullit shqiptar, vendosi që Kosova dhe viset e tjera shqiptare në veri t'i takonin Sërbisë dhe Malit të Zi.³⁶

Përmbledhje

Kryengritja e përgjithshme e vitit 1912, e udhëhequr nga Hasan Prishtina, fillimisht synonte autonomi territoriale brenda Perandorisë Osmane, me njohje zyrtare të kufijve të territorit me shumicë shqiptare dhe me autoritete civile e ushtarake të kombësisë shqiptare. Pas futjes nën kontroll të territorit të Kosovës, në verë të vitit 1912, udhëheqësit kryengritës shqiptarë, për arsye të përçarjeve të brendshme, ndryshe prej platformës politike fillestare për autonomi territoriale, paraqitën një platformë të re politike me 14 kërkesa (që njihen si 14 pikat e Hasan Prishtinës) e që parashihte autonomi joterritoriale, sepse në të nuk kishte fjalë eksplicite as për ushtrinë e as për kufijtë e Shqipërisë. Në këto pika trajtoheshin kryesisht arsimiti, bujqësia, tregtia e transporti, por përfshihej edhe shpallja e amnistisë së përgjithshme për kryengritësit, dëmshpërblimi për shpëtë e shkatërruara dhe hedhja në gjyq e kabineteteve qeveritare të Turqve të Rinj.

.....

36 Boshkoski, Millan, Jordan Ilioski, Gjorgji Isajllovski, Vllado Vellkoski, Miroslav Boshkoviç dhe Simeon Naumovski. *Historia 1 arsimiti i mesëm profesional*. Shkup: Prosvetno Dello, 2006, faqe 103-104; Boshkoski, Millan, Nebi Dervishi, Silvana Sidorovska – Cupovska, Natasha Kotlar, Jordan Ilioski, Dimko Popovski. *Historia 2 arsimiti gjimnazor*. Shkup: Prosvetno Dello, 2008, faqe 139-144 dhe 148-149.

Në tekste të Sërbisë nuk prezentohet fare kryengritja shqiptare e vitit 1912; në disa tekste të Kosovës si synim i saj paraqitet shteti i pavarur shqiptar nga sundimi osman; në tekste të Shqipërisë, të Malit të Zi e të Maqedonisë dhe në disa tekste të Kosovës, synimi i kësaj kryengritjeje prezentohet siç edhe ishte: autonomi në kuadër të Perandorisë Osmane. Por, këto tekste nuk i paraqesin në mënyrë eksplicite ndryshimet e synimeve politike të kryengritësve shqiptarë: nga autonomia territoriale në autonomi joterritoriale. Motivet e përfundimit të kryengritjes përmenden vetëm në tekstet e Kosovës e të Shqipërisë, ku tekstet e Kosovës thonë se kryengritësit shqiptarë shpallën përfundimin e kryengritjes pasi “...filluan provokimet e armatosura të Malit të Zi në kufi”, ndërkaq ato të Shqipërisë si motiv përmendin “...keqësimin e situatës së jashtme nga përpjekjet e shteteve ballkanike për t’i shpallë luftë Perandorisë Osmane dhe për t’i copëtuar midis tyre viset shqiptare”. *Pra*, mosrealizimi i kërkesave politike të udhëheqësve shqiptarë të kohës, në tekstet e Kosovës e të Shqipërisë u faturohet vetëm shteteve përreth.

Në asnjërin prej teksteve të këtyre vendeve nuk zihet në gojë se shqiptarët në këtë kohë ishin të përcarë: nga njëra anë shumica e përfaqësuesve të qyteteve – bejlerë e agallarë – që kundërshtonin autonominë, e në tjetrën udhëheqësit e kryengritjes që synonin autonominë, e që po ashtu ishin të përcarë, pasi që një pjesë e tyre pëlqenin me mbetë fuqimisht të lidhur me Perandorinë Osmane. Përfaqësuesit e qyteteve – bejlerët e agallarët – përmenden si “...elementë proturq që ishin kundër autonomisë” vetëm në tekstet e Maqedonisë dhe në dy tekste të Kosovës: ‘Historia 11’ dhe ‘Historia 12’ për gjimnazin e përgjithshëm. Këto përcarje ishin arsyeja kryesore e ndryshimit të synimit politik nga autonomi territoriale në autonomi joterritoriale.

Tekstet e asnjërit vend nuk pasqyrojnë se përcarjet mes udhëheqësve kryengritës shqiptarë ishin të nxitura edhe prej përfaqësuesve të Sërbisë, të cilët i furnizonin me armë disa prej udhëheqësve kryengritës shqiptarë. Për më shumë, të gjitha rrymat politike të kohës prezentohen nën ombrellën e asaj që tekstet e quajnë Lëvizje Kombëtare Shqiptare, e cila paraqitet si strukturë homogjene e me kërkesa të qarta. Pasqyrimi i këtyre ndarjeve është boshtor, sepse ato patën ndikim vendimtar për ndryshimin e platformës politike prej autonomisë territoriale në autonomi joterritoriale. Mirëpo, kryengritësit shqiptarë nuk e realizojnë as autonominë joterritoriale sepse, në vend që t’i krijonin organet e pushtetit, shpërndahen fill pasi Perandoria Osmane ua pranon zyrtarisht të 14 pikat, duke përjashtuar inicimin e proceseve gjyqësore kundër qeverive të Turqve të Rinj.

Pas fillimit të largimit të regjimenteve osmane nga Kosova në fund të shtatorit 1912 dhe shpalljes së luftës kundër Perandorisë Osmane në fillim të tetorit 1912 nga Mali i Zi, e më pas edhe nga anëtarët e tjerë të Lidhjes Ballkanike

(Sërëbia, Bullgaria dhe Greëia), forcat sërëbe futen në territorin e Kosovës. Traktati i Lidhjes Ballkanike – protektuar nga Rusia – përshkruante ndarjen e territoreve pas largimit të Perandorisë Osmane, e cila i kontrollonte edhe hapësirat e populluara me shumicë shqiptare në Ballkan, përfshi Kosovën. Në mes të tetorit 1912, Mbreti i Sërbisë, Petar Karađorđević, në deklaratën e titulluar “Popullit Sërb”, mes tjerash, thoshte: “...Ushtria ime do të takohet në Sërbinë e Vjetër me sërëbë të krishterë e myslimanë, që na janë njëlloj të dashur, po edhe me shqiptarë të krishterë e myslimanë, me të cilët kombi ynë ka nda për 13 shekuj pa ndërprerje, gëzimin e hidhërimit. Kemi me ju sjellë liri, vëllazëri e barazi të gjithëve”. Shqiptarët vendosin mos me marrë pjesë në luftën mes aleatëve ballkanikë e osmanëve. Kështu, më 23 tetor 1912, në fushën ku është zhvilluar Beteja e Kosovës e vitit 1389, sërëbët festojnë, siç thonë tekstet e Sërbisë “...çlirimin e Kosovës, djepit të shtetësisë së Sërbisë, që e kishin pritur shumë gjenerata gjatë shekullit 19”. Në anën tjetër, futja e trupave sërëbe në Kosovë dhe hapësirat e tjera të banuara me shqiptarë, në tekste të Kosovës, të Shqipërisë, madje edhe të Malit të Zi e të Maqedonisë, paraqitet si pushtim.

Për krimet e kryera në Kosovë nga Sërëbia në tetor 1912 – mars 1913, tekstet e Sërbisë nuk e thonë asnjë fjalë. Natyrisht, këto krime përmenden në tekstet e Kosovës e të Shqipërisë. Tekstet e Kosovës japin vetëm kualifikime për këto krime si “...veprime terroriste e gjakatare kundër popullsisë shqiptare, e cila iu nënshtrua dhunës dhe terrorit të shovinizmit të shteteve ballkanike”, kurse tekstet e Shqipërisë përmendin vetëm “...rrënim të fshatrave e të qyteteve, humbje njerëzore, largim me dhunë të shqiptarëve, detyrim për konvertim fetar, kolonizim të tokave shqiptare me sllavë”. Çuditërisht, këto krime në njëfarë mënyre prezentohen edhe në tekstet e Maqedonisë, ku gjendja e vështirë dhe vendosja e regjimit ushtarako-policor ilustron me ndalimin e shkollave, të alfabetit dhe të flamurit, e madje në mënyrë të tërthortë edhe në tekstet e Malit të Zi, të cilat vënë në pah “...grabitje territoriale, plaçkitje dhe mosrespektim të të drejtave kombëtare të popujve të veçantë”.

As tekstet e Kosovës e të Shqipërisë, e as ato të Sërbisë, të Malit të Zi e të Maqedonisë, nuk i referohen, ta zëmë, raportit të socialdemokratit austriak Leo Freundlich “Golgota e Shqipërisë”, që thotë se numri i shqiptarëve të vrarë në fund të vitit 1912 e në fillim të vitit 1913 shkon në 25 mijë. Këto tekste nuk u referohen as shkrimeve të korrespondentit të luftës për ditoret ruse, Leon Trocki, e as të dhënave nga “Raporti i Komisionit Ndërkombëtar për Hetimin e Shkaqeve dhe Sjelljeve në Luftën Ballkanike”, hartuar nga Donacioni Carnegie për Paqe Ndërkombëtare. Po ashtu, asnjëri nga tekstet e këtyre vendeve nuk u referohet as artikujve të socialdemokratëve sërëbë: Dimitrije Tucović, Kosta Novaković, Dušan Popović, Dragiša Lapčević e Triša Kaclerović, të botuara në gazetën socialiste të Beogradit “Radničke Novine”.

Çuditërisht, rezistenca e shqiptarëve kundër këtyre krimeve të forcave sërbe përmendet vetëm në tekstet e Shqipërisë dhe të Maqedonisë. Tekstet e Shqipërisë e përmendin edhe se kjo rezistencë ishte shtypur nga ushtria sërbe.

Në kohën kur po ndodhnin këto ngjarje të përgjakshme, më 28 nëntor 1912, Shqipëria e shpalli pavarësinë e saj në Vlorë, qytet bregdetar në jug të Shqipërisë, që ishte i vetmi qytet shqiptar ende i papushtuar nga trupat e Aleancës Ballkanike. Pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, Konferenca e Ambasadorëve në Londër, e thirrur për ta diskutuar kryesisht çështjen shqiptare, në dhjetor 1912 vendosi për autonominë e Shqipërisë brenda Perandorisë Osmane, kurse në korrik 1913 vendosi që Shqipëria të jetë principatë sovraane, e trashëgueshme dhe neutrale nën garancitë e Fuqive të Mëdha.

Tekstet e Kosovës, të Shqipërisë dhe të Maqedonisë e konsiderojnë shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë si kurorëzim të luftës disashekullore të shqiptarëve kundër pushtimit pesëshekullor osman, kurse Konferencën e Ambasadorëve në Londër më 1912-13 fajtojnë për copëtimin e tokave shqiptare dhe lënien e Kosovës jashtë Shqipërisë. Mirëpo, këto tekste duhet ta kenë parasysh se shtetet ballkanike, të përkrahura nga Rusia, propozuan që territori i Shqipërisë të ishte përgjysmë më i vogël sesa është sot, kurse Shqipëria, e mbështetur nga Austro-Hungaria, propozonte territor edhe një herë më të madh sesa është sot. Vendimi i Fuqive të Mëdha, me propozim të Anglisë, binte në mes të mëtimeve ruse e austriake. Pra, Fuqitë e Mëdha realisht ua njohën shqiptarëve një territor më të madh sesa ai që ata arritën ta vinin nën administrimin e vet.

Në anën tjetër, tekstet e Sërbisë dhe të Malit të Zi, shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë dhe Konferencën e Ambasadorëve në Londër i paraqesin si prishje të planeve të aleatëve ballkanikë, ngaqë Sërbia u detyrua ta largonte ushtrinë nga Shqipëria dhe të hiqte dorë nga dalja në det. Tekstet e Malit të Zi shtojnë edhe se me këtë konferencë Sërbisë iu njohën territoret që mori në Kosovë. Megjithatë, këto tekste, e sidomos ato të Sërbisë, duhet ta kenë parasysh se Konferenca e Ambasadorëve në Londër më 1912-13, realisht ia ka njohur Sërbisë territoret që mori në Kosovë përmes krimeve që u përmendën më sipër.³⁷

.....

37 Malcolm, Noel. *Kosovo - A Short History*. London: Pan Macmillan, 2002, faqe 245-257; Schmitt, Oliver. *Kosova: histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*. Prishtinë: Koha, 2012, faqe 134-142; Schmitt, Oliver. *Shqiptarët - një histori midis Lindjes dhe Perëndimit*. Tiranë: K&B, 2012, faqe 168-169; Bartl, Peter. *Shqipëria - nga mesjeta deri sot*. Prizren: Drita, 1999, faqe 123-131; Schwartz, Stephen. *Kosovo: Background to a War*. London: Anthem Press, 2000, faqe 41-42; Gawrych, George. *Gjysmëhëna dhe shqiptarja - sundimi otoman, islamizimi dhe shqiptarët 1874-1913*. Tiranë: Bota Shqiptare, 2007, faqe 291-301; Castelan, Georges. *Histori e Ballkanit*. Tiranë: Çabej, 1996, faqe 390-396; Freundlich, Leo. *Golgota e Shqipërisë*. Prishtinë: Rrokullia, 2010. *Report of the International Commission to Inquire into the Causes and Conflict of the Balkan Wars*. Washington: Carnegie Endowment for International Peace, 1914.

5.2. Kosova mes dy luftërave botërore 1918-1939

Ky nënkapitull heton konkretisht se si prezantohet nëpër tekste Kosova nën sundimin austriak/bullgar 1915-1918; ripushtimi/riçlirimi i Kosovës më 1918; kryengritjet e armatosura shqiptare 1918-1924; shpronësimi e shpërngulja e shqiptarëve dhe kolonizimi me sërbë.

Në raport me temat e mësipërme, kjo është bërthama e shtjellimeve që bëjnë **tekstet e Kosovës:**

- Në fund të vitit 1915, pas sulmeve të forcave austro-hungareze, forcat sërbo-malazeze u detyruan të tërhiqeshin nga Kosova. Ato u tërhoqën nëpërmjet Kosovës, Malit të Zi dhe Shqipërisë për në Greqi. Gjatë tërheqjes nëpër trojet shqiptare, pos plaçkitjeve, ato kryen edhe krime të rënda mbi popullsinë shqiptare. Në vend të tyre u vendosën pushtuesit austro-hungarezë dhe bullgarë, të cilët e ndanë Kosovën në dy zona pushtimi. Gjendja në zonën nën pushtuesit austro-hungarez ishte më e favorshme sesa në zonën nën sundimin bullgar, ngase austro-hungarezët lejonin vetadministrim lokal dhe shkollim në shqip. Shqiptarët organizuan rezistencë të armatosur kundër pushtuesve austro-hungarezë dhe bullgarë.
- Në fund të vitit 1918 Kosova dhe viset e tjera shqiptare u ripushtuan nga Sërbia, e cila me anë të regjimit ushtarak e policor ushtroi terror e gjenocid shtetëror mbi shqiptarët, duke djegë dhe shkatërruar fshatra të tëra. Mijëra shqiptarë u larguan për në Shqipëri dhe në Turqi. Shumë shqiptarëve iu morën pronat dhe iu dhanë kolonëve sërbë e malazezë. Shqiptarëve iu mohua përdorimi i gjuhës shqipe dhe i flamurit shqiptar.
- Shqiptarët organizuan luftë të armatosur kundër pushtuesit sërb dhe krijuan zona të lira në të cilat për një kohë nuk arriti të depërtonte ushtria sërbe. Me synim çlirim dhe bashkimin kombëtar, shqiptarët themeluan “Komitetin Mbrojtja Kombëtare”, me seli në Shkodër, e me degë në qendrat kryesore të Kosovës. “Komiteti Mbrojtja Kombëtare” udhëhoqi lëvizjen kombëtare gjatë viteve 1918-1924, bashkëpunoi me “Xhemijetin”, e vetmja parti politike ku aderorin shqiptarët, dhe me çetat e armatosura në Kosovë. Në vitin 1924 pushteti sërb vrau udhëheqësit e çetave kryengritëse, duke nisë nga Azem Bejta, dhe burgosi anëtarët e “Xhemijetit”, ku prijësin e kësaj partie, Ferhat Draga, e dënnoi me 100 vjet burg.
- Në periudhën mes dy luftërave botërore, Sërbia, përmes të ashtuquajturës “reformë agrare”, duke përdorë mungesën e tapive të tokave, sekuestroi rreth 400 mijë hektarë tokë të shqiptarëve dhe ua dha

kolonëve sllavë e manastireve ortodokse. Në këtë periudhë, në tokat shqiptare u vendosën rreth 15 mijë familje sllave me 75 mijë banorë, e në anën tjetër, përmes shpronësimit, rreth 250 mijë shqiptarë u detyruan të shpërnguleshin nga trojet e tyre për në Turqi. Në verë të vitit 1938 u nënshkrua Konventa Jugosllave-Turke për shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi, e cila parashihte që të shpërnguleshin në Turqi rreth 400 mijë shqiptarë, por për shkak të ndryshimit të situatës politike në Europë, kjo konventë nuk u zbatua.³⁸

Bërthama e shtjellimeve që bëjnë **tekstet e Shqipërisë** është kjo:

- Nuk prezentohet gjë për tërheqjen e forcave sërbe në tetor të vitit 1915 në drejtim të Greqisë nëpër malet e Shqipërisë. Në janar 1916 Kosova u pushtua nga trupat austro-hungareze dhe bullgare. Gjendja në zonën bullgare ishte shumë e rëndë: keqtrajtme, burgosje e internime; në zonën austriake gjendja ishte ndryshe: lejoheshin gjuha, shkolla, flamuri, e me radhë.
- Në tetor 1918 forcat sërbe u rivendosën në Kosovë me ndihmën e forcave franceze. Shqiptarët protestuan, por pa sukses. Shqiptarëve u mohoheshin të drejtat kombëtare. Filloi çarmatimi i popullsisë shqiptare. Nuk u lejua hapja e asnjë shkolle në gjuhën shqipe, as botimi i librave e gazetave.
- Në një situatë të tillë shqiptarët reagues përmes Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, që synonte organizimin e rezistencës së armatosur të shqiptarëve nën sundimin jugosllav dhe bashkimin e tyre me shtetin amë – Shqipërinë. Kjo rezistencë u organizua përmes kaçakëve nën drejtimin e Azem Bejtës, por u shtyp shpejt nga forcat sërbe. Një rol të rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve luajti edhe “Xhemijeti”, parti politike që drejtohej nga Nexhip Draga dhe që kishte deputetë në parlamentin jugosllav.
- Politika sërbe synonte ndryshimin e strukturës etnike në Kosovë dhe prandaj e nisi “reformën agrare” për t’i shpronësuar dhe për t’i larguar shqiptarët nga Kosova dhe për ta kolonizuar Kosovën me bujq sllavë. Shqiptarëve që merrnin pjesë në kryengritje u konfiskuan tokat dhe u dhanë veteranëve sërbe të luftës. Në vitin 1938 u nënshkrua Marrëveshja Turke-Jugosllave për shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi, e cila

38 Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj. *Historia 5*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013, faqe 80-81; Rexhepi, Fehmi. *Historia 9*. Libri Shkollor, 2013, faqe 62-71, 76-78; Bajraktari, Jusuf, Fehmi Rexhepi dhe Frashër Demaj. *Historia 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2011, faqe 101, 127-130; Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj. *Historia 11*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013, faqe 131-137; Bajraktari, Jusuf dhe Arbër Salihu. *Historia 12*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013, faqe 184-86.

parashihte që të shpërnguleshin për në Turqi rreth 250 mijë myslimanë, por qeveria jugosllave me turq nënkuptonte edhe shqiptarë myslimanë. Për më shumë, meqë popullsia e qyteteve u përjashtua nga shpërngulja, del qartë se kjo masë parashihej për shqiptarët, ngaqë në qytete jetonin kryesisht personat me kombësi turke. Sidoqoftë, për shkak të ndryshimit të situatës politike në Ballkan, kjo konventë nuk u zbatua.³⁹

Bërthama në **tekstet e Sërbisë** është kjo:

- Në vjeshtë të vitit 1915 në Sërbi hyjnë trupat bullgare e austriake. Shumë ushtarë e civilë sërëbë, bashkë me mbretin Petar Karađorđević u tërhoqën vargmaleve të Shqipërisë për të dalë në Detin Adriatik, ku i pritnin trupat aleate franceze e britanike. Kjo tërheqje ishte epopeja më e vështirë e historisë sërëbe, që njihet si “golgota shqiptare”, ngaqë gjatë kësaj tërheqjeje, për shkak të acarit të dimrit dhe vështirësive të tjera, pësuan dhjeta mija ushtarë e civilë sërëbë, të cilët edhe u sulmuan nga bandat lokale shqiptare. Këto tekste merren veç me okupimin e Sërbisë nga trupat austriake e bullgare dhe në hartat e botuara në kaptinën mbi këtë periudhë, Kosova figuron pjesë e pandashme e Sërbisë.
- Në nëntor 1918 ushtria sërëbe e çliroi gjithë territorin e Sërbisë (në hartë, si territor i Sërbisë figuron edhe Kosova). Nuk përmenden vrasjet e shqiptarëve nga forcat sërëbe, të kryera kryesisht në fund të vitit 1918 e në fillim të vitit 1919.
- Nuk paraqiten fare kryengritjet e armatosura shqiptare kundër forcave sërëbe 1918-1924.
- Sa i takon shpronësimit e shpërnguljes së shqiptarëve dhe kolonizimit me sërëbë, këto tekste bëjnë fjalë veç për “reformën agrare” në mbarë Mbretërinë SKS dhe e vetmja gjë më e veçantë që thonë është se prej saj “përfituan tokë rreth 500 mijë familje fshatare”.⁴⁰

Në **tekstet e Malit të Zi** bërthama e zhvillimeve është kjo:

- Forcat sërëbe u detyruan të tërhiqeshin në drejtim të Greqisë përmes Kosovës e Metohisë, Mali të Zi dhe Shqipërisë. Bashkë me ushtrinë lëvizte edhe popullsi e shumë, e cila largohej nga vendi për t’iu shmangë

39 Dërguti, Menduh, Sonila Boçi dhe Ledia Dushku. *Historia 9*. Tiranë: Botime Shkollore Alban, 2013, faqe 78-79, 95-96; Dërguti, Menduh, Ledia Dushku, Ferit Duka dhe Sonila Boçi. *Historia 12*. Tiranë: Botime Shkollore Alban, 2013, faqe 90-91.

40 Đurić, Đorđe dhe Momčilo Pavlović. *Istorija 8*. Beograd: Zavod za udžbenike, 2010, faqe 74, 103; Đurić, Đorđe dhe Momčilo Pavlović. *Istorija 3*. Beograd: Zavod za udžbenike, 2010, faqe 95, 96, 124, 155.

pushtimit dhe terrorit. Si pasojë e humbjeve, e kapjes rob, e dezertimeve dhe e mundimeve gjatë kalimit të Bjeshkëve të Nemuna të mbuluara nga akulli, numri i ushtarëve të ushtrisë zvogëlohej nga dita në ditë. Gjatë rrugës, mbetën kufoma të shumta të ushtarëve dhe civilëve të mbuluar nga bora, të cilët vdiqën nga uria dhe të ftohtit. Nga brigjet e Shqipërisë, ushtria serbe u transportua në Korfuz. Kjo ishte “golgota shqiptare” përmes të cilës kaloi ushtria dhe populli serb. Nuk prezantohet asgjë për Kosovën nën sundimin austriak/bullgar 1915-1918.

- Më 1 nëntor 1918 ushtria serbe e çliroi gjithë territorin e Sërbisë (në hartë, si territor i Sërbisë figuron edhe Kosova dhe Maqedonia). Shumica e pakicave nacionale në Jugosllavi nuk gëzonin të drejta. Kjo gjë vlen veçmas për shqiptarët, të cilët jo vetëm që nuk kishin kushte për zhvillim nacional (as shkolla e as gazeta në gjuhën amtare), por i nënshtroheshin edhe represioneve të pushtetit, i cili ushtronte mbi ta trysni që të shpërnguleshin nga vatrat e veta.
- Nuk paraqiten fare kryengritjet e armatosura shqiptare kundër forcave serbe 1918-1924.
- Shumë fshatarë kishin tokën e vet, por e punonin tokën e huaj. Nën ndikimin e ideve revolucionare, në vitet 1918-1919 fshatarët kërkonin që të kryhej reforma agrare. Fshatarët u shpallën pronarë të lirë, kurse pronarëve të mëdhenj të tokës iu premtua dëmshpërblimi. Në Kosovë dhe në Metohi, në Vojvodinë dhe në Maqedoni, një pjesë e këtyre pronave u përdor për kolonizim me vendosjen e ushtarëve dhe të vullnetarëve të Luftës së Parë Botërore. Me faljen e tokës së shtetit kolonëve, pushteti ndihmonte një numër fshatarësh, por edhe e ndryshonte në këtë mënyrë përbërjen nacionale të popullsisë, në krahinat ku shumicën e përbënin shqiptarët, gjermanët dhe hungarezët.⁴¹

Përmbajtja e **teksteve të Maqedonisë** ka këtë thelb:

- Sllovenët, kroatët, serbët dhe myslimanët nga vendet nën sundimin austriak ishin të detyruar të merrnin pjesë në luftë dhe të luftonin për interesat e huaja, por kundër dëshirës së tyre. Nga mesi i muajit tetor 1915, ushtritë e bashkuara të Austro-Hungarisë, Gjermanisë dhe Bullgarisë hynë thellë në Serbi. Ushtria e Sërbisë, e sulmuar nga të gjitha anët, u detyrua të tërhiqej nëpër Kosovë, Mal të Zi dhe Shqipëri për në Korfuz. Gjendja e popullsisë civile në vendet e okupuara në Serbi dhe

.....

41 Burzanoviq, Sllavko dhe Jasmina Gjorgjeviq, *Historia 9*. Podgoricë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 2008, faqe 24, 25, 58 dhe 63; Rastoder, Sherbo, Radoje Pajoviq dhe Zvezdan Foliq, *Historia 4*. Podgoricë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 2009, faqe 52 dhe 115.

Mal të Zi nga ushtritë gjermane, austro-hungareze dhe bullgare, ishte shumë e rëndë. Kjo shkaktoi rezistencë popullore kundër okupatorëve.

- Në shtator të vitit 1918 ushtritë e Antantës (italiane, franceze, sërbe, angleze dhe greke) e çliruan Sërbinë. Ushtria sërbe e ktheu Kosovën dhe mori vise të tjera, në të cilat jetonin shqiptarët. Sllavët e jugut krijuan Mbretërinë e Sërbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve, por nuk morën parasysh se ekzistonin edhe popuj të tjerë, si për shembull: populli maqedonas, malazet, shqiptar, etj.
- Në Kosovë kishte pakënaqësi nga vendosja e pushtetit sërëb. Shqiptarët themeluan Komitetin “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, që synonte çlirimin e Kosovës dhe mbrojtjen e pavarësisë së Shqipërisë. Kjo rezistencë u organizua në formë guerile ose kaçake. Një grup i shqiptarëve në Jugosllavi vendosën që të formonin një parti legale “Xhemijet”, që nuk ishte religjioze, por politike. Deputetët e “Xhemijetit” në Parlamentin e Jugosllavisë demaskuan politikën sërëbomadhe ndaj shqiptarëve dhe mbrojtën të drejtat e shqiptarëve, duke iu kundërvënë reformës agrare.
- Mbretëria e Sërbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve është përpjekur ta ndryshojë strukturën etnike në territoret ku kanë jetuar shqiptarët. Prandaj, në Kosovë ka vendosë rreth 15 mijë familje nga territoret ku kanë jetuar sërëbët. Rreth 400 mijë hektarë tokë e punueshme u është marrë shqiptarëve e u është dhënë sërëbëve. Si pasojë e kësaj politike agrare-kolonizuese, u ashpërsuan marrëdhëniet ndëretnike mes shqiptarëve dhe sërëbëve. Pushteti organizoi banda çetnike që përdorën kërcënime, shtypje e frikësime ndaj shqiptarëve. Një numër i madh i shqiptarëve të Kosovës mbetën pa tokë, prandaj rreth 50 mijë shqiptarë u detyruan të punonin në tokat e familjeve kolonizatore. Pas luftërave ballkanike, shqiptarët ishin 90%, kurse në vitin 1940 numri i tyre ra në 70%. Rreth 200 mijë shqiptarë u shpërngulën në Turqi dhe në Shqipëri. Jugosllavia dhe Turqia në vitin 1938 kishin nënshkruar marrëveshje për largimin e 400 mijë shqiptarëve në Turqi.⁴²

Përmbledhje

Lidhur me tërheqjen në fund të vitit 1915 të forcave sërëbo-malazeze nëpërmjet Kosovës, Malit të Zi dhe Shqipërisë për në Greqi, për shkak të sulmeve nga forcat austro-hungareze, gjermane e bullgare, tekstet e Kosovës thonë vetëm se forcat sërëbe “...gjatë tërheqjes nëpër trojet shqiptare, pos plaçkitjeve, kryen

.....

⁴² Vellkoski, Vllado, Halit Sejdiu, Arijan Alademi, Dimka Risteska dhe Gjorgji Pavlovski. *Historia 8*. Shkup: Prosvetno Dello, 2005, faqe 12-14, 21, 33-35, 45-46; Veljanovski, Novica, Gordana Pletvarska, Sonja Cvetkovska dhe Shyqeri Xhaferi. *Historia 3 – arsimit gjimnazor*. Shkup: Prosvetno Dello, 2009, faqe 74-76.

edhe krime të rënda në popullsinë shqiptare”, ndërkaq tekstet e Shqipërisë nuk merren fare këtë tërheqje. Tekstet e Kosovës e të Shqipërisë nuk i përmendin askund qëndrimet armiqësore të shqiptarëve dhe vrasjet e ushtarëve dhe të civilëve serbë që në fund të vitit 1915 po largoheshin nga Kosova nëpërmjet vargmaleve të Shqipërisë. Tekstet e Maqedonisë e përmendin përciptazi këtë tërheqje dhe gjendjen e popullsisë civile në vendet e okupuara në Sërbi dhe Mal të Zi nga ushtritë gjermane, austro-hungareze dhe bullgare e përshkruajnë si shumë të rëndë. Në anën tjetër, tekstet e Sërbisë dhe të Malit të Zi përqendrohen më shumë te kjo tërheqje, duke i vënë në pah vështirësitë dhe humbjet e shumta të ushtarëve e të civilëve serbë që po kalonin Bjeshkëve të Nemuna, duke e quajtur “golgota shqiptare”. Për këto tekste, shkaktarë të pësimit të shumë ushtarëve e civilëve serbë ishin uria, të ftohtit dhe vështirësi të tjera. Për më shumë, tekstet e Sërbisë, që këtë tërheqje e paraqesin si epopenë më të vështirë të historisë serbe, thonë se ushtarët e civilët serbë e pësuan gjatë kësaj tërheqjeje edhe nga sulmet e bandave lokale shqiptare.

Gjatë Luftës së Parë Botërore, Kosova, sikurse edhe Sërbia, ishte ndarë pothuajse përgjysmë: në zonën austriake, ku lejoheshin shkollat në shqip dhe përdorimi i shqipes në administratë, si dhe në zonën bullgare, ku regjimi diktonte kushte të vështira, nën të cilat njerëzit përveçqë bënë punë të detyruar, vuanin edhe për bukën e gojës. Kjo gjendje prezentohet në tekstet e Kosovës e të Shqipërisë, por jo edhe në ato të Sërbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë. Njësoj, edhe rezistenca e armatosur e kryengritësve shqiptarë të Kosovës, e prirë në zonën bullgare nga Idriz Seferi, ndërsa në atë austriaken nga Azem Bejta, paraqitet në tekstet e Kosovës e të Shqipërisë, por jo edhe në ato të Sërbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë. Ndërkaq, bashkëpunimi i këtyre kryengritësve shqiptarë me serbët lokalë kundër forcave austriake përkatësisht bullgare nuk përmendet askund në asnjërin prej teksteve të këtyre vendeve.

Në mbarim të Luftës së Parë Botërore, pas largimit të trupave austriake e bullgare, në Kosovë futen trupat serbe, të cilat sipas teksteve të Kosovës “e ripushtojnë Kosovën dhe viset e tjera shqiptare” dhe përmes regjimit ushtarak e policor ushtrojnë “terror e gjenocid shtetëror mbi shqiptarët, duke djegur e shkatërruar fshatra të tëra, e duke larguar mijëra shqiptarë për në Shqipëri dhe në Turqi”, por këto tekste nuk ofrojnë të dhëna që do ta mbështesnin kualifikimin *gjenocid*. Tekstet e Shqipërisë, futjen e trupave serbe në Kosovë e paraqesin si “rivendosje të forcave serbe në Kosovë”, duke shtuar se regjimi serb ua mohonte shqiptarëve të drejtat kombëtare, nuk ua lejonte shkollat shqip e as botimin e librave e të gazetave.

Në anën tjetër, tekstet e Sërbisë e paraqesin futjen e trupave serbe në territorin e Kosovës si çlirim dhe nuk përmendin asgjë për trajtimin e shqiptarëve nga

trupat sërëbe. Tekstet e Malit të Zi, kur flasin për çlirimin e Sërëbisë në fund të vitit 1918, ndonëse nuk e përmendin drejtpërdrejt Kosovën, në hartë si territor të Sërëbisë e japin edhe Kosovën; megjithatë, ndryshe nga tekstet e Sërëbisë, thonë se shqiptarët nuk kishin të drejta, as shkolla e as gazeta në gjuhën amtare dhe i nënshtroheshin edhe represioneve të pushtetit, i cili ushtronte trysni që t'i shpërngulte nga vatrat e veta. Tekstet e Maqedonisë thonë se ushtria sërëbe e ktheu Kosovën dhe mori vise të tjera në të cilat jetonin shqiptarët dhe shtojnë se kur sllavët e jugut krijuan Mbretërinë Sërëbe-Kroate-Sllovene, nuk e morën parasysh se ekzistonin edhe popuj të tjerë, ndër të cilët përmendin edhe popullin shqiptar.

Kryengritjet e armatosura të shqiptarëve nën sundimin jugosllav kundër forcave sërëbe në periudhën 1918-1924 nuk paraqiten fare në tekstet mësimore të Sërëbisë dhe të Malit të Zi. Ndërkaq, në tekstet e Kosovës, të Shqipërisë dhe të Maqedonisë këto kryengritje thuhet se synonin çlirimin dhe bashkimin kombëtar dhe përmenden telegrafikisht kaçakët, si bartës të kryengritjes së armatosur, dhe Xhemijeti, si e vetmja parti politike ku aderonin shqiptarët, e që kishte një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve përmes deputetëve që kishte në parlamentin jugosllav.

Në asnjërin prej teksteve të këtyre vendeve nuk shënohet se veprimtaria e lëvizjes kaçake vështirësohet pas shkatërrimit të bazës së kaçakëve në fshatin Junik në **zonën neutrale** mes kufirit të Shqipërisë dhe të Mbretërisë Sërëbo-Kroate-Sllovene, e as se në fund të vitit 1923, Kryeministri i Shqipërisë, Ahmet Zogu, e dërgon në këtë zonë ushtrinë shqiptare për t'i luftuar kaçakët. Nuk përmendet as se në këtë zonë vendosen trupa të përbashkëta shqiptaro-jugosllave për ta pamundësuar kthimin e kaçakëve në të. Po ashtu, nuk thuhet as se në Shqipëri dënohet zyrtarisht me vdekje në mungesë kryekaçaku Azem Bejta, e më vonë edhe Hasan Prishtina, që ishte njëri prej udhëheqësve të Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës.

Këto tekste nuk e zënë në gojë marrëveshjen që Azem Bejta bën me autoritetet lokale sërëbe për të jetuar i patrazuar, me kusht që të lëvizë vetëm brenda tri fshatrave. Në këto tekste veprimtaria e lëvizjes kaçake pasqyrohet veç si luftë për çlirim e bashkim kombëtar, prandaj nuk paraqiten as takimet e kryekaçakut Azem Bejta me zyrtarë të lartë sërëbë, ku kërkohej që Kosova të ketë të drejtë për **vetëqeverisje**. Në asnjërin prej teksteve nuk përmendet se një numër i madh shqiptarësh bashkëpunonin me autoritetet dhe punonin në administratën lokale, dhe se prandaj disa prej tyre ishin cak i sulmeve të kaçakëve, bash sikur edhe kolonët sllavë. Po ashtu, nuk përmendet as se formimi i çetave nga sërëbët lokalë për të kryer operacione antikaçake, nxiti sulme të kaçakëve ndaj disa fshatrave sërëbe, ndonëse rregullat e lëvizjes kaçake, mes të tjerash, parashihnin

që të mos dëmtoheshin sërëbët lokalë. Këto rregulla nuk jepen në asnjërin prej teksteve të këtyre vendeve.

Në këto tekste nuk specifikohet se shqiptarët, përveç rrugës kryengritëse, ndjekin edhe atë parlamentare, të përfaqësuar nga Shoqata e të Drejtës për Mbrojtjen e Islamit (Islam Muhafaza-yi Hukuk Cemiyeti), që shkurtimisht njihet si “Xhemijet”. Në asnjë prej teksteve nuk jepet emri i plotë i “Xhemijetit”. Ky formacion politik, që konsiderohej si “parti e bejlerëve”, kërkonte autonomi religjioze, e nganjëherë edhe protestonte për kushtet e jetës në Kosovë, të dhëna këto që nuk figurojnë në këto tekste. Në asnjërin prej teksteve nuk përmendet se ky formacion politik bashkëpunonte me dy partitë kryesore politike sërëbe në Jugosllavi – demokratët dhe radikalët – e nganjëherë edhe e ndante të njëjtën listë elektorale me to.

Sa i takon reformës agrare dhe shpërnguljeve, tekstet e të gjitha vendeve, me përjashtim të atyre të Sërbisë, thonë se në periudhën mes dy luftërave botërore, Mbretëria Sërbo-Kroato-Slllovene synonte ta ndryshonte përbërjen etnike të popullatës në Kosovë dhe për këtë e përdorte të ashtuquajturën reformë agrare për shpërbërjen e pronave të vjetra osmane, që duhet t’u ndaheshin fshatarëve vendas. Këto toka, përfshi tokat e kaçakëve, kryesisht u jepeshin kolonëve nga Sërbia, si dhe ushtarëve e vullnetarëve sërëbë. Mirëpo, në asnjërin prej teksteve nuk përmendet se gjatë ndarjes së këtyre tokave nuk qenë përjashtuar as fshatarët vendas, përfshi shqiptarët. Në këto tekste nuk shkruhet as se, meqë pjesa më e madhe e tokave iu dha kolonëve sërëbë, sërëbët vendas qenë shprehë të gatshëm për një front të përbashkët me shqiptarët kundër tyre.

Tekstet e Sërbisë bëjnë fjalë për reformën agrare në mbarë Mbretërinë SKS dhe e vetmja gjë më e veçantë që thonë është se prej saj “...përfituan tokë rreth 500 mijë familje fshatare”. Tekstet e Shqipërisë flasin veç për “...shpronësimin e shqiptarëve dhe kolonizimin e tokave shqiptare me elementë sllavë”, por nuk japin shifra për këtë. Tekstet e Kosovës, në anën tjetër, pohojnë se midis dy luftërave botërore në Kosovë janë “...sekuestruar 400 mijë hektarë tokë dhe janë vendosur rreth 15 mijë familje kolonësh sllavë me rreth 75 mijë anëtarë”. Noel Malcolm-i, i cili citon autorë sërëbë, shqiptarë e ndërkombëtarë, thotë se sekuestrohen 200 mijë hektarë – gjysma e të cilëve u jepet kolonëve – ndërsa në Kosovë vendosen mbi 13 mijë familje me rreth 70 mijë anëtarë. Sa u takon shpërnguljeve të shqiptarëve në periudhën mes dy luftërave botërore, tekstet e Sërbisë nuk thonë kurrëgjë. Tekstet e Shqipërisë e trajtojnë këtë çështje, pa dhënë ndonjë shifër, kurse ato të Kosovës thonë se “...u detyruan të shpërnguleshin nga trojet etnike rreth 250 mijë shqiptarë”, por nuk japin dëshmi që t’i mbështesin këto të dhëna. Në anën tjetër, Noel Malcolm-i thotë se numri i

shqiptarëve dhe i myslimanëve të tjerë nga Kosova të shpërngulur mes dy luftërave botërore supozohet të ketë qenë mes 90-150 mijë.

Vend të veçantë në tekstet e Kosovës, të Shqipërisë dhe të Maqedonisë, zë marrëveshja e arritur në korrik në vitin 1938 mes Jugosllavisë dhe Turqisë për shpërnguljen e rreth 40 mijë familjeve për në Turqi gjatë periudhës 1939-1944, por që shpërthimi i Luftës së Dytë Botërore ia pamundëson realizimin. Marrëveshja zyrtarisht flet për “riatdheshim” të popullatës “myslimane turke”, por ishte e qartë se nga zonat që specifikoheshin në të, pjesa më e madhe e të shpërngulurve do të ishin shqiptarë. Në tekstet e Kosovës, numri i njerëzve që do të shpërnguleheshin për Turqi shënohet 400 mijë, në ato të Shqipërisë 250 mijë, kurse të Maqedonisë 400 mijë. Autorë ndërkombëtarë japin shifrën 200 mijë, përkatësisht 400 mijë, dhe shtojnë se pjesa më e madhe e tyre duhej të ishin shqiptarë. Mirëpo, asnjëri prej teksteve nuk përmend se marrëveshja mes Jugosllavisë dhe Turqisë nuk ishte kundërshtuar vetëm nga viktimat dhe bashkëkombësit e tyre, por kishte nxitë edhe 65 studentë nga Kosova, prej të cilëve 56 sërbë e malazezë, 1 turk dhe 8 shqiptarë, që të qarkullonin nëpër tërë Kosovën, por edhe nëpër ambasadat e huaja në Beograd, afishe ilegale që e dënonin këtë plan.⁴³

.....
 43 Malcolm, Noel. *Kosovo - A Short History*. London: Pan Macmillan, 2002, faqe 258-288; Schmitt, Oliver. *Kosova: histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*. Prishtinë: Koha, 2012, faqe 143-160; Schmitt, Oliver. *Shqiptarët - një histori midis Lindjes dhe Perëndimit*. Tiranë: K&B, 2012, faqe 168-179; Bartl, Peter. *Shqipëria - nga mesjeta deri sot*. Prizren: Drita, 1999, faqe 170-207. Judah, Tim. *Kosova - Luftë dhe Hakmarrje*. Prishtinë: Koha, 2002, faqe 41-42; Fischer, Bernd. *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*. Tiranë: Çabej, 2000, faqe 29-51; Schwartz, Stephen. *Kosovo: Background to a War*. London: Anthem Press, 2000, faqe 75.

5.3. Kosova në Jugosllavi 1945-1990

Ky nënkapitull heton konkretisht se si prezentohen nëpër tekste: Kosova nën sundimin italian/gjerman/bullgar 1941-1944; ri-pushtimi/ri-çlirimi i Kosovës më 1945; gjendja e shqiptarëve në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore; demonstratat e vitit 1968, kushtetuta e vitit 1974 dhe demonstratat e vitit 1981.

Në raport me temat e mësipërme, kjo është bërthama e shtjellimeve që bëjnë **tekstet e Kosovës:**

- Kosova në kohën e Luftës së Dytë Botërore u nda në tri zona pushtimi: italiane, gjermane dhe bullgare. Pushtuesit italianë hasën në rezistencë të fuqishme nga shqiptarët, e për ta zbutë pakënaqësinë e tyre, shpallën bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Kjo pati rëndësi të madhe, sepse në Kosovë në administratë u vendosën nëpunës shqiptarë, u lejuan simbolet kombëtare, shkollat, gazetat, librat, radiot e me radhë. Të gjitha këto u bënë për të fituar simpatinë e shqiptarëve dhe për të pasur përkrahjen e tyre. Shqiptarët e Kosovës ishin kundër fashizmit në parim, por më shumë urrenin pushtuesin jugosllav dhe për këtë arsye i pritën këta si çlirimtarë e shpëtimtarë. Shqiptarët, ndonëse kishin vuajtur shumë në Jugosllavinë mbretërore, u treguan të kujdesshëm ndaj minoritetit sërb e malazet. Shqiptarët organizuan demonstrata antifashiste në qytete të ndryshme, e më pas edhe aksione të armatosura. Në bazë të udhëzimeve të PKJ-së për Kosovë, në verë të vitit 1943 u themelua Shtabi Kryesor i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare të Kosovës me komandant Fadil Hoxhën, që kishte për detyrë t'i koordinonte aksionet e partizanëve në Kosovë. Një grup intelektualësh nacionalistë, për ta ruajtur bashkimin kombëtar të shpallur në kohën e italianëve, bashkëpunuan edhe me gjermanët. Në këto rrethana, më 16-20 shtator 1943 në Prizren u mbajt Lidhja e Dytë e Prizrenit, në krye me Rexhep Mitrovicën, e cila angazhohej për një Shqipëri Etnike. Këshilli Nacional-Çlirimtar për Kosovë e Rrafsh të Dukagjinit më 31 dhjetor 1943 dhe 1 e 2 janar 1944 mbajti në Bujan konferencën e parë dhe nxori një rezolutë, ku thuhej se Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit e banuar me shumicë nga populli shqiptar dëshiron të bashkohet me Shqipërinë. PKJ-ja nuk i njohu vendimet e Bujanit, sepse binin ndesh me planet e saj për pushtimin e Kosovës. As PKS-ja nuk i mbështeti plotësisht vendimet e Bujanit.
- Pas dëbimit të pushtuesve nazifashistë, në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare depërtuan njësitet partizane sërbe, malazeze dhe maqedone, të cilat ushtruan dhunë ndaj popullsisë shqiptare. Gjenocidi sërb në Kosovë u intensifikua që nga vjeshta e vitit 1944. Këtë dhunë e kundërshtoi populli shqiptar nën udhëheqjen e Shaban Polluzhës.

Shqiptarët nuk u lejuan të jetonin në një shtet të përbashkët, madje edhe brenda Jugosllavisë mbetën të ndarë në katër njësi. Kosova u fut dhunshëm si krahinë autonome në kuadër të Sërbisë, e cila gjatë gjithë kohës vazhdoi të ushtronte dhunë dhe terror ndaj popullsisë shqiptare. Më 8 shkurt 1945, me pretext të shuarjes së kundërrevolucionit, Tito vendosi administrimin ushtarak në Kosovë në krye me Sava Drljević. Më pas terrori e gjenocidi u intensifikuan në Drenicë, ku gjatë pranverës së vitit 1945 njësitet partizane jugosllave vranë 4 mijë shqiptarë. Më 1 prill 1945 në Tivar u vranë dhe u hodhën në det mijëra shqiptarë ushtarë të mobilizuar. Si rrjedhojë e administrimit ushtarak dhe terrorit e gjenocidit sërbo-malazez e maqedon, në Kosovë gjatë kësaj kohe u likuiduan rreth 45 mijë shqiptarë. Më 8-10 korrik 1945 në Prizren, organet shtetërore e partiake të Jugosllavisë e të Kosovës (që ishin në duar të kuadrove sërbo-malazeze) organizuan Konferencën e Këshillit Nacional-Çlirimtar të Kosovës, ku u imponua rezoluta për aneksimin e Kosovës prej Sërbisë federale në kuadër të Jugosllavisë. Ata që e kundërshtuan këtë rezolutë, u likuiduan ose u dënuan me burgje shumëvjeçare.

- Populli shqiptar iu kundërvu me qëndresë të përhershme rivendosjes së pushtetit sërëb, e këtu dallohej Komiteti Nacional Demokratik i Shqiptarëve. Represioni vazhdoi deri në vitin 1966. Forma të represionit ishin edhe aksioni i mbledhjes së armëve 1955-6, ku u rrahën 3 mijë shqiptarë (në disa tekste autorët e njëjtë thonë 300 mijë) e vdiqën nga torturat 100 veta, pastaj u shpërngulën me dhunë 250 mijë shqiptarë (në disa tekste autorët e njëjtë thonë 400 mijë) për në Turqi, që nga fillimi i viteve 1950 e deri më 1966. Pas rënies së Aleksandër Ranković-it (1966), shqiptarët filluan të përdornin më lirshëm gjuhën dhe flamurin e tyre.
- Shqiptarët kurrë nuk u pajtuan me pushtetin sërëb, dhe për ta shfaqur këtë pakënaqësi, më 1968 organizuan demonstrata, ku kërkuan Republikë, Kushtetutë dhe Universitet. Sakrificat qenë të mëdha, por edhe efektet, sepse u shpejtua themelimi i Universitetit të Prishtinës, u miratua Kushtetuta e Kosovës, u themelua Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, si dhe u rrit veprimtaria botuese, kulturore, shkencore, etj. Filloi bashkëpunimi i shqiptarëve të Kosovës me Shqipërinë në fushën e arsimit, shkencës, kulturës, sportit, tregtisë. Në vitin 1981 studentët, të përkrahur nga populli shqiptar, organizuan prapë demonstrata me kërkesën "Kosova Republikë". Policia arrestoi, vrau dhe plagosi qindra protestues shqiptarë.⁴⁴

.....
 44 Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj. *Historia* 5. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013, faqe 85-98; Rexhepi, Fehmi. *Historia* 9. Libri Shkollor, 2013, faqe 110-123, 156-174; Bajraktari, Jusuf, Fehmi Rexhepi dhe Frashër Demaj. *Historia* 10. Prishtinë: Libri Shkollor, 2011, faqe 154-157 dhe 193-199; Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj. *Historia* 11. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013, faqe 159-163 dhe 208-211.

Bërthama e shtjellimeve që bëjnë **tekstet e Shqipërisë** është kjo:

- Trojet shqiptare në ish-Jugosllavi u ndanë mes pushtuesve italianë, gjermanë dhe bullgarë. Pjesa më e madhe e territorit të Kosovës ishte nën pushtuesit italianë, të cilët shpallën bashkimin e këtyre territoreve me Shqipërinë, duke krijuar “Shqipërinë e Madhe”. U vendos administrata me nëpunës shqiptarë dhe me gjuhën shqipe si gjuhë të administratës, u lejua botimi i librave e gazetave në shqip dhe u hapën shkolla në shqip. Bashkimi i pjesës më të madhe të Kosovës me Shqipërinë, pavarësisht se bëhej nga pushtuesit, pati ndikim pozitiv te shqiptarët. Edhe në zonën gjermane, shqiptarët arritën të drejtën e administratës shqiptare dhe të mësimi shqip, kurse në zonën bullgare gjendja nuk u përmirësua. Shqiptarët e Kosovës kishin fituar disa të drejta, pra gjendja ishte më e mirë se nën pushtuesit jugosllavë, prandaj qëndresa kundër pushtuesve nuk ishte e madhe në fillim. Në shumë qytete u organizuan demonstrata, ku u kërkuar pavarësia dhe u valëvit flamuri shqiptar. Në Kosovë, sikurse edhe në Shqipëri, u kristalizuan dy rryma: komunistët dhe nacionalistët. Komunistët e paktë kosovarë iu bashkuan lëvizjes antifashiste dhe themeluan Shtabin Kryesor të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare për Kosovë dhe Rrafsh të Dukagjinit. Pjesa tjetër e popullsisë si qëllim kishte mbrojtjen e bashkimit që ishte arritur, dhe më 16-20 qershor 1943 në Prizren organizuan Lidhjen e Dytë të Prizrenit. Këta nacionalistë shpallën se nuk do të bashkëpunonin as me partizanët jugosllavë e as me partizanët shqiptarë. Kishte edhe nacionalistë të pavarur, si vëllezërit Kryeziu. Më 31 dhjetor 1943 dhe 1 e 2 janar 1944 në Bujan komunistët kosovarë mbajtën një mbledhje, ku nxorën një rezolutë që thoshte se lufta kundër pushtuesve gjermanë është mënyra më e mirë për ta zgjidhur çështjen kombëtare, pra bashkimin me Shqipërinë, sipas parimit të vetëvendosjes. PKJ-ja i kundërshtoi vendimet e kësaj konference.
- Kosova me dhunë iu aneksua shtetit jugosllav, si pjesë e Serbisë. Shtabi i Ushtrisë së Jugosllavisë iu dha urdhër brigadave partizane kosovare që të ndiqnin ushtritë pushtuese në veri të Jugosllavisë, ndërkohë që ushtritë malazeze, serbe dhe maqedone hynë në Kosovë dhe vendosën me dhunë pushtetin serb. Nga 8 shkurti 1945 u vendos administrimi ushtarak. Vetëm në Tivar brenda një nate u pushkatuan qindra shqiptarë të mobilizuar. Në korrik 1945, në Kuvendin e Prizrenit, ku merrnin pjesë 137 anëtarë, prej tyre 33 shqiptarë, u miratua një rezolutë sipas të cilës Kosova njihet pjesë e Serbisë. Më 3 shtator 1945 Kryesia e Kuvendit të Serbisë miratoi ligjin që shpallte aneksimin e Kosovës nga Serbia.
- Gjendja në Kosovë ishte shumë e rëndë. Popullsia e Kosovës konsiderohej pakicë kombëtare. Pushteti serb nuk i respektoi të drejtat

kombëtare të shqiptarëve të Kosovës, ndonëse pas luftës kishte një përmirësim në arsimimin shqip, pasi që u hapën disa shkolla fillore dhe falë marrëdhënieve të mira mes Shqipërisë e Jugosllavisë, u dërguan disa mësues. U lejua botimi i revistave dhe gazetave në shqip dhe u ngritën biblioteka e radiostacioni. Nga viti 1947 këto të drejta humbën pak nga pak: nuk lejohej përdorimi i simboleve kombëtare, administrata përbëhej nga sërbe dhe në të nuk përdorej gjuha shqipe. Në vitin 1945, pushteti jugosllav lejoi kthimin e kolonëve sllavë, që ishin larguar gjatë luftës. Shqiptarët e Kosovës u organizuan për t'iu kundërpërgjigjë dhunës së pashembullt sërbe dhe kthimit të Kosovës nën Sëri. Organizata kryesore e shqiptarëve të Kosovës në këtë kohë ishte NDSH, e cila synonte çlirimin e Kosovës dhe të viseve të tjera dhe bashkimin e saj me Shqipërinë. Pushteti sërbi veçoi ashpër. Në vitin 1947 u shua NDSH. Gjatë viteve 50 filloi një valë e re presioni kundër shqiptarëve: *fushata për çarmatimin e popullsisë*, ku shqiptarët që nuk zotëronin armë detyroheshin t'i blinin në mënyrë që t'i shpëtonin dhunës; dhe *shpërngulja e shqiptarëve*, ku deri në vitin 1966 u shpërngulën nga Jugosllavia 400 mijë shqiptarë, por struktura etnike e Kosovës nuk ndryshoi, falë lindshmërisë së lartë në këtë zonë.

- Më 1 korrik 1966 në Brione u mbajt mbledhja e organeve të larta komuniste jugosllave, ku u kërkua një lloj decentralizimi i Jugosllavisë. Juristët e politikanët shqiptarë të Kosovës kërkuan ndryshimin e statusit të Kosovës, por kërkesat e tyre nuk u realizuan plotësisht. Kërkesat e shqiptarëve rriteshin. Në nëntor 1968 u organizuan demonstrata, ku u kërkua Kosova Republikë. Policia jugosllave i shtypi me dhunë këto demonstrata. Qeveria jugosllave bëri disa lëshime për shqiptarët e Kosovës: u lejua përdorimi i flamurit, u themelua universiteti, e me radhë. Më 1974, Kuvendi i Kosovës miratoi Kushtetutën e Krahinës Autonome Socialiste, që i dha Kosovës një status më të lartë juridik dhe gjendja e shqiptarëve u përmirësua. Megjithatë, Kosova vazhdonte të ishte e varur nga Sëria, e cila synonte ta zbehte autonominë e saj. Në mars të vitit 1981 studentët shqiptarë filluan të organizonin demonstrata, fillimisht kundër kushteve të këqija të jetesës. Më pas demonstratat u masivizuan me kërkesën "Kosova Republikë". Demonstratat u shtypën me dhunë. Autoritetet sërbe filluan t'ua mohonin shqiptarëve të gjitha të drejtat. U ndërpre çdo lidhje e Universitetit të Prishtinës me Universitetin e Tiranës.⁴⁵

.....
 45 Dërguti, Menduh, Sonila Boçi dhe Ledia Dushku. *Historia 9*. Tiranë: Botime Shkollore Alban, 2013, faqe 112-114 dhe 131-134; Dërguti, Menduh, Ledia Dushku, Ferit Duka dhe Sonila Boçi. *Historia 12*. Tiranë: Botime Shkollore Alban, 2013, faqe 118-119 dhe 137-139.

Bërthama në **tekstet e Sërbisë** është kjo:

- Sa i takon Kosovës nën sundimin italian/gjerman/bullgar 1941-1944, e tëra që thuhet është se Kosova e Metohia përfshihet në Shqipërinë italiane dhe se shqiptarët në Kosovë e Metohi kryejnë terror ndaj sërbeve, por nuk ka të dhëna për numrin e civilëve të vrarë gjatë kësaj periudhe.
- Sërbia territorialisht është formësuar në vitin 1945 me bashkimin e disa rrethëve të Sanxhakut të ndarë dhe me inkorporimin e Vojvodinës e të Kosovës dhe të Metohisë në përbërjen e vet me statute të veçanta. Sërbia ka marrë formën definitive nga mesi i vitit 1945, kur Vojvodina është bërë krahinë autonome, kurse Kosova ka marrë një shkallë më të ulët të autonomisë. Pas qetësimit të gjendjes në Kosovë, heqjes së administrimit (pushtetit) ushtarak dhe në kohën e bashkëpunimit gjithnjë më të madh me Shqipërinë, Kuvendi Popullor i Krahinës së Kosovës dhe Metohisë miratoi në Prizren (më 9 e 10 korrik 1945) Rezolutën me të cilën u shfaq dëshira e delegatëve për aneksimin e kësaj krahine nga Sërbia federale. Sërbia u bë e **vetmja njësi federale** në të cilën u formuan **njësi autonome**, megjithëse shkaqe të njëjta ose të ngjashme ekzistonin për konstituimin e autonomive edhe në njësitë e tjera federale. Kushtetuta e vitit 1946 parashihte mundësinë e konstituimit të njësive të tjera, por ato në praktikë nuk u formuan.
- Nuk ka asgjë për gjendjen e shqiptarëve në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore e deri te rënia e Aleksandar Ranković-it (1966).
- Në mbarim të nëntorit të vitit 1968 në Kosovë shpërthyen demonstratat, ku u theksua kërkesa që Kosova të bëhej republikë. U kërkuar kushtetuta e re, shkëputja dhe bashkimi i rajoneve në të cilat jetojnë shqiptarët, brohoritej për Enver Hoxhën. Megjithëse kishin pika masive dhe separatiste, Titoja i cilësoi si trazira të rëndomta, duke kritikuar ata “që ende po jetojnë në sfera të vjetra dhe që nuk janë të kënaqur se të gjitha kombet e kombësitë në vendin tonë gëzojnë të njëjtat të drejta”. Me këtë mendonte për sërbe. Pas kësaj ngjarjeje (demonstratat u shuan me dhunë) vazhduan diskutime të ashpra për ndryshimin e karakterit të federatës. Krahinat autonome në Republikën e Sërbisë fituan autorizime më të mëdha. Ndryshimet e karakterit të federatës, të bëra me amendamentet e viteve 1969 e 1971, sollën deri te forcimi i pozitës së republikave, por edhe të krahinave. Me amendamente u siguria pavarësia më e madhe e krahinave, të cilat fituan statusin e elementit kushtetues të federatës, megjithëse nuk kishin karakter të njësive federale. Krahinat mund të merrnin pjesë në marrjen e vendimeve në republikë, kurse republika nuk kishte të drejtë të përzihej në punët e krahinës. Kushtetuta e re u

miratua në shkurt të vitit 1974 dhe menjëherë u quajt "kartë e shoqërisë vetëqeverisëse". Së shpejti u miratua edhe Kushtetuta e Sërbisë, si dhe kushtetutat e Vojvodinës e të Kosovës, me rastin e shpalljes së të cilave nuk u ftua askush nga udhëheqësit politikë të Sërbisë. Me këto ndryshime kushtetuese u mundësua forcimi i mëtejme i pavarësisë së republikave dhe i krahinave, por edhe dobësimi i përbashkësisë, parcializimi i ekonomive dhe brejtja e Jugosllavisë si shtet i përbashkët. Megjithatë, krerët e LKJ-së edhe më tej flisnin me optimizëm për bashkimin, stabilitetin dhe progresin. Krahinat fituan autorizime të gjera në pushtetin ligdhënës dhe ekzekutiv, kështu që praktikisht kishin status të barabartë të anëtarëve, d.m.th. të shteteve, të federatës. Republika e Sërbisë, me këto kushtetuta, edhe vetë fitoi elemente të konfederalizmit. Krahinat fituan të drejtën që të vendosin, me të drejta të barabarta me republikat, për punët e federatës - madje sipas parimit të konsensusit (pajtimit). Pa votën e tyre nuk mund të merreshin vendimet në federatë. Shenjat e para të destabilizimit të Jugosllavisë u shfaqën në Kosovë. Shpërthimi i nacionalizmit dhe i separatizmit shqiptar në pranverë të vitit 1981 shënoi zgjimin e nacionalizmave të fjetur, fatalë për bashkësinë. Republikat do të fillojnë lojën rreth Kosovës. Përballë propagandës së përhapur, elita politike shqiptare tanimë sundonte sovraane në Kosovë. Vazhdonin presionet ndaj sërëbëve, dhunimet, shkatërrimi i pasurisë, madje edhe vrasjet nga urrejtja nacionale. Kjo vetëm e forcoi shpërnguljen e sërëbëve, që, në të vërtetë, po zgjaste që nga viti 1945 dhe që shkaktoi rënien e numrit të popullsisë sërëbe në gjithsej 13,2%. Ngjarjet në Kosovë e Metohi ushtruan ndikim negativ në marrëdhëniet e tërësishme në Jugosllavi. Milošević-i, me çështjen e zgjidhjes së problemeve në Kosovë e Metohi, e filloi reformën e Lidhjes së Komunistëve në Sërbi dhe të marrëdhënieve në federatë. Në shumë mitingje iu dha mbështetje masive personalitetit të Milošević-it dhe politikës së tij. Kjo pati për pasojë ndërrimin e udhëheqjes në Kosovë e Metohi, në Vojvodinë e Mal të Zi.⁴⁶

Në **tekstet e Malit të Zi** bërthama e zhvillimeve është kjo:

- Nuk ka asgjë për Kosovën nën sundimin italian/gjerman/bullgar 1941-1944.
- As për ripushtimin/riçlirimin e Kosovës më 1945.
- As për gjendjen e shqiptarëve në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore.

.....
⁴⁶ Đurić, Đorđe dhe Momčilo Pavlović. *Istorija 8*. Beograd: Zavod za udžbenike, 2010, faqe 137; Đurić, Đorđe dhe Momčilo Pavlović. *Istorija 3*. Beograd: Zavod za udžbenike, 2010, faqe 208, 235, 243, 245, 248.

- Për demonstratat e vitit 1968 në Kosovë nuk ka asgjë, ndërkaq për kushtetutën e vitit 1974 dhe të drejtat që fitonte Kosova nga kjo kushtetutë thuhet: me kushtetutën e vitit 1974 u zvogëluan kompetencat e qeverisë federative dhe u rrit roli i republikave dhe i krahinave. Sa u takon demonstratave të vitit 1981, thuhet se: në gjysmën e parë të viteve '80, Jugosllavia u ballafaqua me shpërthimin e nacionalizmit shqiptar në Kosovë. Protestat e studentëve në vitin 1981 u kthyen në demonstrata masive, në të cilat kërkohej që Kosova të bëhej Republikë, gjë që u shpjegua zyrtarisht si hap i parë për shkëputjen e saj nga RSFJ-ja. Policia dhe ushtria i shtypën demonstratat, por marrëdhëniet ndërnacionale në krahinë u keqësuan edhe më shumë.⁴⁷

Përmbajtja e **teksteve të Maqedonisë** ka këtë thelb:

- Për të mbajtur të nënshtruar popullin shqiptar dhe për të administruar më lehtë me viset shqiptare, Gjermania, Italia dhe Bullgaria i copëtuan dhe i ndanë mes vete territoret shqiptare jashtë Shqipërisë. Në prill të vitit 1941, Italia, përmes Shqipërisë së pushtuar, hyri në territorin e Jugosllavisë, duke i okupuar territoret e banuara me shqiptarë dhe e shpalli formimin e Shqipërisë Etnike (Shqipërisë së Madhe). U lejua përdorimi i gjuhës, flamurit, mbajtja e tubimeve me karakter nacional, u hapën shkolla në shqip, u lejua botimi i gazetave e revistave, u formua administrata dhe policia shqiptare, e me radhë. Populli shqiptar, edhe përkundër këtyre të drejtave, Italinë e llogariste për okupatore, prandaj që nga okupimi filloi të përgatitej për luftë të armatosur antifashiste. Në zonën e kontrolluar nga gjermanët, shqiptarët nuk i gëzonin gjithë këto të drejta, kurse në zonën bullgare nuk kishin kurrfarë të drejtash. Në Prizren u themelua Lidhja e Dytë e Prizrenit në krye me Bedri Pejanin. Gjermania, për interesa të veta e përkrahu këtë organizatë politike. Pas kapitullimit të Italisë, Gjermania bëri përpjekje për ta siguruar territorin e Kosovës me ndihmën e Divizionit SS "Skënderbeu". Nga 50 mijë rekrutë që kishte paraparë Gjermania në Kosovë, ky divizion mobilizoi vetëm 6.500 rekrutë. Pjesëtarët e këtij divizioni mbanin uniforma gjermane dhe kapela shqiptare, por nuk arritën të përfitonin simpatizues dhe përkrahje të mjaftuar.
- Pas çlirimit të Maqedonisë, ushtria e Maqedonisë me dy divizione dhe ushtria e Shqipërisë kaluan në territorin e Kosovës duke ndihmuar në çlirimin e Kosovës dhe në pastrimin e terrenit nga forcat e

.....
⁴⁷ Burzanoviq, Sllavko dhe Jasmina Gjorgjeviq, *Historia 9*. Podgoricë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 2008, faqe 120, 128; Rastoder, Sherbo, Radoje Pajoviq dhe Zvezdan Foliq. *Historia 4*. Podgoricë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 2009, faqe 254.

mbetura gjermane dhe divizioni SS. Pas çlirimit të vendit, shërbimi i fshehtë në vend (OZNA) ndërmori masa ndëshkuese për shuarjen e “kundërrevolucionit” nëpërmjet masave represive. Në shkurt u vendos administrimi ushtarak në Kosovë. Këtë e shfrytëzuan disa rryma regresive të ushtrisë jugosllave për t’iu hakmarrë popullit shqiptar, i cili u cilësua në mënyrë kolektive si bashkëpunëtor i okupatorit. Gjatë kësaj kohe u bënë disa likuidime grupore të banorëve të pafajshëm shqiptarë në Kosovë. Në Kuvendin e Prizrenit më 1945, pa dëshirën e shqiptarëve, u vendos që Kosova dhe Metohia si krahinë autonome të mbetet nën Sërbi dhe Jugosllavi.

- Gjendja e shqiptarëve nuk u përmirësua. Për shkaqe të presioneve të ndryshme nga Jugosllavia u shpërngulën rreth 250 mijë shqiptarë. Në këto shpërngulje ndikoi edhe aksioni për mbledhjen e armëve. Pas shkarkimit më 1966 të Aleksandar Ranković-it, njeriut të parë të policisë jugosllave, u bë kthesë vendimtare në trajtimin e shqiptarëve.
- Në nëntor 1968 shqiptarët organizuan demonstrata me kërkesë për shpalljen e Kosovës Republikë. Me kushtetutën e vitit 1974 shqiptarët fituan të drejta gati të barabarta me kombet e tjera jugosllave. U themelua Universiteti i Prishtinës, pastaj u hapën institute, muze, biblioteka, arkiva, teatro, gazeta, revista, Akademia e Shkencave dhe Arteve, e me radhë. Pas vdekjes së Titos, situata u komplikua. Shqiptarët menduan se kishte ardhë koha për ta kërkuar shpalljen e Republikës së Kosovës. U organizuan demonstratat e vitit 1981, të cilat në fillim u cilësuan si kundërrevolucionare edhe nga vetë udhëheqësia kosovare. Në mars 1989, Kuvendi i Kosovës në kushte të jashtëzakonshme dha pëlqimin për ndryshimin e kushtetutës, më 28 mars 1989 u suprimua autonomia e Kosovës.⁴⁸

Përmbledhje

Në përgjithësi, tekstet e Kosovës, të Shqipërisë dhe të Maqedonisë pohojnë se shqiptarët e kundërshtojnë pushtimin fashist në Kosovë, ndonëse në fillim e presin atë si çlirim e shpëtim nga robëria sërbe dhe shtojnë se bashkimi i pjesës më të madhe të territorit të Kosovës me Shqipërinë, pavarësisht se u bë nga pushtuesit italianë, pati ndikim pozitiv ndër shqiptarë. Në anën tjetër, tekstet e Malit të Zi

.....
 48 Vellkoski, Vllado, Halit Sejdiu, Arijan Alademi, Dimka Risteska dhe Gjorgji Pavlovski. *Historia 8*. Shkup: Prosvetno Dello, 2005, faqe 130-131; Veljanovski, Novica, Gordana Pletvarska, Sonja Cvetkovska dhe Shyqeri Xhaferi. *Historia 3 - arsimit gjimnazor*. Shkup: Prosvetno Dello, 2009, faqe 134-135, 137-138, 163, 164, 204-205, 208-209.

nuk e paraqesin fare Kosovën nën pushtimin italian, gjerman e bullgar, kurse krejt çka thonë tekstet e Serbisë për këtë segment është se në kohën e pushtimit italian në Kosovë e Metohi shqiptarë të armatosur kryejnë terror ndaj serbëve, por nuk ka të dhëna për numrin e civilëve të vrarë gjatë kësaj periudhe. Për këto krime të shqiptarëve, kryesisht ndaj fshatrave të banuara me serbë, për t'i larguar kolonët e për t'i kthyer pronat e konfiskuara gjatë periudhës mes dy luftërave botërore, e që përmenden vetëm në tekstet e Serbisë, autorë të huaj thonë se shifrat e të dëbuarve serbë e malazezë nga Kosova në këtë periudhë luhaten nga 30 mijë në 100 mijë, kurse vrasjet, shkatërrimet e vjedhjet, ndonëse reciproke, kanë për viktimitë kryesore serbët dhe malazezët. Për më shumë, tekstet e Kosovës jo vetëm që nuk i përmendin këto krime, por edhe pohojnë se shqiptarët, përkundër vuajtjeve nën sundimin jugosllav, janë treguar të kujdesshëm ndaj minoritetit serb e malazez, madje në shumë raste edhe duke i marrë këta në mbrojtje.

Pas kapitullimit të fashistëve italianë në Kosovë dhe vendosjes së nazistëve gjermanë, në rrafshin politik të Kosovës kristalizohen në thelb dy rryma: rryma nacionaliste, e mbështetur nga nazistët gjermanë dhe e organizuar në Lidhjen e Dytë të Prizrenit, që shpall se angazhohet t'i mbajë të bashkuara Kosovën me Shqipërinë; dhe rryma komuniste, e mbështetur kryesisht nga komunistët jugosllavë dhe e organizuar në Këshillin Nacional-Çlirimtar për Kosovë e Metohi, që në Konferencën e Bujanit shpall dëshirën e Kosovës për t'u bashkuar me Shqipërinë, duke sugjeruar të drejtën për vetëvendosje deri në shkëputje. Tekstet e Serbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë nuk merren fare me këto rryma, të cilat në tekstet e Shqipërisë, ndryshe nga ato të Kosovës, pasqyrohen më qartë, megjithëse sipërfaqësisht. Madje, tekstet e Shqipërisë i prezantojnë shkurtimisht edhe grupimet e pavarura nacionaliste që kundërshtonin pushtimin, siç ishte ai i vëllezërve Kryeziu në Gjakovë. Sidoqoftë, ndonëse në tekstet e Kosovës e të Shqipërisë këto dy rryma paraqiten përciptazi, në asnjërin tekst nuk përshkruhen përleshjet e armatosura mes tyre, e as fakti se njëra kishte mbështetjen nga nazistët gjermanë, e tjetra nga komunistët jugosllavë.

Pas tërheqjes së trupave gjermane nga Kosova, forcat partizane futen në qytetet e Kosovës Perëndimore, kurse në Kosovën Lindore hyjnë forcat bullgare, të cilave u bashkohen partizanë jugosllavë. Krahas me trupat gjermane largohen nga Kosova edhe pjesa më e madhe e grupeve të armatosura, të krijuara nga Lidhja e Dytë të Prizrenit, duke përfshi këtu pjesëtarët e divizionit SS "Skanderbeg", të cilët para largimit marrin pjesë në mbledhjen dhe largimin e komunistëve nga Kosova, përfshi edhe një numër hebrejsh. Kjo nuk prezantohet në tekstet e asnjë vendi, me përjashtim të një prezantimi sipërfaqësor që u bëhet në tekstet e Maqedonisë.

Njësitë partizane serbo-malazeze dhe maqedone që depërtojnë në Kosovë pas dëbimit të pushtuesve nazifashistë, sipas teksteve të Kosovës ushtrojnë dhunë ndaj

popullsisë shqiptare, e cila madje cilësohet edhe si gjenocid, duke e çuar numrin e shqiptarëve të vrarë në këtë periudhë në 45 mijë. Këtë depërtim e përshkruajnë si të dhunshëm edhe tekstet e Shqipërisë dhe ato të Maqedonisë. Këto të fundit thonë se situatën e shfrytëzuan disa rryma regresive të ushtrisë jugosllave për t'iu hakmarrë popullit shqiptar, i cili u cilësua në mënyrë kolektive si bashkëpunëtor i okupatorit. Tekstet e Sërbisë dhe të Malit të Zi nuk e paraqesin fare këtë depërtim. Por, Noel Malcolm-i që analizon të dhëna nga autorë të ndryshëm, vjen në përfundim se shifra e rreth 45 mijë shqiptarëve të vrarë është e ekzagjeruar.

Në asnjërin prej teksteve nuk përmendet se edhe partizanët kosovarë ndahen të paktën në dysh: në njërin anë partizanët e prirë nga Shaban Polluzha, që e refuzojnë urdhrin për t'iu luftuar trupat gjermane në veri të Jugosllavisë dhe vendosin të qëndrojnë në Kosovë për ta mbrojtë popullatën shqiptare nga partizanët jugosllavë; dhe, në anën tjetër, partizanët e prirë nga Fadil Hoxha, i cili pranon me qenë zëvendës i Savo Drljević-it, komandantit të pushtimit ushtarak jugosllav në Kosovë. Në këto tekste nuk figuron as e dhëna se partizanët e Shaban Polluzhës, të përqendruar kryesisht në Drenicë, likuidohen shpejt nga partizanët e Savo Drljević-it, komandant, e të Fadil Hoxhës, zëvendës-komandant, të ndihmuar edhe nga divizione me partizanë nga Shqipëria. Madje, sidomos në tekstet e Kosovës shpiket organizmi që emërtohet "Ushtria Nacionalçlirimtare e Kosovës (UNÇK)", ndonëse dihet se komunistët e Kosovës ishin pjesë e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare të Jugosllavisë.

Votimi në Kuvendin e Prizrenit në korrik të vitit 1945 për futjen e Kosovës në Sërbë, përkatësisht në Jugosllavi, në tekstet e Kosovës paraqitet si i imponuar, ku thuhet se ata që e kundërshtuan këtë rezolutë u likuiduan ose u dënuan me burgje shumëvjeçare, ndërkaq tekstet e Shqipërisë thonë se në këtë kuvend, nga 142 anëtarë, vetëm 33 ishin shqiptarë, gjë që nuk potencohet në tekstet e vendeve tjera. Pak a shumë edhe tekstet e Maqedonisë e thonë që në këtë kuvend u vendos pa dëshirën e shqiptarëve. Ndërkaq, ndërsa në tekstet e Malit të Zi nuk flitet fare për këtë, në tekstet e Sërbisë thuhet se në kohën e bashkëpunimit gjithnjë më të madh me Shqipërinë u miratua rezoluta me të cilën është shfaqur dëshira e delegatëve për aneksimin e kësaj krahine në Sërbinë federale si përbërje e saj. Pra, këto tekste duhet ta kenë parasysh se në këtë kuvend, ku u miratua me aklamacion rezoluta për aneksimin e Kosovës nga Sërbia federale, veç 33 prej 142 anëtarëve ishin shqiptarë (që ishin pjesë e rrymës komuniste), e madje edhe se anëtarëve të këtij kuvendi me qëllim iu përkujtua se në Kosovë ishin 50.000 trupa të gatshme për t'iu mbrojtë frytet e luftës.

Sa i takon gjendjes së shqiptarëve në periudhën 1945-1966, kur pushteti jugosllav detyron dhjeta mija shqiptarë në Jugosllavi të shpërngulen drejt Turqisë, duke përdorë trysni të ndryshme, si aksioni për mbledhjen e armëve, tekstet e Sërbisë

dhe Malit të Zi nuk thonë asnjë fjalë, kurse tekstet e Kosovës e të Shqipërisë, e edhe ato të Maqedonisë, japin shifra të fryra: 250 mijë, përkatësisht 400 mijë shqiptarë shpërngulen nga Jugosllavia drejt Turqisë. Prej vitit 1945 e deri në mes të viteve '60, grupe e organizata të ndryshme politike të shqiptarëve në Kosovë e kundërshtojnë pushtetin jugosllav, kryesorja nga të cilat ishte organizata ilegale Komiteti Nacional Demokratik i Shqiptarëve, i cili, si edhe grupimet e tjera, asgjësohet shpejt. Kjo organizatë përmendet në tekstet e Kosovës e të Shqipërisë, por nuk përmendet asnjëra nga organizatat e tjera ilegale që e kundërshtojnë pushtimin jugosllav, ndër kryesoret e të cilave ishte Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve (LRBSh), e udhëhequr nga Adem Demaçi. Pra, këto tekste nuk saktësojnë se në këtë kohë në Kosovë ekzistonin dy rryma politike: njëra legale dhe tjetra ilegale.

Gjatë viteve 1960, vit pas viti miratohen amendamente në Kushtetutën e Sërbisë dhe atë të Jugosllavisë në favor të Kosovës, kurse në korrik 1966 merret vendimi që njeriu i dytë pas Titos në pushtetin e Jugosllavisë, Ministri i Punëve të Brendshme, Aleksandar Ranković, të shkarkohet nga pushteti. Me këtë marrin fund shpërnguljet e zullumet e tipit të kërkimit masiv për armë dhe gjithçka e ngjashme me atmosferën e kontrollit të periudhës së Ranković-it.

Më 27 nëntor 1968, organizata ilegale e ashtuquajtur "Grupi 68", shumë prej anëtarëve të të cilit kishin qenë pjesë e LRBSh-së, organizon demonstrata në disa qytete të Kosovës, me kërkesën kryesore "Kosova Republikë". Në tekstet e Kosovës, të Shqipërisë dhe të Maqedonisë flitet sipërfaqësisht për këto demonstrata dhe përveçqë nuk përmenden organizatorët e tyre, nuk përmendet as se zyrtarët **legalë** politikë të Kosovës i patën cilësuar ato si armiqësore e shoviniste. Këto tekste avancimin e pozitës kushtetuese të Kosovës në Serbi e Jugosllavi ia atribuojnë ekskluzivisht këtyre demonstratave, duke e shpërfillë faktin se për këtë avancim, veç zyrtarëve **legalë** politikë të Kosovës, kishte ndikuar edhe rivendosja e marrëdhënieve Shqipëri-Jugosllavi. Tekstet e Malit të Zi nuk flasin fare për këto demonstrata, kurse tekstet e Sërbisë i paraqesin ato si separatiste, pas të cilave vazhdojnë diskutime të ashpra për ndryshimin e karakterit të federatës, me ç'rast sigurohet pavarësi më e madhe e krahinave, të cilat "...mund të merrnin pjesë në vendimmarrjen e republikës, kurse republika nuk kishte të drejtë të përzihej në punët e tyre".

Kjo pavarësi e krahinave kurorëzohet në vitin 1974 me miratimin e Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ), e cila dy Krahinave Autonome, Kosovës e Vojvodinës, që ishin pjesë përbërëse e Republikës së Sërbisë, u siguronte status për shumëçka të ngjashëm me atë të gjashtë republikave jugosllave, sidomos në vendimmarrjen ekonomike dhe disa fusha të politikës së jashtme. Tekstet e Kosovës përmendin miratimin e Kushtetutës së Kosovës në

vitin 1974 vetëm si efekt të demonstratave të vitit 1968, por s' merren fare me të drejtat që i garantoheshin Kosovës. Tekstet e Shqipërisë thonë se në bazë të kësaj kushtetute, Kuvendi i Kosovës tani mund të miratonte ligje dhe se pa pëlqimin e tij nuk mund të ndryshonte territori i Kosovës. Mirëpo, në bazë të kësaj kushtetute, territori i RSFJ-së përbëhej nga territoret e republikave, e as territori i republikave nuk mund të ndryshonte pa pëlqimin e republikave. Tekstet e Shqipërisë e përmendin edhe të drejtën e Kosovës për përfaqësim në Kuvendin e RSFJ-së dhe krijimin e disa institucioneve autonome në gjyqësi e financa. Kuvendi i RSFJ-së përbëhej nga Dhoma Federative, ku republikat kishin të drejtë t'i dërgonin nga 30 delegatë, kurse krahinat nga 20, si dhe nga Dhoma e Republikave dhe Krahinave, ku republikat kishin të drejtë t'i dërgonin nga 12 delegatë, kurse krahinat nga 8. Megjithatë, këto tekste nënvizojnë se ndonëse diktati sërbi zbehet ndjeshëm me këtë kushtetutë, Kosova vazhdonte të ishte e varur nga Serbia, e cila me të gjitha mënyrat mendohej t'ia zbehte autonominë. Tekstet e Serbisë përqendrohen kryesisht te forcimi i pavarësisë së krahinave, të cilat, sipas tyre, fituan autorizime të gjera në pushtetin ligjdhënës e ekzekutiv dhe status të barabartë në federatë, me të drejtën për të vendosë barabar me republikat për punët e federatës. Mirëpo, ndonëse thonë se Serbia fiton elemente të konfederalizmit, këto tekste nuk saktësojnë fare se ndërkohë që në pjesën hyrëse të Kushtetutës së RSFJ-së dhe të Kushtetutës së Serbisë përmendet e drejta e secilit komb për vetëvendosje deri në shkëputje, në Kushtetutën e Krahinës Autonome të Kosovës këto nuk figurojnë. Për më tej, në bazë të këtyre kushtetutave të vitit 1974, shqiptarët konsiderohen kombësi dhe jo komb.

Në tekstet e të gjitha vendeve trajtohen edhe demonstratat që shpërthejnë në mars e prill të vitit 1981, të organizuara fillimisht nga studentë të UP-së për kushte më të mira, e më pas edhe nga grupe të ndryshme politike e ilegale të shqiptarëve të Kosovës, me kërkesën "Kosova Republikë". As për këto demonstrata, si për ato të vitit 1968, tekstet e Kosovës e të Shqipërisë nuk i japin organizatorët, e as cilësimet që vinin prej zyrtarëve të lartë politikë shqiptarë të Kosovës për shovinizëm, separatizëm, tubime huliganësh e organizatash kundërrevolucionare shqiptare. Vetëm tekstet e Maqedonisë potencojnë që demonstratat e vitit 1981 qenë cilësuar si kundërrevolucionare edhe nga vetë udhëheqësia kosovare. Tekstet e Malit të Zi i prezentojnë shkurt e korrekt këto demonstrata, kurse ato të Serbisë thonë se pas këtyre demonstratave vazhduan presionet ndaj sërbeve, dhunimet, shkatërrimi i pasurisë, madje edhe vrasjet nga urrejtja nacionale, e këto vetëm e forcuan shpërnguljen e sërbeve.

Marrëdhëniet mes shqiptarëve e sërbeve acarohen edhe më tutje pas demonstratave të vitit 1981, kur Serbia bën planet për t'ia heqë autonominë Kosovës duke nisë fushata propagandistike mediale kundër atyre që tekstet e Serbisë i cilësojnë si "...presione ndaj sërbeve, dhunime, shkatërrime të pasurisë, madje edhe vrasje nga

urrejtja nacionale”. Sa u takon dhunimeve në Kosovë, Komiteti i Juristëve Sërbë dhe Ekspertëve për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në analizën e publikuar më 1990, analizon statistikën e dhunimeve dhe të tentim-dhunimeve gjatë viteve 80 dhe konstaton se shpeshësia e këtij krimi ishte shumë më e ulët në Kosovë se në pjesët e tjera të Jugosllavisë, dhe se në shumicën dërrmuese të rasteve, sulmuesi dhe viktimi ishin të të njëjtit komb. Po ashtu, sa u përket shpërnguljeve, duhet thënë se ndër arsyet kryesore të tyre ishin keqmenaxhimi i ekonomisë në Kosovë dhe shkalla e papunësisë që ishte më e larta në Jugosllavi.⁴⁹

.....

49 Malcolm, Noel. *Kosovo - A Short History*. London: Pan Macmillan, 2002, faqe 289-334; Schmitt, Oliver. *Kosova: histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*. Prishtinë: Koha, 2012, faqe 164-233; Fischer, Bernd. *Shqipëria gjatë Luftës, 1939-1945*. Tiranë: Çabej, 2000, faqe 124-129; Krieger, Heike (ed.). *The Kosovo Conflict and International Law*. Cambridge: Cambridge University Press, 2001, 2-8; Surroi, Veton. *Fadil Hoxha në vetën e parë*. Prishtinë: Koha, 2010, faqe 233-255.

5.4. Kosova gjatë viteve 1990

Ky nënkapitull heton konkretisht se si prezentohen nëpër tekste: rezistenca civile në fund të viteve 1980, rezistenca civile gjatë viteve 1990, rezistenca e armatosur 1998-1999, krimet e luftës; Konferenca e Rambujesë (Rambouillet) dhe ndërhyrja e NATO-s.

Në raport me temat e mësipërme, kjo është bërthama e shtjellimeve që bëjnë **tekstet e Kosovës:**

- Udhëheqja politike në Kosovë, e cila që nga vitit 1981 e deri më 1989 ishte instrument në duart e politikës sërbe, me vonesë filloi ta kuptonte lojën për suprimimin e autonomisë. Më 1989 shpërthyen demonstrata gjithëpopullore për ruajtjen dhe avancimin e autonomisë. Minatorët e Trepçës në shenjë protestë u ngujuan në zgafelle për dy javë rresht me kërkesën për ta mbrojtë pavarësinë e institucioneve të Kosovës dhe për ta shqyrtuar fatin e Kosovës në OKB. Më 23 mars 1989, Kuvendi i Kosovës, i rrethuar me tanke, dha pëlqimin për ndryshimin e kushtetutës. Gjatë manifestimeve kundër ndryshimit të kushtetutës, ranë 30 dëshmorë. U izoluan 254 intelektualë dhe kuadro udhëheqëse shqiptare. Një formë shumë e rëndë e represionit policor sërb ishte edhe helmimi i 7 mijë nxënësve shqiptarë.
- Inteligjenca shqiptare më 23 dhjetor 1989 themeloi Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK), e cila, nën udhëheqjen e Ibrahim Rugovës, angazhohej për zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe shqiptarëve në Jugosllavi në bazë të parimit të vetëvendosjes. Më pas u formuan edhe parti të tjera dhe Këshilli Koordinues i Partive Politike Shqiptare në ish-Jugosllavi, që mbështeste Kosovën shtet të pavarur dhe sovran, mbështeste kërkesën e shqiptarëve në Maqedoni për të qenë element shtetformues, ndërkaq për shqiptarët në Luginën e Preshevës kërkonte autonomi në shkallë të lartë me të drejtë bashkimi me Kosovën. Me qëllim të homogjenizimit të popullit shqiptar nisi pajtimi i gjaqeve, ku u falën mbi 1.200 gjaqe. Më 2 korrik 1990 Kuvendi i Kosovës e shpalli Deklaratën Kushtetuese mbi pavarësinë dhe barazinë e Kosovës në Jugosllavi. Më 7 shtator 1990 u miratua Kushtetuta e Kosovës. Në shtator 1991 u mbajt referendumi për Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Më 24 maj 1992 u mbajtën zgjedhjet parlamentare e presidenciale. Pushteti sërb dëboi nxënësit dhe studentët shqiptarë nga shkollat dhe fakultetet, por shqiptarët organizuan sistemin e pavarur të arsimit në shtëpi-shkolla. Po ashtu, pushteti sërb dëboi nga puna mijëra shqiptarë, shumë prej tyre u detyruan të emigronin. Shqiptarët, të udhëhequr nga Ibrahim Rugova, e bindën botën se e donin lirinë. Bota u bind se Kosova e meriton lirinë.

- Represioni serb ndikoi që më 1 tetor 1997 të shpërthejnë protestat e popullsisë dhe të studentëve të UP-së kundër pushtetit okupues. Ushtria dhe policia serbe vriste dhe masakronte shqiptarët anekënd Kosovës, prandaj për ta mbrojtë dhe çliruar popullin e Kosovës, në skenë doli Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), e cila u paraqit për herë të parë më 28 nëntor 1997. Platforma e saj për liri e pavarësi, për shoqëri të hapur e demokraci, u përkrah nga mbarë populli shqiptar. Lufta e UÇK-së u intensifikua sidomos pas luftës heroike të familjes Jashari në Prekaz, të udhëhequr nga Adem Jashari.
- Pushteti okupues serb futi në veprim një makineri të fuqishme ushtarako-policore e propagandistike, jo vetëm kundër UÇK-së, por edhe kundër popullatës civile, rrjedhojë e të cilave janë skenat e llahtarshme të barbarisë së eskadronëve gjakatarë, vrasjet e masakrimet e njerëzve të pafuqishëm e të pafajshëm, djegiet e shtëpive, burgosjet masive, etj. Nga janari deri në dhjetor të vitit 1998 u vranë mbi 2 mijë shqiptarë, duke mos llogaritur këtu edhe një numër të madh të të zhdukurve, ndërsa numri i të zhvendosurve ishte 430 mijë, pjesa dërmuese e të cilëve përbrenda Kosovës. Nga Kosova, Ushtria Jugosllave dëboi me dhunë mbi 1 milion shqiptarë. Vetëm gjatë bombardimeve të NATO-s, ushtria serbe vrau rreth 15 mijë shqiptarë. Mbi 3 mijë shqiptarë humbën pa gjurmë, ndërsa 5 mijë mbetën peng të Serbisë. Mbi 1.500 ushtarë të UÇK-së ranë dëshmorë për lirinë e Kosovës.
- Politika paqësore dhe lufta e UÇK-së dhanë rezultatet e veta. Lufta e UÇK-së hyri në një fazë të re pas masakrës së Reçakut dhe dështimit të bisedimeve në Rambuje. Për t'ia ndalur hovin krimeve të Serbisë ndaj shqiptarëve, ndodhi ndërhyrja ushtarake e bashkësisë ndërkombëtare. Pas tre muaj bombardimesh të NATO-s dhe aksioneve të vazhdueshme të UÇK-së, Ushtria Jugosllave u detyrua të tërhiqej nga Kosova. Në Kosovë, pos njësiteve të UÇK-së, hynë edhe forcat e NATO-s. OKB vendosi pushtetin civil, kurse NATO atë ushtarak. UÇK u shndërrua në TMK.⁵⁰

Bërthama e shtjellimeve që bëjnë **tekstet e Shqipërisë** është kjo:

- Situata për shqiptarët e Kosovës u përkeqësua kur në politikën serbe u shfaq Slobodan Milošević. Ai filloi t'i zëvendësonte udhëheqësit e Kosovës me njerëz të bindur ndaj tij, gjë që shkaktoi protesta të reja masive. Hapi i dytë i Milošević-it ishte ndryshimi i kushtetutës së vitit 1974. Më 23 mars 1989, Kuvendi i Kosovës, i rrethuar me tanke,

.....
50 Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj. *Historia 5*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013, faqe 99-106; Rexhepi, Fehmi. *Historia 9*. Libri Shkollor, 2013, faqe 62-71, 76-78; Bajraktari, Jusuf, Fehmi Rexhepi dhe Frashër Demaj. *Historia 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2011, faqe 199-207; Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj. *Historia 11*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013, faqe 211-221.

ndryshoi kushtetutën e vitit 1974, duke e vënë Kosovën nën autoritetin e Sërbisë. Pas kësaj u mbyll Kuvendi i Kosovës dhe të gjitha institucionet u mbushën sërish me nëpunës sërëbë. Kjo solli një valë të re protestash. Minatorët hynë në grevë për të rivendosur të drejtat.

- Në dhjetor 1989 u formua Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me kryetar shkrimtarin Ibrahim Rugova, që kishte për qëllim të organizonte kundërshtimin paqësor të shqiptarëve dhe internacionalizimin e çështjes së Kosovës. U formuan edhe parti të tjera. Më 2 korrik 1990 Kuvendi i Kosovës shpalli Deklaratën Kushtetuese, sipas të cilës Kosova fitonte statusin e republikës në kuadër të federatës jugosllave. Më 7 shtator 1990 u shpall Kushtetuta e Kosovës, kurse disa ditë më pas, referendumi për miratimin e Republikës, ku 90% e popullatës votuan pro shpalljes së Republikës. U shpallën zgjedhjet parlamentare e presidenciale dhe u krijua qeveria. Këto vendime nuk i pranoi Sërbia, e cila e shtoi dhunën në Kosovë, duke e shndërruar në gjenocid etnik.
- Krahas krahut paqësor në mesin e viteve 1990 u shfaq edhe krahu ushtarak: Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), me komandant të përgjithshëm Adem Jasharin, e cila luftoi për mbrojtjen e vendit nga ushtria sërëbe që kryente masakra mbi popullsinë civile. Shumë shqiptarë të Kosovës u detyruan t'i linin shtëpitë e tyre për t'u shpëtuar masakrave sërëbe. Në pranverë-verë të vitit 1998, UÇK-ja kishte vendosur nën kontroll një pjesë të Kosovës. Gjatë verës së vitit 1998 ushtria sërëbe i ripushtoi këto pjesë të Kosovës, duke kryer reprezalje të përgjakshme ndaj popullsisë civile. Ndonëse kishte shpallë armëpushim dhe ishte zotuar se do të tërhiqte një pjesë të trupave nga Kosova, më 15 janar 1999 trupat sërëbe në Reçak masakruan 45 shqiptarë të Kosovës.
- Përfaqësues të Kosovës e të Sërbisë u mbledhën në një konferencë në Rambuje, afër Parisit, për të biseduar për zgjidhjen e krizës. Marrëveshja u nënshkrua vetëm nga delegacioni shqiptar. Sipas saj, Kosova mbetej pjesë e Jugosllavisë, brenda të cilës do të gëzonte "autonomi substanciale", kurse çështja e pavarësisë do të diskutohej pas tri viteve. Forcat sërëbe filluan sulmet për spastrim etnik, ku nga Kosova u larguan rreth një milion shqiptarë, që u strehuan në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi e vende tjera të Europës. Pas këtij akti, NATO bombardoi Sërbinë dhe e detyroi të tërhiqej nga Kosova. Kosova u vendos nën administrimin e OKB-së sipas Rezolutës 1244. Trupat e NATO-s kishin për detyrë të demilitarizonin UÇK-në, të krijonin kushte për kthimin e refugjatëve, etj. Shqiptarët u rikthyen në vatrat e tyre.⁵¹

.....
51 Dërguti, Menduh, Sonila Boçi dhe Ledia Dushku. *Historia 9*. Tiranë: Botime Shkollore Alban, 2013, faqe 135-136; Dërguti, Menduh, Ledia Dushku, Ferit Duka dhe Sonila Boçi. *Historia 12*. Tiranë: Botime Shkollore Alban, 2013, faqe 139, 152-153.

Bërthama në **tekstet e Sërbisë** është kjo:

- Nuk ka asgjë për rezistencën civile në fund të viteve 1980 në Kosovë.
- As për rezistencën civile gjatë viteve 1990 në Kosovë.
- Sa i takon rezistencës së armatosur më 1998-1999, thuhet se: Aksionet e çdoditshme të armatosura të grupeve terroriste shqiptare, të shpallur si Ushtria Çlirimtare e Kosovës, plaçkitjet dhe konfrontimet e tyre me forcat e rendit, në të cilat kanë pësuar më shumë civilët, në mënyrë të theksuar e kanë përkeqësuar gjendjen në Kosovë.
- Më në fund, shtetet perëndimore u përzien, duke u dhënë përkrahje të hapur shqiptarëve. Pas bisedimeve të pasuksesshme në Rambuje dhe Paris dhe pas refuzimit të palës serbe që t'i nënshkruante kërkesat ultimative për tërheqjen e ushtrisë dhe policisë nga Kosova në shkurt të vitit 1999, pasoi agresioni i NATO-s, i cili zgjati prej 24 mars 1999 deri më 10 qershor 1999. Vdiqën ndërmjet 1200-2500 civilë, prej të cilëve 88 fëmijë, ndërsa u lënduan/plagosën rreth 5 mijë njerëz. U shkaktua një dëm i madh material, që jozyrtarisht vlerësohet në 30 miliardë dollarë. Nga të dhënat e tjera, dëmi përfshin rreth 100 miliardë dollarë. Në RFJ, NATO-ja hodhi mbi 23 mijë bomba dhe raketa, gjatë bombardimit u goditën 7643 shtëpi, rreth 300 shkolla, 53 spitale dhe 50 kisha e përmendore. Pas 78 ditësh të bombardimeve të pandërprera, ushtria dhe policia u tërhoqën nga Kosova. Sipas dispozitave të Marrëveshjes së Kumanovës më 9 qershor 1999, ushtria duhej të tërhiqej 5 kilometra brenda territorit të vet nga kufiri administrativ me Kosovën (zona e sigurisë). KS i OKB-së miratoi Rezolutën 1244 për Kosovën, me të cilën garantohej integriteti territorial i Jugosllavisë. Nga momenti i hyrjes së forcave të NATO-s në Kosovë u vranë disa qindra sërbe civilë dhe u rrëmbyen mbi njëmijë njerëz. Nga Kosova u shpërngulën mbi 220 mijë sërbe dhe joshqiptarë. Jiri Dinstbir, raportues special i OKB-së për të drejtat e njeriut në ish-Jugosllavi, në raportin e tij për Sekretarin e Përgjithshëm të KB-së, vlerësoi se në Kosovë po ndodhte spastrimi etnik i sërbeve në prani të OKB-së dhe KFOR-it. Në shkurt të vitit 2000, Republika Federale e Jugosllavisë i dërgoi letër KS të OKB-së, ku e akuzon misionin e OKB-së në Kosmet për gjendjen e rëndë të shkeljes së Rezolutës 1244, duke precizuar që prej ardhjes së KFOR-it janë kryer 4249 sulme terroriste, janë vrarë 899, janë lënduar/plagosur 784 dhe janë rrëmbyer 834 persona. Në maj të vitit 1999 Prokurorja e Tribunalit të Hagës, Louise Arbour, ngriti aktakuzë kundër Presidentit të RFJ-së, Slobodan Milošević, Presidentit të Sërbisë, Milan Milutinović, zëvendës-presidentit të qeverisë federale, Nikola Šainović, shefit të shtabit të përgjithshëm të ushtrisë jugosllave, gjeneralit Dragolub Ojdanić dhe ministrit të punëve të brendshme, Vljajka Stojilković. U ofruan 5 milionë dollarë për informacione që të ndihmonin

në arrestimin e Slobodan Milošević-it, Radovan Karadžić-it dhe Ratko Mladić-it. Më 1 prill 2001 u arrestua Milošević-i, kurse më 28 qershor 2001 u ekstradua në Hagë. Vdiq në vitin 2006 në burgun e Tribunalit të Hagës.⁵²

Në **tekstet e Malit të Zi** bërthama e zhvillimeve është kjo:

- Në vjeshtën e vitit 1986 u shfaq programi i njohur si Memorandumi i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Sërbisë. Në të, si interes i popullit sërb, theksohet bashkimi i të gjithë sërbeve në një shtet nacional ose jeta në Jugosllavinë e centralizuar.
- U ndryshua edhe organizimi shtetëror i Sërbisë. Në mars të vitit 1989 u hoqën autonomitë e krahinave, ndërsa u shpërnda Kuvendi i Kosovës.
- Vatër e re e luftës u bë Kosova. Popullsia shumicë shqiptare refuzoi pas heqjes së autonomisë që ta njëhte pushtetin shtetëror të Sërbisë dhe krijoi institucionet e veta paralele.
- Konfliktet e shqiptarëve me policinë dhe ushtrinë u bënë gjithnjë e më të shpeshta dhe u kthyen në kryengritje. U përzie bashkësia ndërkombëtare, duke ndërhyrë politikisht në favor të shqiptarëve. Pas dështimit të bisedimeve në Rambuje erdhi edhe ndërhyrja ushtarake e Paktit NATO. Gjatë bombardimit disamujor të RFJ-së (mars-qershor 1999), Serbia pësoi humbje në njerëz dhe shkatërime të mëdha të objekteve ekonomike, ushtarake dhe të komunikacionit. Sipas dispozitave të Marrëveshjes së paqes, në Kosovë u vendosën forcat ushtarake ndërkombëtare. Në zgjedhjet presidenciale në RFJ në shtator 2000, mori fund sundimi i Slobodan Milošević-it. Qeveria e re e Sërbisë ia dorëzoi Milošević-in Gjykatës Ndërkombëtare për Krime Lufte në Hagë.⁵³

Tekstet e Maqedonisë nuk e prezentojnë fare Kosovën gjatë viteve 90.

Përmbledhje

Në fund të vitit 1988 qindra mija shqiptarë protestojnë në Kosovë kundër heqjes së autonomisë së Kosovës nga Serbia e Slobodan Milošević-it. Tekstet e Kosovës nuk qartësojnë se protestuesit e kundërshtonin ndërrimin e udhëheqësve

.....

52 Đurić, Đorđe dhe Momčilo Pavlović. *Istorija 3*. Beograd: Zavod za udžbenike, 2010, faqe 251-253. Đurić, Đorđe dhe Momčilo Pavlović. *Istorija 8*. Beograd: Zavod za udžbenike, 2010, faqe 186-187.

53 Burzanović, Sllavko dhe Jasmina Gjorgjević. *Historia 9*. Podgoricë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 2008, faqe 128, 129, 131 dhe 132; Rastoder, Sherbo, Radoje Pajović dhe Zvezdan Foliq. *Historia 4*. Podgoricë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 2009, faqe 254-256.

komunistë të Kosovës. Po kështu, grevat e minatorëve të Kosovës, të cilët në shkurt 1989 ngujohen për dhjetë ditë në zgafile me kërkesën kryesore kundër rrënimin të autonomisë së Kosovës, prezentohen në këto tekste pa kërkesat për “vëllazërim-bashkim dhe rrugën e drejtë të Titos”. Këto protesta e greva nuk prezentohen fare në tekstet e Sërbisë e të Malit të Zi, kurse në ato të Shqipërisë paraqiten shkurtimisht si grevë për rivendosjen e të drejtave të shqiptarëve. Pas këtyre grevave dhe protestave, në Kosovë vihet gjendja e jashtëzakonshme dhe arrestohen qindra intelektualë, profesorë e udhëheqës ndërmarrjesh shoqërore. Këto arrestime përmenden vetëm në tekstet e Kosovës, të cilat nuk e japin askund arrestimin dhe gjykimin edhe të ish-udhëheqësit politik të shqiptarëve të Kosovës, Azem Vllasit, që lirohet nga burgu mbas afro një viti.

Me gjithë këto protesta e greva të shqiptarëve të Kosovës, Sërbia e përfundon procesin e suprimimit të autonomisë së Kosovës, kur më 23 mars 1989 këtë e miraton Kuvendi i Kosovës me shumicë shqiptare. Ndërsa tekstet e Sërbisë nuk e pasqyrojnë këtë fare, kurse ato të Malit të Zi e përmendin këtë suprimim krejt telegrafikisht. Tekstet e Kosovës e të Shqipërisë thonë se ndërtesa e Kuvendit të Kosovës ishte e rrethuar me polici e ushtri sërbe, por asnjëri prej këtyre teksteve, përveç që nuk thotë se megjithatë ky kuvend kishte shumicë shqiptare, nuk thotë as se dhjetë deputetë shqiptarë të Kuvendit të Kosovës votojnë kundër heqjes së autonomisë të vitit 1974. Disa muaj pas suprimimit të autonomisë së Kosovës formohet Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e cila nën udhëheqjen e Ibrahim Rugovës brenda pak kohësh bëhet bindshëm partia më e madhe politike që udhëheq Kosovën. Në asnjë prej teksteve të këtyre vendeve nuk thuhet se fillimisht programi i saj ishte për autonomi.

Në mars e prill të vitit 1990, mija nxënës të Kosovës dërgohen në spitale drejt nga shkollat, për shkak të dhimbjeve të barkut, të kokës dhe vjelljeve nga, siç thuhej asokohe, helmimet masive të fëmijëve shqiptarë. Më vonë një ekspert toksikologjie i Kombeve të Bashkuara, në bazë të analizave të gjakut dhe urinës erdhi në përfundimin se kishte gjetë prani të substancave sarin dhe tabun. Në vitin 1995 bëhet publike se Armata e Jugosllavisë ka prodhuar sarin. Sidoqoftë, kjo nuk përmendet në tekstet e Sërbisë e të Malit të Zi, kurse në ato të Shqipërisë jepet një pamje për “...helmimet masive të nxënësve të Kosovës nga sërëbët”, ndërkaq tekstet e Kosovës thonë se një prej formave të rënda të presionit policor ishte “...helmimi i mbi 7,000 nxënësve e studentëve me helme lufte”. Por, në asnjëri prej këtyre teksteve nuk përmendet se në disa pjesë të Kosovës ngjajnë dhjeta sulme ndaj sërëbëve lokalë nga shqiptarë që besonin se fëmijët u ishin helmuar nga pushteti sërëb në Kosovë.

Më 2 korrik 1990, të mbështetur edhe nga LDK-ja, deputetët e Kuvendit të Kosovës, para ndërtesës së Kuvendit të Kosovës në Prishtinë, e shpallin Kosovën

republikë **në kuadër të Jugosllavisë**. Pas kësaj shpalljeje Sërbia i suprimon të gjitha organet legjislative, ekzekutive e gjyqësore të Kosovës; pushon nga puna shumicën dërrmuese të shqiptarëve të punësuar; mbyll televizionin, radion, gazetatat, spitalet, fabrikat dhe studentëve dhe mësimdhënësve shqiptarë ua ndalon t'i shfrytëzojnë ambientet e UP-së. Pas dy muajsh, më 7 shtator 1990, Kuvendi i Kosovës shpall Kushtetutën e Republikës së Kosovës **në kuadër të Jugosllavisë**, kurse më 26-30 shtator 1991 organizon referendumin për njohjen e Kosovës si shtet sovran e të pavarur **me të drejtë lidhjeje me Jugosllavinë**. Tekstet e Sërbisë e të Malit të Zi nuk i japin fare këto zhvillime, ato të Shqipërisë pjesërisht e me pasaktësi, kurse të Kosovës e prezentojnë më saktë shpalljen e Kosovës republikë në kuadër të Jugosllavisë. Sa i takon Kushtetutës së Kosovës, as tekstet e Kosovës e as ato të Shqipërisë nuk përmendin se edhe ajo ishte kushtetutë për Kosovën republikë **në kuadër të Jugosllavisë**. Po ashtu, në këto tekste nuk thuhet askund se fill pas aktit të shpalljes së kësaj kushtetute, shumica e deputetëve të Kuvendit arratisen nga Kosova. Edhe referendumin, tekstet e Kosovës e të Shqipërisë prezentojnë si referendum për Kosovën shtet sovran e të pavarur, duke mos e përmend **të drejtën e lidhjes me Jugosllavinë**. Kuvendi i Republikës së Kosovës më 19 tetor 1991 e ndryshon Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe shkëput çdo lidhje me shtetin e Jugosllavisë, por kjo nuk prezantohet në tekstet e Sërbisë e të Malit të Zi, e as në ato të Kosovës e të Shqipërisë.

Në këtë periudhë, nën udhëheqjen e LDK-së krijohet sistemi paralel në disa fusha: arsim, shëndetësi, financa, media, kulturë e sport, organizohen zgjedhje presidenciale e parlamentare, dhe në rrafshin diplomatik llobohet për ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës. Kjo nuk përmendet në tekstet e Sërbisë, e në ato të Malit të Zi vetëm thuhet se "...popullsia shumicë shqiptare pas heqjes së autonomisë refuzoi ta njihnte pushtetin shtetëror të Sërbisë dhe krijoi institucionet e veta paralele". Në tekstet e Shqipërisë përmenden vetëm zgjedhjet parlamentare e presidenciale, por jo edhe sistemi paralel në fushat e lartpërmendura, ndërkaq ky organizim paralel zë vend në tekstet e Kosovës. Në tekstet e Kosovës përmenden suprimimi i të gjitha organet legjislative, ekzekutive e gjyqësore të Kosovës nga Sërbia; pushimi nga puna i shumicës dërrmuese të shqiptarëve të punësuar; mbyllja e televizionit, radios, gazetave, spitaleve, fabrikave; ndalimi i studentëve dhe i mësimdhënësve shqiptarë për t'i shfrytëzuar ambientet e UP-së, si dhe krijimi i sistemit paralel nga Kosova në disa fusha të jetës: arsim, shëndetësi, financa, media, kulturë e sport dhe organizimi i zgjedhjeve presidenciale e parlamentare. Këto në tekstet e Shqipërisë përmenden pjesërisht, ndërsa në tekstet e Sërbisë e të Malit të Zi nuk përmenden fare.

Deri në mesin e viteve 1990, **rezistenca paqësore pasive** e udhëhequr nga LDK-ja nën Ibrahim Rugovën ishte e pakonkurrencë. Në këtë kohë, Adem

Demaçi, që kishte vuajtur 28 vjet nëpër burgjet e Jugosllavisë së Titos për shkak të angazhimit për bashkimin e viseve shqiptare nën Jugosllavi me Shqipërinë, përfshihet në Partinë Parlamentare të Kosovës (PPK) për të bërë **rezistencë paqësore aktive**. Kjo mbasi në Kosovë, sipas tij, po lindte një shtresë e njerëzve të pakënaqur nga politika e **rezistencës paqësore pasive** e që kërkonin zgjidhje të armatosur. Kjo ndarje e politikës së Kosovës nuk prezentohet në tekstet e asnjë vendi. Demaçi nuk rezultoi i suksesshëm në synimin e tij për të bërë **rezistencë paqësore aktive**. Në shtator të vitit 1996 me ndërmjetësimin e shoqatës Shën Exhidio, Ibrahim Rugova nënshkruan me Slobodan Milošević-in marrëveshjen për kthimin e nxënësve dhe të studentëve shqiptarë në objektet shkollore dhe universitare, të uzurpuara nga organet shtetërore të Serbisë. As kjo nuk figuron në tekstet e asnjërit vend.

Pala serbo-jugosllave nuk e përfill marrëveshjen, prandaj më 1 tetor 1997 studentët e Universitetit të Prishtinës (UP) organizojnë protesta për kthimin e procesit mësimor të shqiptarëve në ndërtesat e UP-së. Këto protesta prezentohen vetëm në tekstet e Kosovës, ku **represioni i regjimit serb** këtu emërtohet “represion serb”; **protestat e studentëve**, të cilave iu patën bashkëngjitë shumë qytetarë shqiptarë, quhen “protesta të popullsisë dhe të studentëve”; kurse qëllimi i deklaruar i protestave të studentëve, **kthimi në objektet universitare**, nuk përmendet kund. Ky prezentim mund të krijojë përshtypje se këto protesta janë organizuar për ta çliruar dhe pavarësuar Kosovën nga Serbia.

Shkeljet e të drejtave të njeriut që regjimi i Serbisë ushtronte kundër shqiptarëve të Kosovës gjatë viteve 1990, në tekstet e Kosovës prezentohen si **masakra** të regjimit serb **anekënd** Kosovës, të cilat “...e nxisin daljen e UÇK-së për ta mbrojtë popullin e Kosovës”. Këto shkelje në tekstet e Shqipërisë prezentohen si **gjenocid etnik**, kurse arsytimi rreth daljes dhe qëllimit të UÇK-së është i njëjtë me atë në tekstet e Kosovës. Tekstet në Serbi e në Mali të Zi nuk i evidentojnë fare këto shkelje, kurse përkeqësimin e gjendjes në Kosovë, tekstet e Serbisë e prezentojnë si pasojë të “...plaçkitjeve dhe e konfrontimeve të grupeve terroriste shqiptare, të shpallura si Ushtri Çlirimtare e Kosovës, me forcat e rendit, ku e pësojnë gjithmonë e më shumë civilë”, por s’japin të dhëna për përkatësinë etnike të këtyre civilëve. Tekstet e Malit të Zi thonë vetëm se “...konfliktet e shqiptarëve me policinë dhe ushtrinë u bënë gjithnjë e më të shpeshta dhe u kthyen në kryengritje”.

Ndarja mes krahut paqësor dhe ushtarak të politikës në Kosovë nuk përmendet në tekstet e asnjë vendi, sikur që nuk përmenden as tri konceptet politike e ushtarake për luftën në Kosovë: a) koncepti i Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës (**FARK**), themeluar nga Ministria e Mbrojtjes e Qeverisë

së Republikës së Kosovës, që ishte për luftë të drejtuar nga oficerë profesionistë; b) koncepti i Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (**LKÇK**), e formuar kryesisht nga ish të burgosur politikë, që parashihte krijimin e një fronti të gjerë politik e ushtarak për organizimin e kryengritjes së përgjithshme të armatosur, ku do të përfshiheshin të gjitha grupet politike e ushtarake që synojnë çlirimin e Kosovës nga Sërbia; dhe c) koncepti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (**UÇK**), e krijuar nga Lëvizja Popullore e Kosovës (**LPK**), që pëlqente luftën guerile me qëllim të provokimit të ndërhyrjes ushtarake të NATO-s kundër forcave sërbe. Mungesa e këtyre koncepteve të të tri rrymave e nënkupton edhe mungesën e të dhënave mbi fërkimet dhe përleshjet ndërmjet tyre.

Këto tekste prezentojnë vetëm krimet e “palës tjetër”, duke ofruar etiketa në vend të fakteve e argumenteve për krimet. Ta zëmë, në tekstet e Sërbisë e të Malit të Zi s’përmendet asnjë shqiptar i vrarë nga forcat sërbe/jugosllave gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë, sikurse qysh në tekstet e Kosovës e të Shqipërisë nuk përmendet asnjë sërëb i vrarë nga forcat e UÇK-së e të NATO-s gjatë e pas konfliktit të armatosur. Tekstet e Kosovës e të Sërbisë edhe i hiperbolizojnë krimet e “palës tjetër” dhe lënë hapësirë për keqkuptime. Tekstet e Sërbisë i referohen një letre të RFJ-së dërguar KS të OKB-së në shkurt 2000, që thotë se nga çasti i hyrjes së forcave të NATO-s në Kosovë “...janë vra 899 dhe janë rrëmbyer 834 persona”, por nuk jepen përkatësia e tyre etnike dhe fati i personave të rrëmbyer. Fondi për të Drejtën Humanitare (FDH) me seli në Beograd, shënon 1,123 civilë sërëbë të vrarë në periudhën (janar 1998-dhjetor 1999), prej të cilëve 786 vriten pas hyrjes së trupave të NATO-s (qershor 1999 – dhjetor 1999). Numri i civilëve të vrarë nga NATO-ja, në tekstet e Kosovës e të Shqipërisë nuk shënohet fare, kurse në tekstet e Sërbisë së paku dyfishohet dhe nuk faktehet se numri më i madh i këtyre vrasjeve kanë ndodhë në Kosovë.

Tekstet e Kosovës, në anën tjetër, thonë se gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë, veç në periudhën janar-dhjetor 1998 “...janë vra mbi 2 mijë shqiptarë, duke mos llogaritur këtu edhe një numër shumë të madh të të zhdukurve”. Por, po për këtë periudhë, botimi shumëvëllimësh **Libër Kujtimi i Kosovës 1998-2000** i FDH-së, regjistron 1,660 shqiptarë të vrarë (përfshi 678 ushtarë të UÇK-së) dhe 296 sërëbë (përfshi 167 pjesëtarë të Ushtrisë Jugosllave dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme). Po sipas teksteve të Kosovës, në periudhën e bombardimeve të NATO-s (24 mars – 10 qershor 1999) “...ushtria sërëbe ka vrarë rreth 15 mijë shqiptarë”. **Libër Kujtimi i Kosovës 1998-2000** numrin e civilëve shqiptarë të vrarë në periudhën janar 1998-dhjetor 2000, që përfshin 78-ditëshin e bombardimeve të NATO-s, e nxjerr 7,864 gjithsej. Pra, numri i të vrarëve në tekstet e Kosovës del i dyfishuar, ndonëse nuk jepen burime të të dhënave.

Pak a shumë e njëjta gjë sikur me prezentimin e vrasjeve, ndodhë edhe me prezentimin e deportimeve/shpërnguljeve. Tekstet e Kosovës dhe të Shqipërisë nuk shënojnë shifër të të shpërngulurve serbë dhe joshqiptarë nga Kosova pas vendosjes së KFOR-it, kurse për tekstet e Serbisë kjo shifër është mbi 220,000, ndërsa për Komisaratin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) 210,000. Njëjtë, tekstet e Serbisë dhe të Malit të Zi nuk raportojnë deportimet e shqiptarëve nga Kosova gjatë bombardimeve të NATO-s, që sipas UNHCR, kapin shifrën prej 862,979 personash. Në tekstet e Kosovës kjo shifër është **mbi një milion** shqiptarë, ndërsa në tekstet e Shqipërisë **rreth një milion** shqiptarë.

Tekstet e Kosovës për krimet e forcave serbe ndaj shqiptarëve gjatë luftës në Kosovë japin kualifikimin **gjenocid**. Në vend të definicionit të Konventës së OKB-së për parandalimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit, por edhe argumenteve nëse në Kosovë ka pasë **gjenocid**, këto tekste ofrojnë fraza të tipit: "...skenat e llahtarshme të barbarisë së eskadronëve gjakatare". Për më shumë, me cilësimin e krimeve të forcave serbe në Kosovë si **gjenocid**, autorët e teksteve të Kosovës shpërfillin mendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, sipas të cilës, veprimet e regjimit të Serbisë nën sundimin e Slobodan Milošević-it mund të kualifikohen më parë si **krime kundër njerëzimit** sesa si **gjenocid**.

Tekstet e Serbisë e të Malit të Zi, siç u tha edhe më lart, s'i prezentojnë krimet e forcave serbe ndaj shqiptarëve të Kosovës, por e japin informatën që Tribunali Ndërkombëtar për Krime të Luftës për ish-Jugosllavi (ICTY) ka ngritë aktakuzë kundër liderëve kryesorë politikë e ushtarakë të RFJ-së dhe të Serbisë, ndonëse pa i dhënë akuzat që u ngarkohen. Në anën tjetër, tekstet e Kosovës e të Shqipërisë, as s'i pasqyrojnë krimet e kryera nga UÇK-ja ndaj serbëve dhe joshqiptarëve gjatë dhe pas konfliktit të armatosur në Kosovë, por as s'i përmendin akuzat e ICTY-së për krime lufte e krime kundër njerëzimit ndaj dy komandantëve kryesorë të UÇK-së. Krimet e kryera nga ana e UÇK-së ndaj serbëve dhe joshqiptarëve **gjatë** konfliktit të armatosur në Kosovë, nuk pasqyrohen fare në tekstet e Serbisë. Këto tekste sa i takon krimeve të UÇK-së, japin të dhëna **vetëm** për krimet që janë kryer **pas** konfliktit të armatosur dhe hyrjes së trupave të KFOR-it në Kosovë. Prej këtyre teksteve del se **gjatë** konfliktit të armatosur në Kosovë vetëm NATO-ja ka kryer krime.

Për 78 ditë të bombardimeve të NATO-s kundër RFJ-së, sipas teksteve të Serbisë "...janë vra ndërmjet 1200 dhe 2500 civilë", por në tabelën që japin këto tekste për pësimet e civilëve nga bombardimet e NATO-s, ofrohen të dhëna vetëm për 347 civilë të vrarë. Në këtë tabelë përmendet përkatësia etnike shqiptare vetëm për 70 civilët e vrarë nga forcat e NATO-s në afërsi të Gjakovës, kurse për 50 civilët e vrarë në fshatin Luzhan të Podujevës, 20 në

afërsi të Pejës dhe 87 në fshatin Korishë të Prizrenit, nuk shënohet askund përkatësia e tyre shqiptare. Po ashtu, në këtë tabelë s'figuron askund sulmi i forcave të NATO-s në Burgun e Dubravës, ku, sipas FDH-së, janë vra 112 të burgosur shqiptarë. Mund të jetë që ky sulm s'është futë në këtë tabelë pasi vetëm 29 të burgosur në Burgun e Dubravës vriten nga bombat e NATO-s më 19 dhe 20 maj 1999, kurse të tjerët, po sipas FDH-së, ekzekutohen nga forcat sërbe më 21 dhe 23 maj 1999. Sa për vrasjet e civilëve nga NATO-ja, raporti i organizatës Human Rights Watch (HRW), i bazuar në hulumtime terreni, thotë se NATO-ja gjatë bombardimeve në territorin e RFJ-së ka vrarë minimum 489 dhe maksimum 528 civilë të pafajshëm. Sipas HRW-së, numri më i madh i këtyre civilëve të pafajshëm janë vrarë në territorin e Kosovës dhe sillet ndërmjet 279 e 318 veta. Pra, numri i civilëve të vrarë nga NATO-ja, në tekstet e Sërbisë së paku dyfishohet, kurse në tekstet e Kosovës e të Shqipërisë nuk shënohet fare.

Para Konferencës së Rambujesë, njëra prej ngjarjeve më të rëndësishme në rrafshin politik është takimi i një delegacioni nga Kosova, të përfaqësuar nga Ibrahim Rugova, me Slobodan Milošević-in në maj të vitit 1998, ku palët dakordohen për një zgjidhje paqësore të çështjes së Kosovës. Kjo nuk prezentohet në asnjërin prej teksteve të këtyre vendeve. Pa dyshim, një prej çasteve më të rëndësishme gjatë **konfliktit të armatosur** në Kosovë është edhe konferenca e organizuar në Rambuje të Francës, e cila në tekstet e Kosovës, të Shqipërisë, të Sërbisë dhe të Malit të Zi prezentohet fare shkurt dhe në mënyra të ndryshme. Por, nuk jepen arsyet e dështimit të këtyre bisedimeve, as esenca e dokumentit **Marrëveshja e Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje**, i nënshkruar në Paris, më 18 mars 1999, nga përfaqësuesit shqiptarë të Kosovës në konferencë dhe ndërmjetësuesit Christopher Hill (ShBA) e Wolfgang Petritsch (BE), por i refuzuar nga Sërbia / RFJ-ja dhe ndërmjetësuesi Boris Majorski (Rusi).

Autorët e këtyre teksteve s'e thonë që ky dokument – implementimi i të cilit garantohej me 28.000 trupa të NATO-s në Kosovë – parashihte për Kosovën **autonomi substanciale** në kuadër të sovranitetit dhe të integritetit territorial të RFJ-së. Po ashtu, nuk prezentohen as dispozitat e këtij dokumenti për demilitarizimin e UÇK-së dhe mbetjen e 2.500 policëve e 1.500 ushtarëve të RFJ-së brenda territorit të Kosovës. Tekstet e Sërbisë thonë se "...agresioni i NATO-s ka ndodhë pasi që pala sërbe në Rambuje e Paris refuzoi t'i nënshkruajë kërkesat ultimative për tërheqjen e ushtrisë dhe policisë nga Kosova". Pra, nxënësve sërbe u krijohet përshtypja se "shtetet perëndimore që u përzien duke i dhënë përkrahje të hapur shqiptarëve", kishin për qëllim ta largonin Sërbinë nga Kosova.

Tekstet e Kosovës, me aq informata sa japin, e krijojnë bindjen se UÇK-ja nuk ka lëshuar pe nga qëndrimet e saj politike. Përveçqë s'e përmendin nënshkrimin

e **autonomisë substanciale** për Kosovën nga ana e përfaqësuesve të UÇK-së, për tekstet e Kosovës platforma politike e luftës së UÇK-së ishte liria dhe pavarësia e Kosovës. Pra, s'vihet askund në dukje se ajo platformë fillimisht ishte – siç e thotë teksti i betimit të ushtarit të UÇK-së – "...për çlirimin dhe bashkimin e tokave të pushtuara të Shqipërisë".

Ndërsa, tekstet e Shqipërisë e përmendin **autonominë substanciale** që Kosova do ta gëzonte brenda RFJ-së në bazë të dokumentit **Marrëveshja e Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje**, por, shtojnë edhe se "çështja e pavarësisë së Kosovës do të diskutohej pas tre vjetëve". Në të vërtetë, ky dokument nuk e përmend askund pavarësinë, por jep frazën jo fort qartë të përcaktuar: "...pas tre vjetësh do të thirret një mbledhje ndërkombëtare për ta determinuar një mekanizëm për një zgjidhje finale për Kosovën, në bazë të vullnetit të popullit, të mendimeve të autoriteteve relevante, të përpjekjeve të secilës palë në lidhje me implementimin e kësaj marrëveshjeje dhe të Aktit Final të Helsinkit...". Përveçqë nuk specifikohet kund se për vullnetin e cilit popull bëhet fjalë, bashkë me togfjalëshin "vullneti i popullit" radhitet edhe mbështetja në Aktin Final të Helsinkit, sipas të cilit, kufijtë ndërkombëtarë mund të ndryshojnë vetëm me pajtimin e të dyja palëve.

Pas Rambujesë, më i rëndësishmi gjatë luftës në Kosovë është padyshim harku kohor i bombardimeve të NATO-s ndaj caqeve ushtarako-policore serbe/jugosllave, i cili sipas teksteve të Sërbisë është **agresion** i NATO-s, që ndodh pasi pala serbe/jugosllave refuzon t'i tërheqë trupat ushtarako-policore nga Kosova. Siç u përmend edhe më lart, bashkësia ndërkombëtare s'kërkonte tërheqjen e **të gjitha** trupave ushtarako-policore serbe/jugosllave nga Kosova, prandaj prezntimi i këtyre në tekstet e Sërbisë sikur synon ta paraqesë Sërbinë "viktimë të shteteve perëndimore që haptas anuan kah shqiptarët". Tekstet e Shqipërisë, në anën tjetër, thonë se fillimisht janë dëbuar nga Kosova rreth një milion shqiptarë, e më pas "...forcat ushtarake të NATO-s bombarduan Sërbinë dhe e detyruan atë të tërhiqet nga Kosova". Mirëpo, siç u përmend edhe më sipër, sipas UNHCR-it, në periudhën 24 mars-10 qershor 1999, që është harku kohor kur kryhen bombardimet e NATO-s, forcat serbe deportojnë nga Kosova, 862,979 veta, dhe kryejnë pjesën më të madhe të vrasjeve të civilëve shqiptarë të Kosovës.

Për tekstet e Kosovës, NATO-ja ka ndërhy ushtarakisht "...për t'ua ndalë hovin krimeve që bënte Sërbia ndaj shqiptarëve". Sipas këtyre teksteve, Kosova është çliruar nga Sërbia "...pas luftës së suksesshme çlirimtare të UÇK-së dhe **hyrjes** së trupave të NATO-s në qershor të vitit 1999". Nëse UÇK-ja s'ishte në gjendje t'ua ndalte hovin krimeve që bënte Sërbia ndaj shqiptarëve dhe duhej të **ndërhynte** ushtarakisht NATO-ja, duket vështirë e kuptueshme se Kosova u

çlirua **pas luftës së suksesshme të UÇK-së dhe hyrjes së trupave të NATO-s**. Po ashtu, tekstet e Kosovës thonë se "...**pos** njësiteve luftarake të UÇK-së, në Kosovë hynë **edhe** forcat e NATO-s me emrin KFOR". Kështu sikur lihet të kuptohet se as trupat e UÇK-së nuk paskëshin qenë në Kosovë, por paskëshin hy sikur trupat e NATO-s, mirëpo tekstet e Kosovës nuk tregojnë se prej kah dhe kur hynë.

Në disa prej teksteve të Kosovës thuhet edhe se pala sërëbo-jugosllave është tërheqë nga territori i Kosovës si pasojë e "...bombardimeve të NATO-s dhe aksioneve të vazhdueshme të UÇK-së". Marrëveshja Tekniko-Ushtarake për tërheqjen e forcave sërëbe/jugosllave nga Kosova, e nënshkruar më 9 qershor 1999 në Kumanovë, lidhet **vetëm** mes NATO-s dhe RFJ-së, përkatësisht Sërbisë. Autorët e teksteve të Kosovës, e as ata të teksteve të Shqipërisë, nuk saktësojnë se UÇK-ja nuk ishte pjesë e kësaj marrëveshjeje të rëndësishme për përfundimin e konfliktit të armatosur në Kosovë. Ajo, përveçse i detyron forcat sërëbe/jugosllave me u tërheqë nga Kosova, garanton – gjë që prapë s'përmendet në këto tekste – se një numër i kufizuar i tyre, **qindra, jo mijëra**, do të mund të kthehen në Kosovë. E njëjta garanci nuk figuron as në tekstet e Sërbisë e të Malit të Zi.

Po ashtu, në asnjërën prej historiografive s'thuhet kund se fillimisht qëllimi i NATO-s nuk ishte t'i heqë të gjitha trupat ushtarako-policore sërëbe/jugosllave nga Kosova, por u bë i tillë më 3 qershor 1999, pak ditë para përfundimit të bombardimeve, kur Presidenti i RFJ-së, Slobodan Milošević, e pranoi dokumentin e hartuar nga Strobe Talbott (ShBA), Martti Ahtisaari (BE), dhe Victor Chernomyrdin (Rusi), që kërkonte tërheqjen e të gjitha forcave policore, ushtarake dhe paraushtarake të RFJ-së/Sërbisë nga Kosova. Kjo për shkak se vetëm kështu refugjatët do të ndjeheshin të sigurt të ktheheshin në shpitë e veta dhe trupat e NATO-s do të vendoseshin në një ambient të sigurt pa gjasa për ndonjë konflikt me ato të Sërbisë/RFJ-së e as të këtyre të fundit me popullsinë e kthyer.

Edhe demilitarizimi dhe transformimi i UÇK-së në tekstet e Kosovës prezentohet veç si shndërrim i UÇK-së në Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) "...në bazë të një marrëveshjeje të nënshkruar në shtator të vitit 1999 ndërmjet gjeneralit Agim Çeku, komandant i UÇK-së, dhe gjeneralit Michael Jackson, komandant i KFOR-it". Dokumenti **Zotimi për Demilitarizim dhe Transformim të UÇK-së**, që Drejtori Politik i UÇK-së, Hashim Thaçi, i ofron komandantit Jackson më 21 qershor 1999, s'figuron askund. Në këtë dokument Hashim Thaçi zotohet se ushtarët e UÇK-së do të çarmatosen dhe do të integrohen në shoqëri civile, si organizata civile për ndërhyrje emergjente - TMK. UÇK-ja, sipas këtij dokumenti, pajtohej mos me i ndërhy personelit të

RFJ-së që kthehet në Kosovë (**qindra, jo mijëra**) për të kry detyra të caktuara sipas autorizimit dhe udhëzimit të komandantit të KFOR-it. Në tekstet e Shqipërisë, çarmatosja e UÇK-së përmendet përciptazi: “...detyra e KFOR-it ishte të çmilitarizonte UÇK-në”, kurse në ato sërbe e malazeze s’përmendet hiç. Për pushtetin civil në Kosovë, të vendosur nga OKB-ja, dhe atë ushtarak, të vendosur nga NATO-ja, në tekstet e Kosovës ofrohen vetëm data dhe numra trupash të vendosura. Nuk theksohet askund qëllimi i misionit të NATO-s në Kosovë për të zbatuar Rezolutën 1244 të KS të OKB-së. Po ashtu, nuk figuron asnjë e dhënë përkritazi me misionin e OKB-së në Kosovë, UNMIK, i cili sipas Rezolutës 1244 i garantonte Kosovës administrim të përkohshëm ndërkombëtar, nën të cilin populli i Kosovës gëzonte autonomi substanciale në kuadër të RFJ-së. Në tekstet e Sërbisë figuron garanci për integritetin territorial të RFJ-së sipas Rezolutës 1244⁵⁴

54 Për kërkesat e minatorëve: Maliqi, Shkëlzen. *Nyja e Kosovës – as Vllasi as Milošević-i*. Lubljanë: Knjizna zbirka KRT, 1990, faqe 254; Malcolm, Noel. *Kosovo - A Short History*. London: Pan Macmillan, 2002, faqe 334-356; Clark, Howard. *Civil Resistance in Kosovo*. London: Pluto Press, 2000, faqe 58, 70-157; Ismajli, Rexhep, Hivzi Islami, Esat Stavileci dhe Ilaz Ramajli. *Akte të Kuvendit të Republikës së Kosovës – 2 korrik 1990-2 maj 1992*. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, 2005, faqe 7-8 dhe 9-41, 98-101, 119 dhe 141-142; Gashi, Shkëlzen. *Adem Demaçi biografi e paautorizuar*. Prishtinë: Rrokullia, 2010, faqe 118-140; Kandić, Nataša. *Libër Kujtimi i Kosovës 1998-2000*. Prishtinë: Fondi për të Drejtën Humanitare, 2011, faqe 457; *UNHCR Country Updates – Former Yugoslavia, UN Inter-Agency Humanitarian Situation Report: Kosovo*. 65-70; Shih edhe: <http://www.unhcr.org/pages/49e48d9f6.html>; Schabas, William. *Gjenocidi në të Drejtën Ndërkombëtare*. Prishtinë: Finish-UNHCR Human Rights Support Programme - Kosovo, 2003, faqe 467; Human Rights Watch. *Civilian Deaths in the NATO Air Campaign*. Gjetet në: <http://www.hrw.org/legacy/reports/2000/nato/>; Marrëveshja e Përkohshme për Paqe dhe Vetë-qeverisje, Paris, 18 mars 1999. Gjetet në: <http://jurist.law.pitt.edu/ramb.htm>; Dokumenti Marrëveshja Teniko-Ushtarake mes Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë (KFOR) dhe Qeverive të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Republikës së Sërbisë, Kumanovë, 9 qershor 1999. Gjetet në: <http://www.nato.int/kosovo/docu/a990609a.htm>; Dokumenti Marrëveshja Teniko-Ushtarake mes Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë (KFOR) dhe Qeverive të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Republikës së Sërbisë, Kumanovë, 9 qershor 1999. Gjetet në: <http://www.nato.int/kosovo/docu/a990609a.htm>; Dokumenti i hartuar nga Strobe Talbott (ShBA), Martti Ahtisaari (BE), Victor Chernomyrdin (Rusi) dhe i pranuar nga Parlamenti i Sërbisë më 3 qershor 1999. Gjetet në: <http://jurist.law.pitt.edu/peace.htm#plan>; Zotimi për Demilitarizim dhe Transformim të UÇK-së. Gjetet në <http://jurist.law.pitt.edu/peace.htm>; Rezoluta 1244 e KS të OKB-së. Gjetet në: <http://www.un.org/Docs/scres/1999/sc99.htm>.

BIBLIOGRAFI

Tekste mësimore

Kosovë

- Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj. *Historia 5*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013.
- Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj. *Historia 6*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013.
- Bicaj, Isa dhe Arbër Salihu. *Historia 7*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013.
- Rexhepi, Fehmi. *Historia 9*. Libri Shkollor, 2013.
- Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj. *Historia 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013.
- Bajraktari, Jusuf, Fehmi Rexhepi dhe Frashër Demaj. *Historia 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2011.
- Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj. *Historia 11*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013.
- Abdyli, Ramiz dhe Emine Bakalli. *Historia 11*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2012.
- Bajraktari, Jusuf dhe Arbër Salihu. *Historia 12*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013.

Shqipëri

- Boçi, Sonila. *Historia 4*. Tiranë: Botime Shkollore Alban, 2013.
- Treska, Tomi dhe Menduh Dërguti. *Historia 6*. Tiranë: Botime Shkollore Alban, 2013.
- Dërguti, Menduh, Sonila Boçi dhe Ledia Dushku. *Historia 9*. Tiranë: Botime Shkollore Alban, 2013.
- Treska, Tomi, Menduh Dërguti dhe Abaz Mullaj. *Historia e qytetërimit botëror 11*. Tiranë: Botime Shkollore Alban, 2013.
- Dërguti, Menduh, Ferit Duka, Ledia Dushku dhe Sonila Boçi. *Historia e shqiptarëve 12*. Tiranë: Botime Shkollore Alban, 2013.

Sërbi

- Smirnov-Brkiq, Aleksandra. *Istoria 5*. Beograd: Zavod za udžbenike, 2011.
- Mihaljčić, Rade. *Istoria 6*. Beograd: Zavod za udžbenike, 2011.
- Bataković, Dušan. *Istoria 7*. Beograd: Zavod za udžbenike, 2010.
- Đurić, Đorđe dhe Momčilo Pavlović. *Istoriya 8*. Beograd: Zavod za udžbenike, 2010.
- Radoš Ljušić. *Istoriya za I razred gimnazije*. Beograd: Zavod za udžbenike, 2008.
- Katić, Tatjana dhe Dušan Ilijin. *Istoriya za I razred gimnazije*. Beograd: Zavod za udžbenike, 2013.
- Smilja Marjanović-Dušanić dhe Marko Šuica. *Istoriya za II razred gimnazije*. Beograd: Zavod za udžbenike, 2009.
- Đurić, Đorđe dhe Momčilo Pavlović. *Istoriya 3*. Beograd: Zavod za udžbenike, 2010.

Mal të Zi

- Kasumović, Millada dhe Goran Marković. *Historia 6*. Podgoricë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 2006.
- Popović, Radovan dhe Dragan Miranović. *Historia 7*. Podgoricë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 2006.
- Andrijašević, Zhivko, Sait Šabotiq, Dragutin Papović dhe Slobodan Drobnjak. *Historia 8*. Podgoricë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 2008.
- Burzanović, Sllavko dhe Jasmina Gjorgjević. *Historia 9*. Podgoricë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 2008.
- Vukçević, Sllavko dhe Millada Kasumović e Goran Marković. *Historia 1*. Podgoricë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 2006.
- Popović, Radovan dhe Dragan Miranović e Dragoje Gjokiq. *Historia 2*. Podgoricë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 2006.
- Borozan Gjorgje, Sasha Knezhević dhe Sait Šabotiq. *Historia 3*. Podgoricë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 2009.
- Rastoder, Sherbo, Radoje Pajović dhe Zvezdan Folić. *Historia 4*. Podgoricë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 2009.

Maqedoni

- Mladenovski, Simo. *Historia 5*. Shkup: Prosvetno Dello, 2004, faqe 63-65; Axhievski, Kosta dhe Darinka Petreska, Violeta Ačkoska, Naum Dimoski dhe Vančo Gjorgjiev. *Historia 5*. Shkup: Tabernakul, 2005.
- Boshkoski, Millan, Jordan Ilioski dhe Nebi Dervishi. *Historia 6*. Shkup: Prosvetno Dello, 2008.
- Vellkoski, Vllado, Halit Sejdiu, Arijan Alademi, Dimka Risteska dhe Gjorgji Pavllovski. *Historia 8*. Shkup: Prosvetno Dello, 2005.
- Pavllovski, Gjorgji dhe Dime Maxhovski e Jovo Ratković. *Historia 1 për gjimnazin e reformuar*. Shkup: Prosvetno Dello, 2002.
- Boshkoski, Millan dhe Gjorgji Isajllovski, Miroslav Boshković, Jordan Ilioski, Vllado Vellkoski, Simeon Naumovski. *Historia 1 për arsimin e mesëm profesional*. Shkup: Prosvetno Dello.
- Boshkoski, Millan, Jordan Ilioski, Gjorgji Isajllovski, Vllado Vellkoski, Miroslav Boshković dhe Simeon Naumovski. *Historia 1 arsimit të mesëm profesional*. Shkup: Prosvetno Dello, 2006.
- Boshkoski, Millan dhe Nebi Dervishi, Safet Neziri, Dime Maxhovski dhe Sasho Nikolloški. *Historia 1 - arsimit të gjimnazit*. Shkup: Prosvetno Dello, 2009.
- Boshkoski, Millan, Nebi Dervishi, Silvana Sidorovska – Cupovska, Natasha Kotlar, Jordan Ilioski, Dimko Popovski. *Historia 2 arsimit të gjimnazit*. Shkup: Prosvetno Dello, 2008.
- Veljanovski, Novica, Gordana Pletvarska, Sonja Cvetkovska dhe Shyqeri Xhaferi. *Historia 3 – arsimit të gjimnazit*. Shkup: Prosvetno Dello, 2009.

Tekste të tjera

- Bartl, Peter. *Shqipëria nga Mesjeta deri Sot*. Prizren: Drita, 1999.
- Belegu, Xhafer. *Lidhja e Prizrenit dhe veprimet e saj*. Tiranë, 1939.
- Castelan, Georges. *Histori e Ballkanit*. Tiranë: Çabej, 1996.
- Clark, Howard. *Civil Resistance in Kosovo*. London: Pluto Press, 2000.
- Fischer, Bernd. *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*. Tiranë: Çabej, 2000
- Freundlich, Leo. *Golgota e Shqipërisë*. Prishtinë: Rrokullia, 2010.
- Gashi, Shkëlzen. *Adem Demaçi - biografi e paautorizuar*. Prishtinë: Rrokullia, 2010.
- Gawrych, George. *Gjysmëhëna dhe shqiptonja – sundimi otoman, islamizimi dhe shqiptarët 1874-1913*. Tiranë: Bota Shqiptare, 2007.
- Ismajli, Rexhep, Hivzi Islami, Esat Stavileci dhe Ilaz Ramajli. *Akte të Kuvendit të Republikës së Kosovës – 2 korrik 1990-2 maj 1992*. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, 2005.
- Judah, Tim. *Kosova – Luftë dhe Hakmarrje*. Prishtinë: Koha, 2002.
- Kandić, Nataša. *Libër Kujtimi i Kosovës 1998-2000*. Prishtinë: Fondi për të Drejtën Humanitare, 2011.
- Krieger, Heike (ed.). *The Kosovo Conflict and International Law*. Cambridge: Cambridge University Press, 2001.
- Malcolm, Noel. *Kosovo: A Short History*. London: Pan Books, 2002.
- Maliqi, Shkëlzen. *Nyja e Kosovës – as Vllasi as Milošević-i*. Lubllanë: Knjizna zbirka KRT, 1990.
- Matzinger, Joachim. *Shqiptarët si pasardhës të ilirëve nga këndvështrimi i gjuhësisë historike*. botuar në librin e përgatitur nga Oliver Schmitt dhe Eva Anne Frantz. *Historia e Shqiptarëve – gjendja dhe perspektivat e studimeve*. Tiranë: Botimet Përpjekja, 2012.
- Schmitt, Oliver. *Shqiptarët – një histori midis Lindjes dhe Perëndimit*. Tiranë: K&B, 2012.
- Schmitt, Oliver. *Kosova: histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*. Prishtinë: Koha, 2012.
- Schmitt, Oliver. *Monada e Ballkanit - Shqiptarët në Mesjetë*. botuar në librin e përgatitur nga Oliver Schmitt dhe Eva Anne Frantz. *Historia e Shqiptarëve – gjendja dhe perspektivat e studimeve*. Tiranë: Botimet Përpjekja, 2012.
- Schabas, William. *Gjenocidi në të Drejtën Ndërkombëtare*. Prishtinë: Finish-UNHCR Human Rights Support Programme - Kosovo, 2003.
- Schwartz, Stephen. *Kosovo: Background to a War*. London: Anthem Press, 2000.
- Surroi, Veton. *Fadil Hoxha në vetën e parë*. Prishtinë: Koha, 2010, faqe 233-255.
- Thalloczy, Ludwig. *Të ndodhurat e Shqypnis prej një geqe që don vendin e vet*. Shkodër: Botime Françeskane, 2008.

Raporte dhe dokumente

- UNHCR Country Updates – Former Yugoslavia, UN Inter-Agency Humanitarian Situation Report: Kosovo:
<http://www.unhcr.org/pages/49e48d9f6.html>
- Human Rights Watch. Civilian Deaths in the NATO Air Campaign. Gjendet në:
<http://www.hrw.org/legacy/reports/2000/nato/>
- Marrëveshja e Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje, Paris, 18 mars 1999. Gjendet në: <http://jurist.law.pitt.edu/ramb.htm>
- Dokumenti Marrëveshja Teniko-Ushtarake mes Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë (KFOR) dhe Qeverive të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Republikës së Sërbisë, Kumanovë, 9 qershor 1999. Gjendet në:
<http://www.nato.int/kosovo/docu/a990609a.htm>
- Dokumenti Marrëveshja Teniko-Ushtarake mes Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë (KFOR) dhe Qeverive të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Republikës së Sërbisë, Kumanovë, 9 qershor 1999. Gjendet në:
<http://www.nato.int/kosovo/docu/a990609a.htm>
- Dokumenti i hartuar nga Strobe Talbott (ShBA), Martti Ahtisaari (BE), Victor Chernomyrdin (Rusi) dhe i miratuar nga Parlamenti i Sërbisë më 3 qershor 1999. Gjendet në: <http://jurist.law.pitt.edu/peace.htm#plan>
- Zotimi për Demilitarizim dhe Transformim të UÇK-së. Gjendet në:
<http://jurist.law.pitt.edu/peace.htm>
- Rezoluta 1244 e KS të OKB-së. Gjendet në:
<http://www.un.org/Docs/scres/1999/sc99.htm>

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

37.02:94(496.51)

94:37.02(075)

Gashi, Shkëlzen

Historia e Kosovës në tekstet mësimore të historisë në Kosovë, Shqipëri,
Sërbë, Mal të Zi dhe Maqedoni / Shkëlzen Gashi. – Prishtinë : Alter Habitus,
2016. – 120 f. ; 25 cm.

Bibliografia : f. 117-120

ISBN 978-9951-8938-0-0

Ky publikim vë nën objektiv mënyrën e prezentimit të periudhave më të rëndësishme të historisë së Kosovës, që nga antikiteti e deri më sot, nëpër tekstet e historisë për shkollat fillore e të mesme në Kosovë, Shqipëri, Sëri, Mal të Zi dhe Maqedoni. Tekstet e këtyre pesë vendeve, të miratuara nga ministrinë përkatëse të arsimit, shërbyen si burim themelor për t'i krahasuar ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre, por edhe falsifikimet përkatëse të secilës nga këto historiografi. Përballë tyre janë vënë argumentet e autorëve ndërkombëtarë që trajtojnë arealin e Kosovës nga antikiteti deri në ditët tona. Në një mënyrë të tërthortë ky publikim mëton me nxjerrë në pah edhe se ç'marrëdhënie ndërfqinjësore po u sugjerojnë qeveritë e pesë shteteve përkatëse, brezave që me anë të këtyre teksteve po i arsimojnë, kurse në mënyrë të qartë e të faktografuar, publikimi synon me shpalosë atë që përbën bazën e pretendimeve shpesh kundërshtuese ndërmjet popujve që takohen në Kosovë.

ISBN 978-9951-8938-0-0



9 789951 893800



Ky raport u bë i mundshëm falë ndihmës bujare nga:



Kingdom of the Netherlands



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA



Fundacioni Kosovë për Shqipëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fundacija za Otvoreno Društvo

GEORG ECKERT
INSTITUTE

for International Textbook Research